



FAQE 2



FAQE 3



FAQE 4



FAQE 5

# Koha

www.koha.mk

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3220 • E hënë 13 nëntor 2017 15 DEN



Te Renova  
edhe pas  
karrierës

FAQE 12-13

## Huliganët kryesorë të dhunës, ende në liri



Shkup, 12 nëntor - Dhuna në Kuvendin e Maqedonisë, më 27 prill, ende nuk ka marrë një epilog konkret gjyqësor. Deri më tani organet e ndjekjes penale kanë ngritur akuza ndaj disa pjesëmarrësve në dhunën e ushtruar ndaj deputetëve dhe zyrtarëve tjerë, ndërsa njëri prej tyre, Pançe Angellov,

është dënuar me katër vjet burgim për tërheqjen për flokësh të ministres së Mbrojtjes, Radmilla Sheqerinska. Nga Prokuroria Speciale thonë se hetimet për pjesëmarrësit e tjerë në dhunë po ecin ngadalë, për shkak të pengesave të ndryshme që bëhen nga drejtuesit e gjykatave, por sh-

prehen të bindur se askush nuk do të mund t'i ikë drejtësisë. Ziadin Sela nga Aleanca për Shqiptarët, ishte një nga deputetët që ishte në shënjestër të sulmit të protestuesve që kishin pushtuar Kuvendin për shkak të zgjedhjes së kryetarit shqiptar të Kuvendit...

FAQE 2

Maqedonia para zgjidhjes së çështjes me emrin

## Përveç VMRO-së, të gjithë e duan Parisin



Përveç VMRO-së, e cila kërkon që dialogu mes partive të zhvillohet në institucionet e shtetit, të gjitha partitë tjetra janë pro nisjes së dialogut në shtëpinë e Zhan Monesë në Paris

FAQE 3

SPECIALE  
Të luftosh  
radikalizmin  
dhe  
hoxhallarët  
e internetit



Rinia në Ballkan ka qenë një shënjestër e lehtë për ekstremistët që kërkojnë t'i radikalizojnë ata dhe t'i bindin të luftojnë jashtë vendit, por tani prindër, aktivistë dhe organizata zyrtare islamike po kundërveprojnë. "Dija shumë pak për fenë", tha për BIRN një...

FAQE 18

RAJON  
Dy muaj  
për Demar-  
kacionin

FAQE 16

GLOBI  
Shqiptarët të  
parët në  
Evropë për  
konsumim  
të ilaçeve

FAQE 17

REPORTAZH  
Skllëvërit  
modernë  
në Ballkan



FAQE 16

## Prodhimet organike, ardhmëria e bujqësisë



Shkup, 7 nëntor - Vetëm 0.5 për qind e tokave bujqësore në Maqedoni janë të mbjella me prodhime organike. Kjo paraqet një sasi shumë të vogël në raport me mundësitë dhe kërkesat e tregut, sidomos atij të huaj për një ushqim të shëndoshë organik. Sipas të dhënave të Odës Ekonomike të Maqedonisë, në

shtet janë të regjistruar vetëm 533 fermerë të prodhimtarisë organike, që më së shumti kultivojnë kultura të perimeve dhe të drithërave në një tokë prej afër 3200 hektarë. Për dallim prej Maqedonisë, që nuk ka asnjë për qind të tokës bujqësore të mbjellë me prodhimtari organike, në Slloveni gati 2.5 për

qind e të mbjellave janë me prodhime organike. Vend lider për prodhimin e ushqimit organik është Danimarka, ku mbi 9 për qind e tokës mbillet me ushqim organik. Ky shtet, për çdo vjet ndan nga 50 milionë euro që të stimulojë fermerët të kalojnë nga prodhimtaria tradicionale në atë...

FAQE 6



Prezantohet projekti gjigant i Shqipërisë

# Rruga e Arbrit, një korridor ekonomik për gjithë rajonin

Rruga e Arbrit është një ëndërr që bëhet realitet për të gjithë zonën e Dibrës, tha kryeministri shqiptar Edi Rama gjatë prezantimit në Dibër të këtij projekti fitues që do të jetë rruga e parë kombëtare me standarde evropiane në Shqipëri që do të certifikohet nga BE-ja. "Kjo është rruga më e shkurtër nga Tirana në Dibër, Tetovë, Shkup e më tej, në Republikën e Maqedonisë e gjithashtu rruga më e shkurtër drejt Bullgarisë e Rumanisë dhe më tej..."



Tiranë, 12 nëntor - Ndërtimi i rrugës së Arbrit që lidh Tiranën me Dibrën, synon të krijojë një korridor ekonomik jo vetëm me Maqedoninë, nëpërmjet Dibrës së Madhe, por edhe me vendet e rajonit. Gjatë prezantimit të projektit të propozuar nga kompania "Gjoka Konstruktion sh.a" që do të ndërtojë këtë rrugë, inxhinieria Albana Ahmeti shpjegoi efektet e këtij investimi të rëndësishëm në epërsinë ekonomike dhe sociale që do të japë për Shqipërinë

dhe rajonin. Kjo Rrugë, siç tha ajo, do të bëhet një korridor lidhës i rëndësishëm i Lindje-Perëndimit. Kjo është rruga më e shkurtër nga Tirana në Dibër, Tetovë, Shkup e më tej, në Republikën e Maqedonisë e gjithashtu rruga më e shkurtër drejt Bullgarisë e Rumanisë dhe më tej. Rruga e Arbrit është

një ëndërr që bëhet realitet për të gjithë zonën e Dibrës, tha kryeministri shqiptar Edi Rama gjatë prezantimit në Dibër të këtij projekti fitues që do të jetë rruga e parë kombëtare me standarde evropiane në Shqipëri që do të certifikohet nga BE-ja. Rama, siç transmeton ATSH, tha se rruga e

Arbrit do të ndjekë rrugën e karvanëve që ka lidhur historikisht Dibrën me Tiranën. Kjo u shpreh kreu i qeverisë, "është një rrugë shumë më e shkurtër dhe që do të zgjidhë një problem të madh që ka torturuar të gjithë dibranët nga Peshkopia në Klos, në Burrel dhe në Bulqizë".

Siç theksoi Rama, segmenti i ri i kësaj rruge e bën kufirin me Maqedoninë 75 km nga 160 kilometrat e tanishme. Sipas tij ky projekt është i rëndësishëm jo vetëm për këtë zonë, por për të gjithë vendin. Ai shtoi se Dibra me pasuritë e saj ka ndihmuar me zhvillimin e vendit shumë më tepër se sa ka mundur të ndihmojë veten. "Ne morëm zotimin se rruga e Arbrit nuk do të lidhë vetëm një zonë me një zonë, por do të jetë një burim për investime strategjike për punësimin dhe turizmin që do të sjellë punësim për këtë zonë", tha ai. Kryeministri theksoi se, me përfundimin e Rrugës së Arbrit nuk do të kemi vetëm një aks të brendshëm, por dhe një korridor të rëndësishëm ekonomik në rajon. Ai konfirmoi gjithashtu edhe dakordësimin për të realizuar së shpejti në Pogradec një mbledhje të përbashkët mes Qeverisë së Shqipërisë dhe të Maqedonisë. Rama tha se në rend të parë të ditës të kësaj mbledhje do të

kompletimi nga pala maqedonase për këtë projekt në pjesën e vet, në mënyrë që përmes Portit të Durrësit edhe Maqedonia të mund të aksesojë sa më shpejt. Rruga që përdoret sot nga mjetet e transportit nga Tirana për në Dibër të Maqedonisë, kalon nga Qafë Thana drejt Strugës e më tej, me një gjatësi përafërsisht 180 km në total. Ky projekt do të përmirësojë ndjeshëm kushtet e transportit lokal te njerëzve dhe do të bëhet një galeri kryesore që lidh kryeqytetin e Shqipërisë dhe vendin fqinj Maqedoninë. Për këtë arsye, ky projekt mund të çojë drejt rritjes ekonomike të dy vendeve dhe do të ndikojë në zhvillimin rajonal.

Ky projekt është mbështetur nga autoritetet qeveritare shqiptare në të gjitha nivelet. Punimet për ndërtimin e Rrugës së Arbrit pritet të zgjasin 44 muaj ndërsa distanca mes Tiranës dhe Dibrës pritet të shkurtohet ndjeshëm, në gati 40 minuta.

Akoma nuk është zbardh rasti i 27 prillit në Parlament

"Lavdërohen se kanë ngritur akuzë për veprën vrasje në rastin e Ziadin Selës. Për kë? Për muskujt apo për ata të fortët që e kryen aktin e dhunës? Ku është këtu grupi kriminal, ku është porositësi, ku është ai që mundësoi pushtimin e Kuvendit, ku është roli i Policisë, e cila nuk ndaloi protestuesit të futen brenda dhe të rrahin për vdekje deputetët?! Do të jetë e turpshme nëse mendojnë se me këtë e kanë mbyllur këtë proces", vlerëson për Radion Evropa e Lirë, Zvonko Davidoviq, njohës i çështjeve juridike

## Huliganët kryesorë të dhunës, ende në liri



Shkup, 12 nëntor - Dhuna në Kuvendin e Maqedonisë, më 27 prill, ende nuk ka marrë një epilog konkret gjyqësor. Deri më tani organet e ndjekjes penale kanë ngritur akuzat ndaj disa pjesëmarrësve në dhunën e ushtruar ndaj deputetëve dhe zyrtarëve tjerë, ndërsa njëri prej tyre, Pançe Angelov, është dënuar me katër vjet burgim për tërheqjen për flokësh të ministres së

Mbrojtjes, Radmilla Sheqerinska. Nga Prokuroria Speciale thonë se hetimet për pjesëmarrësit e tjerë në dhunë po ecin ngadalë, për shkak të pengesave të ndryshme që bëhen nga drejtuesit e gjykatave, por shprehen të bindur se askush nuk do të mund t'i ikë drejtësisë. Ziadin Sela nga Aleanca për Shqiptarët, ishte një nga deputetët që ishte në shënjestër të sulmit të protestuesve që kishin pushtuar Kuvendin për

shkak të zgjedhjes së kryetarit shqiptar të Kuvendit, por edhe mosformimit të Qeverisë së re nga VMRO-ja, që sipas tyre, ishte fituese e zgjedhjeve. Sela, që kishte pësuar më së shumti nga sulmuesit, thotë se pas këtij sulmi qëndrojnë personalitetet të larta të pushtetit të kaluar, të cilët, siç shprehet, për të mbuluar krimin janë të gatshëm të bëjnë gjithçka. "Realisht, nuk kanë

nevojë shumë për dëshmi, sepse gjithçka ishte shumë publike, sikur që ishin publike edhe tendencat e asaj që ndodhi. Edhe porositësit e asaj që ndodhi janë shumë publikë, janë figura politike, kryetar partish, të cilët në përpjekje për të shpëtuar krimin dhe korrupsionin që kanë bërë ndër vite, janë të gatshëm të bëjnë gjithçka", deklaroi Sela. Njohësit e çështjeve juridike, thonë se rasti i 27 prillit nuk mund të quhet i zbardhur pa u dënuar

porositët e pushtimit të Kuvendit dhe të dhunës së ushtruar mbi deputetët dhe anëtarët e qeverisë, që ndodheshin aty.

"Lavdërohen se kanë ngritur akuzë për veprën vrasje në rastin e Ziadin Selës. Për kë? Për muskujt apo për ata të fortët që e kryen aktin e dhunës? Ku është këtu grupi kriminal, ku është porositësi, ku është ai që mundësoi pushtimin e Kuvendit, ku është roli i Policisë, e cila nuk ndaloi protestuesit të futen brenda dhe të rrahin për vdekje deputetët?!"

Do të jetë e turpshme nëse mendojnë se me këtë e kanë mbyllur këtë proces", vlerëson për Radion Evropa e Lirë, Zvonko Davidoviq, njohës i çështjeve juridike. Edhe Osman Kadriu, profesor i së Drejtës Kushtetuese kërkon përgjegjësi për organizatorët e gjithë asaj që ka ndodhur në Kuvend, në të kundërtën, sipas tij, përgjegjësia do të bjerë mbi Gjyqësorin, edhe ashtu të kritikuar për mbrojtjen e ish-zyrtarëve për veprat e

dyshuara për krime nga më të ndryshmet. "Këtu duhet urgjentisht të vepruar pasi nuk ka kohë për zvarritje të mëtejme, këtu duhet të vepruar drejtësisë, pasi kemi të bëjmë me vepra të rënda penale kundër pjesëtarëve të pushtetit, kundër deputetëve, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë fizike me motive konkrete politike, por kualifikimi i veprave është shumë i rëndë. Ata duhet gjykuar për vrasje, por edhe për vepra tjera si kundër shtetit, tradhti kombëtare, para së gjitha për organizatorët e puçit që ndodhi në Kuvend", vlerëson Kadriu.

Gjatë dhunës së ushtruar në Kuvend, përveç Ziadin Selës, lëndime kishin pësuar edhe lideri i LSDM-së Zoran Zaev, tani kryeministër i vendit, si dhe disa deputetë tjerë të partisë së tij. Pushtimit të Kuvendit i kishte paraprirë protesta disaditore e një grupi të madh të protestuesve, ithtarë të VMRO-së, të cilët veç tjerash kundërshtonin edhe formimin e Qeverisë mes LSDM-së dhe partive shqiptare. Gjatë hyrjes së dhunshme në Kuvend, ata besohet të jenë ndihmuar nga së paku tre deputetë të VMRO-së së Nikolla Gruevskit, të cilët kishin hapur dyert e Kuvendit pa u penguar fare nga pjesëtarët e sigurimit të Kuvendit. (REL)



## Han për Maqedoninë dhe Shqipërinë Në rrugën e duhur drejt BE-së

Shkup, 12 nëntor - Derisa Britania e Madhe shkon drejt daljes nga BE-ja, Ballkani Perëndimor kryen presion për hapjen e derye të Unionit. Në pranverë mund të jepet dritë jeshile nga Brukseli për hapje të negociatave për praninë në BE të Maqedonisë dhe Shqipërisë, shkruan gazeta austriake Kurir. Se Maqedonia dhe Shqipëria janë në rrugën e duhur drejt BE-ja, sipas kësaj gazete, ka vërtetuar edhe komisar për zgjerim dhe fqinjësi të mirë Johannes Han, në takimet me gazetarët e rajonit të dielën në Tiranë, transmeton MIA. Kryetari i Komisionit Evropian, Zhan Klod Junker, e theksoi 2025-tën si vitin e mundshëm për praninë të anëtarëve të rinj në BE, por sipas Han, asnjëri prej shteteve nuk ka garanci se atëherë do të kyçet në BE. Nëse vendoset afat konkret, mund të jetë rrezik për vendet e Ballkanit Perëndimor të cilat nuk do ta arrijnë këtë afat, të qëndrojnë në pritje dhe të bëjnë regres. Procesi i pranimit është proces i vazhdueshëm reformash, ndërkaq, cili shtet së pari do të bashkangjitet, nuk është vendosur, i transmetoi Han gazetarëve në Tiranë. Në shkurt, Komisioni do të prezantojë strategji për forcim të mëtejshëm të perspektivës evropiane dhe për reformat e nevojshme në rajon. Vlerësimi i pritshëm pozitiv për Maqedoninë dhe Shqipërinë, të cilat janë në rrugën e duhur, duhet të sigurojë bazë që vendet anëtare në BE të hapin rrugën për fillimin e bisedimeve inkuadruese me Shkupin dhe Tiranën. Bullgaria do të kryesojë me BE-në në gjysmën e parë të vitit 2018, më pas kryesimin e merr Austria, Rumania, Finlanda dhe Kroacia, respektivisht të gjitha janë vende që angazhohen për eurointegrimin e Ballkanit Perëndimor, citon "Kurir" Moment pozitiv, që ka qenë i theksuar në takimet e Hanit në Tiranë, janë raportet e përmirësuar mes Greqisë dhe Maqedonisë. Me këtë do të hapen mundësi për muajt e ardhshëm për fund eventual të bllokadës greke për shkak të çështjes afatgjatë rreth emrit me Greqinë. Lidhur me Shqipërinë, duhet të zgjidhet problemi me mijëra shqiptarë të cilët kërkojnë akoma azil në BE. Kjo ndikon në imazhin e vendit dhe për këtë arsye kjo duhet të ndryshojë, por kjo nuk mund të bëhet për një ose dy vite. Për lodhjen nga zgjerimi në BE, për të cilën gjithashtu është diskutuar në Tiranë, sipas komisarit Han është e nevojshme që liderët dhe parlamentet në vendet e Unionit të flasin për qytetarët e tyre, për përfitimet e zgjerimit të mëtejshëm, shkruan gazeta austriake "Kurir".

Përveç VMRO-së, e cila kërkon që dialogu mes partive të zhvillohet në institucionet e shtetit, të gjitha partitë tjera janë pro nisjes së dialogut në shtëpinë e Zhan Monesë në Paris

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 12 nëntor - Me mbarimin e zgjedhjeve lokale dhe me fitoren absolute të partive të partive në pushtet - LSDM, BDI dhe Aleanca për Shqiptarët, Qeveria do ti kthehet kursit të reformave në shumë drejtime si dhe do të nisë me hapat e parë drejt zgjidhjes së çështjes së emrit me Greqinë, por dhe mbylljen e çështjeve të hapura me të gjithë fqinjët. Krejt kjo për të ecur sigurt në rrugën e hyrjes sa më të shpejtë në NATO dhe afrimit të vendit me Bashkimin Evropian. Por që të ndodhin këto, shumica parlamentare vazhdon të jetë e brishtë ndonëse Lëvizja BESA më herët, së fundmi edhe PDSH i kanë dhënë përkrahje Qeverisë për të bërë reformat e nevojshme. Sytë e opinionit tashmë janë drejt VMRO-së, konkretisht tek pozicioni i saj karshi të gjitha prioritetëve që ka shumica parlamentare, sidomos me zgjidhje e kontestit me emrin, hap ky që Maqedonia të fillojë negocia-ta për hyrje në BE deri në vitin 2023, vit kur është planifikuar që vendet e Ballkanit Perëndimor përveç Kosovë të futen në pako në BE.

Në prononcimin e fundit, presidenti i Komisionit Evropian, Zhan Klod Junker përmendi vetëm Malin e Zi dhe Serbinë si vende që do të jenë të gatshme të anëtarësohen në BE në vitin 2023, duke lënë të nënkuptohet se Shqipëria, Maqedonia dhe Bosnja nuk kanë bërë reformat e nevojshme që të ndjekin kursin e integritit siç bënë Serbia dhe Mali i Zi, i cili është edhe anëtar i ri i NATO-s. Siç po shkojnë rrjedhat e zhvillimeve politike, dy do të jenë rrugët që do të ndiqen më tutje - ose të fillojë dialogu i mirëfilltë në vend me opozitën, konkretisht me VMRO-në me 50 deputetë, ose nëse kjo e fundit nuk do të bashkëpunojë - vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme dhe të arrihet shumicë e konsoliduar parlamentare prej 2/3 të numrave në Parlament. Indikacionet janë të qarta se VMRO mund të pësojë një humbje katastrofale siç pësoi në zgjedhjet parlamentare, andaj që të shmangen

Maqedonia para zgjidhjes së çështjes me emrin

# Përveç VMRO-së, të gjithë pro dialogut në Paris



zgjedhjet - VMRO po tentohet që më çdo kusht të kyçet në dialog me pushtetin për zgjidhjen e përbashkët të të gjitha temave të hapura në vend. Në këtë frymë, Bashkim Evropian lajmëroi në organizmin e një tryezë të përbashkët mes të gjitha partive parlamentare në shtëpinë e Zhan Monesë në Paris, ish-ministër francez i Punëve të Jashtme dhe ideatori kryesor i themelimit të Bashkimit Evropian. Ditë më parë, raportuesi për Maqedoni në Parlamentin Evropian, Ivo Vajgell, qëndroi në Shkup dhe pati takim me të gjitha grupet parlamentare duke paralizuar njëkohësisht se deri në fund të janarit të vitit të ardhshëm, përfaqësuesit e partive politike parlamentare të Maqedonisë, ekspertë nga Bashkimi Evropian, në prani të eurokomisionerit për Zgjerim, Johannes Hahn, si dhe përfaqësuesve të Parlamentit dhe Qeverisë franceze, do ta fillojnë procesin e dialogut të ndërsjellë mes pozitës dhe opozitës në Maqedoni të titulluar "Dialogu Zhan Mone", me qëllim të shtytjes së proceseve që kanë të bëjnë me integrimin e Maqedonisë në strukturat euroatlantike. Por nga VMRO menjëherë janë shprehur kritik se ky dialog nuk duhet të zhvillohet jashtë Maqedonisë, por të nisë në institucionet shtetërore. Zëdhënësi i VMRO-së, Ivo Kotevski, tha për gazetën KOHA se partia e tij vazhdon të mbajë qëndrimin se dialogu duhet të zhvillohet në institucionet e vendit, duke e parë të panevo-

jshme të zhvillohet jashtë Maqedonisë. Siç tha Kotevski, për VMRO-në është e papranueshme një Përzihino e dytë apo diçka tjetër jashtë Maqedonisë, duke shtuar se VMRO nuk ka ndonjë informatë të saktë se çfarë do të ndodh në Paris. "VMRO mendon se për çështje të rëndësishme në çdo vend, dialogu mes partive të zhvillohet brenda institucioneve shtetërore dhe për momentin nuk e shih të nevojshme dhe nuk njuh temë tjetër për asnjë lloj tjetër të takimeve. VMRO nuk ka asgjë kundër dialogut, por përsëritje të Përzihinos ose ndonjë teme jashtë Maqedonisë, është e panevojshme dhe e papranueshme. Ne jemi në bisedime me shumicën parlamentare, por preferojmë që ai dialog të jetë brenda institucioneve shtetërore. VMRO ende nuk informacion të saktë për temat që do të diskutohen në Paris dhe në këtë moment - nuk mundemi apriori të prejdukujmë", theksoi Kotevski. Qëndrimi të kundërta me VMRO ka partia tjetër opozitare Lëvizja BESA, deputetë të së cilës konfirmojnë për gazetën KOHA se do të marrin pjesë në Paris, kjo siç thanë ata - për të dhënë kontributin e tyre politik për arrijen synimeve kryesore të Maqedonisë - anëtarësimi në NATO dhe BE. Përveç BESËS, pro pjesëmarrjes në Paris u deklaruan edhe nga Grupi Parlamentar i BDI-së dhe deputetë nga RDK dhe ASH. "Ne patën takim me eurodeputetin Vajgell, të cilit i shprehëm qëndrimin tonë se do të mbështesim këtë

nismë të BE-së", tha shkurt Ejup Alimi, koordinator i grupit parlamentar të BDI-së. Nga ana tjetër - takimi në Paris mes të gjitha partive politike parlamentare është vlerësuar pozitiv nga ekspertë të BE-së në drejtim të asaj se vendi ka nevojë për konsensus të brendshëm politik për të zgjidhur çështje të mëdha politike. Profesori universitar, Bashkim Selmani, mendon se partitë politike kanë nevojë të ndërtojnë një strategji politike për sfidat e ardhës që e tangojnë shtetin. Kjo duhet të ndodh pasi, siç thekson Selmani, partitë politike në qeverisje deri më tani nuk kanë treguar rezultatet e pritura në sferën e integritimeve euroatlantike. "Çështjet mes partive politike parlamentare dhe situatës bashkëkohore, në raportet e tyre komunikuese për sfidat e radhës, kanë nevojë për një dialog dhe strategji më të përafërt në arrijtje e synimeve të përbashkët. E them këtë pasi është konstatuar se sukseset e partive në realizimin e programeve të tyre nuk kanë në nivelin e duhur rezultate që pritëshin, andaj kjo gjendje kërkon një strategji më precize në çështjet nacionale dhe ato ndërkombëtare nga dialogu që do të nisë në janar në Paris, në shtëpinë e Zhan Monesë, pikërisht është një synim i unifikimit të qëndrimeve strategjike në sfidat dhe rreziqet bashkëkohore që në përgjithësi janë të karakterit të përbashkët çështjet që i tangojnë çdo partie dhe shteti përkatës në nivel ndërkombëtar", theksoi Selmani. Ndryshe eurodeputeti Ivo Vajgell pas takimit me përfaqësuesit e partive politike në Shkup nuk e përjashtoi mundësinë që takime të tilla, përveç në Paris, të zhvillohen edhe në qendrat tjera evropiane, por edhe në Shkup. Raportuesi Vajgell, në deklaratën e tij për media, pohoi se kjo iniciativë nuk paraqet as vazhdim dhe as zëvendësim të Marrëveshjes së Përzihinos, por paraqet dialog i cili do ta rriste mirëkuptim dhe do të kontribuonte për funksionimin konstruktiv të Parlamentit të Maqedonisë.

## Visar Ganiu konfirmohet kryetar i Çairit

Shkup, 12 nëntor - Rivotimi për të tretën herë në vendvotimin 2001 në shkollën fillore "Idnina" në Komunën e Çairit ka konfirmuar rezultatin e raundit të dytë, konkretisht Visar Ganiu i BDI-së do të jetë kryetar komune. Dalja e vogël e votuesve, as gjysma sa kishte vendvotimi 2001, ishte vërejtur që në orët e hershme të mëngjesit e deri në mbyllje të kutisë, ku nga 719 votuesit e regjistruar, nuk votuan as gjysma. Edhe vëzhguesit e akredituar kishin konstatuar se rivotimi në Çair u zhvillua qetë dhe pa jehonë të madhe, konkretisht njëjtë sikurse në



dy raundet zgjedhore. Ndryshe, në raundin e dytë në zgjedhjet e 29 tetorit, në këtë vendvotim kanë votuar 278 nga gjithsej 719 votues. Dallimi midis kandidatëve për kryetar komune Zeqirja Ibrahimiri dhe Visar Ganiu ishte 66 vota epërsi për Ibrahimirin. Pas ankesës së pranuar të Lëvizjes BESA për vendvotimin 2001 në Shkollën Fillore "Idnina", në Çair, Gjykata Administrative mori vendim për rivotim, duke e pranuar ankesën. Pas rrethit të dytë të zgjedhjeve, dallimi në vota midis Visar Ganiut nga BDI dhe Zeqirja Ibrahimiri të Lëvizjes BESA ishte 209 vota.



## Shkupi kryeson me ndotje të ajrit

Ajri më i ndoturi ishte dje në mëngjes në orën tetë, ku janë regjistruar përqendrime prej 168 mikrogramësh, ndërsa ndotja ishte e lartë dhe në periudhën prej orës 18 e deri në mesnatë me përqendrime mbi 100 mikrogramë për metër kub



Shkup, 12 nëntor - Në të gjitha komunat e Shkupit, gjatë 24 orëve banorët kanë thithur ajër të ndotur. Stacionet matëse të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në të gjitha stacionet matëse kanë regjistruar përqendrime më të larta të grimcave PM10 më të larta janë shënuar në Lisice. Në stacionin matës në Qendër, vlera më e lartë prej 112,6 mikrogramë për metër kub të grimcave PM10 janë regjistruar në orën 9.00. Në pjesën tjetër të ditës përqendrimet kanë lëvizur nga 70 deri në 105 mikrogramë. Matjet e mëngjesit në këtë stacion tregojnë vlera prej rreth 60 mikrogramë, që është më 50 mikrogramë nga e lejuara për metër kub. Në Gazi Babë, stacioni matës e ka regjistruar vlerën më të lartë prej 140 mikrogramë në orën 18 të mbrëmjes. Më i ndoturi ka qenë ndërmjet orës 15:00 dhe 18:00 dhe nga mesnata deri në orën dy, kur përqendrimet kanë qenë mbi 100 mikrogramë. Ky stacion matës ka regjistruar edhe periudhën nga ora 10 në mëngjes e deri në orën 12 kur përqendrimet kanë qenë brenda intervalit të lejuar. Në Karposh, përqendrimet e grimcave të PM10 kanë lëvizur nga 70 në 168 mikrogramë. Ajri më i ndoturi ishte dje në mëngjes në orën tetë, ku janë regjistruar përqendrime prej 168 mikrogramësh, ndërsa ndotja ishte e lartë dhe në periudhën prej orës 18 e deri në mesnatë me përqendrime mbi 100 mikrogramë për metër kub. Nga mëngjesi i sotëm rreth 60 mikrogramë. Ajri më i ndotur gjatë 24 orëve është regjistruar me Lisicë me 486 mikrogramë për metër kub të grimcave PM10 në orën 18 dhe 452 mikrogramë në orën 19. Nga ora 20:00 deri në orën 2:00 në Lisice, përqendrimet kanë lëvizur mbi 100 dhe rreth 100 mikrogramë. Nga mëngjesi i sotëm janë shënuar përqendrime më të larta dhe janë matur 94, pastaj 84 dhe 82 mikrogramë për metër kub. Në stacionin matës te Rektorati ajri ka qenë i ndotur në periudhën, përveç matja në orën 12 dje pasdite, kur janë regjistruar 28.9 mikrogramë. Nga ora 14 dje dhe deri në orën pesë të mëngjesit, përqendrimet e grimcave PM10 janë mbi 100 mikrogramë. Pra, në Manastir ishte ka qenë i ndotur nga ora 17 e deri në orën një pas mesnate, në Kërçovë nga ora 16 e në orën 20, në Tetovë përqendrimet e grimcave PM10 kanë lëvizur nga 40 e deri në 98 mikrogramë, në Veles ndotja e ajrit ishte mes orës 19 dhe 21, në Koçan prek orës 17 e deri orën 23 dhe në orën 18 orë janë matur 224 mikrogramë të grimcave PM10 dhe në Kumanovë ajri më i ndotur ka qenë mes orës 17 dhe 18. Autoritetet qendrore dhe lokale paralajmërojnë një sërë masash për uljen e ndotjes së ajrit. Qyteti i Shkupit, së bashku me MPB-në, ka iniciuar ndryshime ligjore në kontrollin teknik të automjeteve. Mes masave afatmesme është gazifikimin, si dhe ulja e çmimit të ngrohjes qendrore që të stimulohen qytetarët të kyçen në ngrohjen qendrore. Sipas statistikave në muajt e fundit të vitit edhe janari, ka ndotje më të lartë të ajrit.

Ekonomistët thonë se largimi nga komunikacioni i veturave që deri diku edhe ndotin ambientin, nuk janë të arsyeshme për shkak se veturat me dizel - vetëm 2 përqind emitojnë grimcat e rrezikshme PM10 në raport me dëmin më të madh që shkakton ngrohja e amvisërive, industria dhe prodhimtaria e energjisë

Koha Fisnik Pasholli

Shkup, 12 nëntor - Prej vitit 2019 pritet që në ditët e mëdha të ndotjes - të ketë ndalesë të vozitjes për veturat dizel në Shkup. Një pjesë e madhe e 60 mijë vozitësve në Shkup që posedojnë vetura me karburant dizel, pas dy vitesh mund të goditen nga masat kundër ndotjes së ajrit në Shkup, e sipas së cilëve, do të vendosen ekonjitetet me ngjyrë adekuate dhe do të përjashtohen nga trafiku për shkak të emitimit të madh të gazrave ndotës.

Pritet që në të ardhmen, veturave gjatë kontrollit teknik tu vendoset ngjitëse me tre ngjyra me qëllim që të përçaktohet se cilat vetura sa ndotin ajrin dhe në bazë të asaj - edhe të mund të përjashtohet nga trafiku. Ekonomistët alarmojnë se në kushte të gjendjes së keqe ekonomike dhe fuqisë shumë të ulët blerëse të qytetarëve në Maqedoni, duhet pasur kujdes që gjatë zgjidhjes së problemit me ndotjen të mos revoltohen qytetarët me masa jo të popullarizuara që ju shkurtojnë të drejtën e shfrytëzimit të veturës së tyre personale. Sipas profesorit universitar Neritan Turkeshi, fakt është se ndotja e ajrit paraqet një problem që dëmton shëndetin e qytetarëve dhe duhet të fillojë të zgjidhet gradualisht, megjithatë duhet pasur kujdes që gjatë ndërmarrjes së masave të ndryshme për të zgjidhur këtë problem - të mos rëndojnë buxhetin edhe ashtu të dobët të familjeve në Maqedoni. Sipas tij, largimi nga komunikacioni i veturave që deri diku edhe ndotin ambientin, nuk janë të arsyeshme për shkak se diskriminojnë vozitësit, ndërsa veturat me dizel me vetëm 2 përqind emitojnë grimcat e rrezikshme PM10 që më së shumti rrezikojnë shëndetin e qytetarëve në raport me dëmin më të madh që shkakton ngrohja e amvisërive, industria dhe prodhimtaria e energjisë.

"Analizat e ndryshme tregojnë se ndotja nga veturat nuk është kryesorja në listën e ndotësve të ajrit në Shkup dhe Maqedoni, ku dominon ngrohja nga amvisëritë, industria, prodhimtaria e energjisë,

I padobishëm largimi i veturave dizel nga trafiku

# Masat e kota kundër ndotjes



NERITAN TURKESHI

Analizat e ndryshme tregojnë se ndotja nga veturat nuk është kryesorja në listën e ndotësve të ajrit në Shkup dhe Maqedoni, ku dominon ngrohja nga amvisëritë, industria, prodhimtaria e energjisë, punët ndërtimore e kështu me radhë. Bile, sipas analizave të Ministrisë së Ambientit, në vitin 2014 - sektorët kryesor të grimcave të suspenduara apo PM10, si supstanca më kritike që ndikojnë ndaj shëndetit të njeriut me nga 36 për qind janë ngrohja në amvisëritë, proceset industriale me nga 33 për qind dhe prodhimtaria e energjisë me 20 për qind. Nga ana tjetër, emisionet e grimcave nga komunikacioni marrin pjesë me vetëm 2 për qind



punët ndërtimore e kështu me radhë. Bile, sipas analizave të Ministrisë së Ambientit, në vitin 2014 - sektorët kryesor të grimcave të suspenduara apo PM10, si supstanca më kritike që ndikojnë ndaj shëndetit të njeriut me nga 36 për qind janë ngrohja në amvisëritë, proceset industriale me nga 33 për qind dhe prodhimtaria e energjisë me 20 për qind. Nga ana tjetër, emisionet e grimcave nga komunikacioni marrin pjesë me vetëm 2 për qind", thotë

Turkeshi. Andaj, sipas tij, një masë e tillë e largimit nga komunikacioni i veturave që deri diku edhe ndotin ambientin nuk janë aq të arsyeshme për shkak se diskriminojnë vozitësit në kushte kur qytetarët nuk kanë mundësi të shfrytëzojnë një transport efikas, të shpejtë dhe të lirë për të udhëtuar nga shtëpia deri te vendi i punës dhe anasjelltas.

"Nëse flasim vetëm për në Shkup, paramendoni vetëm rastin e banorëve që

udhëtojnë për çdo ditë me veturë deri në vendin e punës nga Saraji, Haraçina apo Studeniçani... se sa do t'u kushtojë transporti në rast se shfrytëzojnë taksi, sepse shpesh edhe nuk kanë linjë direkte me autobus deri në vendin e tyre të punës. Gjithashtu, ata mund të jenë të detyruar të shfrytëzojnë dy apo tre autobusë duke humbur nga disa orë vetëm për vajtje-ardhje në punë. Me fjalë të tjera, është mirë të ndërmerren masa të ndryshme ndaj ndotjes, por ato duhet të jenë mirë të menduara dhe të analizuar jo vetëm në aspektin teorik, por edhe praktik", thekson Turkeshi. Nga ana tjetër, aktivisti ekologjik Filip Vidinovski, thekson se ndotja enorme në Shkup nuk ndodh verës, por vetëm dimrit që dëshmon se ngrohja dhe faktorët e tjerë dhe jo veturat shkaktojnë këtë problem të madh ekologjik.

"Ndotjet rekorde janë kur është ftohtë dhe jo kur punojnë fabrikat, kur vozisim, ku ndërtohet, kur digjen deponitë... Fabrika, vetura, ndërtimtari dhe deponi ka gjatë gjithë vitit, dhe jo vetëm gjatë dimrit. Nëse eliminohet ngrohja me dru, të gjithë shkaktarët e tjerë të ndotjes si veturat e vjetra dizel, oxhaqet pa filtra, të gjithë deponitë e egra nuk janë të mjaftueshme që ndotja të tejkalojë mesataren e kufijve të kaluar. Nëse nuk adresohet problem i vërtetë i ndotjes që është ngrohja, të gjitha masat e tjera janë të kota, ndërsa sërish do të kemi dimrit një ndotje ekstreme", thekson Vidinovski. Ndryshe, analiza e paralajmëruar do të kategorizojë veturat në tërë Maqedoninë në bazë të gazrave që lëshojnë në atmosferë në bazë të rregullave të Komisionit Evropian.

FILIP VIDINOVSKI

Ndotjet rekorde janë kur është ftohtë dhe jo kur punojnë fabrikat, kur vozisim, ku ndërtohet, kur digjen deponitë... Fabrika, vetura, ndërtimtari dhe deponi ka gjatë gjithë vitit, dhe jo vetëm gjatë dimrit. Nëse eliminohet ngrohja me dru, të gjithë shkaktarët e tjerë të ndotjes si veturat e vjetra dizel, oxhaqet pa filtra, të gjithë deponitë e egra nuk janë të mjaftueshme që ndotja të tejkalojë mesataren e kufijve të kaluar. Nëse nuk adresohet problem i vërtetë i ndotjes që është ngrohja, të gjitha masat e tjera janë të kota, ndërsa sërish do të kemi dimrit një ndotje ekstreme





## Pa ndryshime të ligjeve sistemore, nuk ka reforma në gjyqësor

Fillimisht, avokati Raufi, ngjashëm si profesor Beqiri, vlerëson se puna e Xholevit do të reflektojë në organizimin e brendshëm të gjykatës, e cila për momentin është në një shkallë të lartë të marrëdhënieve të prishura mes gjykatësve

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 12 nëntor - Ndryshimet në sistemin gjyqësor të Maqedonisë, përfshirë edhe lëvizjet e fundit në Gjykatën Penale të Shkupit, nuk mund të ndodhin përderisa korniza juridike e ligjeve sistemore mbetet e njëjtë. Faktin se për përmirësimin e gjendjes në gjyqësor, fillimisht duhet të bëhen ndryshime në Ligjin për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për gjykatës, në një prononcim për gazetën KOHA e ka përsëritur edhe profesori universitar Mitasim Beqiri. Duke e komentuar zgjedhjen e gjykatësit Ivan Xholev për kryetar të ri të GJPSH-së, profesor Beqiri është shprehur skeptik se mund të ndodhin ndryshime thelbësore, për shkak se ai mendon se kaosi në gjyqësor nuk mund të zgjidhet me deklarata politike.

"Kur jemi te çështja shqiptare, e cila lidhet me sistemin gjyqësor në vend, unë nuk e di pse gjykatësit edhe prokurorët shqiptarë nuk prononcohen, pse ato nuk i ndajnë mendimet e tyre, pse heshtin, ose sepse janë pjesë e korrupsionit gjyqësor? Zgjedhja e Xholevit për kryetar të GJPSH-së është vetëm një fasadë. Realisht, korniza ligjore atij nuk i jep shumë hapësirë për veprim. Mendoj se të vetmen punë që mundet ta bëjë Xholevi është që GJPSH-në ta rregulloj përbrenda, në drejtim të mbikëqyrjes se ndarjes së



## Riorganizimi i GJPSH-së, mision i Xholevit

lëndëve gjyqësore. Një kryetar i gjykatës nuk mund të ndikojë te asnjë gjykatës se si duhet ta procedoi një rast, kur ky i fundit kryekëput është i korrupsionar", tha profesori Beqiri. Caktimi i gjykatësit Xholev, në krye të GJPSH-së, vjen në një kohë kur pritet të zgjidhet edhe kryeprokurori i ri, i cili sipas të gjitha gjasave, do të jetë prokurori Lubomir Jovevski. Ndërkohë, kryetari aktual i GJPSH-së, Ivan Xholev, për opinionin është i njohur edhe për përplasjet e vazhdueshme me kolegët e tij brenda Gjykatës, ndryshe të njohur si "ekipi i svarovski gjykatësve". Pjesë e përditshmërisë së GJPSH-së, si palë në më shumë procese gjyqësore, vite me radhë është edhe avokati Naser Raufi, i cili zgjedhjen e kryetarit të ri të kësaj gjykatë e

vlerëson si një vendim të duhur të Këshillit Gjyqësor. Me rëndësi të veçantë në këtë rast, siç thotë avokati Raufi, është se gjykatësi Xholev posedon aftësi të mira organizative dhe çka është më e rëndësishme - Raufi thotë se ndryshe nga të tjerët, ai është guximtar. Fillimisht, avokati Raufi, ngjashëm si profesori Mitasim Beqiri, vlerëson se puna e Xholevit do të reflektojë në organizimin e brendshëm të gjykatës, e cila për momentin është në një shkallë të lartë të marrëdhënieve të prishura mes gjykatësve.

"Gjykatësit e aftë mendoj se përsëri do të kthehen për shqyrtim të lëndëve në Sektorin për krim të organizuar, kurse gjykatësit e caktuar nga Pançevski, pritet t'i procedojnë lëndët për kundërvajtje. Kur jemi te çështja shqiptare në

gjyqësor, jam i mendimit se minimumi që mund të bëhet në GJPSH-ë, është që zëvendësi i kryetarit aktual të jetë shqiptar, në këtë rast gjykatësi Osman Shabani, i cili po ashtu konkurroi për postin e kryetarit. Për momentin, në këtë gjykatë sipas informacioneve që i posedoj, janë të angazhuar vetëm dy gjykatës, respektivisht përveç gjykatësit Shabani, gjykatës tjetër shqiptar është Pajazit Pajaziti", tha avokati Raufi.

Ndryshe, në Sektorin për krim të organizuar në GJPSH-së, nuk figuron asnjë gjykatës shqiptar i cili mund të procedoi lëndë të kësaj natyre. Për t'u përmirësuar kjo situatë, avokati Naser Raufi thotë se minimum duhet të punësohen shtatë apo tetë gjykatës shqiptarë.

"Ekonomist" për kontestet ndërfaqinësore

## Emrat e aeroporteve në Ballkan për të nervozuar fqinjët

"Greqia thotë se emri Maqedoni implikon aspirata territoriale drejt pjesës së Maqedonisë historike, e cila ndodhet në Greqi. Maqedonasit ua rikthyen në vitin 2007, me ndryshim të emrit të aeroportit në Shkup në 'Aleksandri i Madh', të cilin e përvetësojnë të dy vendet. Megjithatë, qeveria e re në Maqedoni dëshiron t'i përmirësojë marrëdhëniet me Greqinë, madje kështu është e mundur që të ketë ndryshim të ri të emrit", shkruan Ekonomist

Londër, 12 nëntor - Javorja britanike "Ekonomist" në tekstin me titull: "Terminale me qëndrim: Riemërimi i aeroporteve ballkanike me qëllim që të nervozohen fqinjët" merret me fenomenin e emrave të rinj të aeroporteve në rajon. Javorja shkruan se "nëpër gjithë Ballkanin po ndërtohen terminale të reja të aeroporteve dhe po emërohen në mënyrë të tillë që t'i nervozojnë fqinjët". "Ekonomist", pohon se "lojën rreth emërimit të aeroporteve e kanë

filluar grekët, me ç'rast aeroporti në Selanik në vitin 1992 i riemëruar në "Maqedoni". "Greqia dhe Maqedonia janë në kontest nga shpallja e pavarësisë së Maqedonisë në vitin 1991. Greqia thotë se emri Maqedoni implikon aspirata territoriale drejt pjesës së Maqedonisë historike, e cila ndodhet në Greqi. Maqedonasit ua rikthyen në vitin 2007, me ndryshim të emrit të aeroportit në Shkup në 'Aleksandri i Madh', të cilin e përvetësojnë të dy

vendet. Megjithatë, qeveria e re në Maqedoni dëshiron t'i përmirësojë marrëdhëniet me Greqinë, madje kështu është e mundur që të ketë ndryshim të ri të emrit", shkruan Ekonomist. "Objekti i ri futurist është hapur në mars në Zagreb, kryeqyteti i Zagrebit. Ai u riemërua sipas Franjo Tugjman, babai i lëvizjes kroate për pavarësi. Ai zhvilloi luftë të ashpër kundër serbëve kroatë, që i mbështeste Serbia dhe të cilët e formuan republikën e ndarë serbe në një të tretën e territorit të Kroacisë e cila ishte jetëshkurtër. Shumica e serbëve u dëbuan nga Kroacia në vitin 1995", shkruan në artikull. "Ekonomist" e përmend edhe shembullin në Kosovë. "Pas 18 viteve nga përfundimi i luftës së Kosovës, edhe më tej nuk mund të fluturoni nga 'Nikolla Tesla' në 'Adem Jashari', në nder të së cilit aeroporti prishtinas e mban emrin nga viti 2010.

Jashari ishte njëri nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili u vra së bashku me një numër të madh të anëtarëve të familjes pas rrethimit serb të strehimores së tij në vitin 1998. Sot, ai është hero i kosovarëve", shkruan gazeta. Javorja njofton se "disa emra nuk janë ndryshuar". "Në Bosnjë, aeroporti sarajevës edhe më tej është 'Sarajevë', si edhe më parë. Tentimi që në vitin 2005 të riemërohet në 'Alija Izetbegović', sipas liderit ushtarak të myslimanëve boshnjakë, veto vendosi prokonsulli ndërkombëtar Padi Eshdaun. Në Podgoricë, aeroporti edhe më tej quhet 'Podgoricë', përveç në shenjën për bagazh. Aje ende qëndron TGD, përkujtim i kohës kur kryeqyteti malazez e mbante emrin Titograd sipas Josip Broz Titos, lider jugosllav, i cili ndërroi jetë në vitin 1980", shkruan "Ekonomist".

### Kronikë

## Gostivar, shantazhohet 18-vjeçarja

Një vajzë 18 vjeçare nga fshati Dobërdoll i Gostivarit, në stacionin policor në Gostivar, ka denoncuar një person nga Tetova për shantazh. Nga Sektorin për Punë të Brendshme në Tetovë informojnë se vajza është ballafaquar me shantazhe dhe kërcënime nga ana e 20 vjeçarit nga Tetova, i cili nëpërmjet porosive dhe telefonatave ka kërkuar prej saj 400 euro, në të kundërtën ka thënë se do të publikojë fotografi të saja. Fotografite me të cilat është shantazhuar vajza janë marrë nga profili i saj në rrjetet sociale. Pas denoncimit, nga policia thonë se është zbuluar identiteti i personit që ka kryer shantazh dhe thuhet se do të ftohet për bisedë në polici. Këtë vit, në rajonin që mbulon SPB Tetovë, janë regjistruar pesëdhjetë raste të keqpërdorimit të të dhënave personale, fotografive, video incizimeve dhe mashtrimeve nëpërmjet rrjeteve sociale. Për këtë arsye, nga SPB Tetovë apelojnë deri te përdoruesit e rrjeteve sociale dhe në veçanti personat e moshave më të reja të jenë të kujdesshëm gjatë shkëmbimit të të dhënave personale, fotografive dhe dokumenteve.

## Një njeri i vdekur në autostradën Shkup-Kumanovë

Në autostradën Shkup-Kumanovë është gjetur një njeri i vdekur, konfirmon MPB. Sipas dëshmitarëve, në vendin ku është gjetur kufoma - nuk ka pasur shenja gjaku e as shenja të frenimit të veturave. Nga MPB thonë se për momentin po marrin masa për zbulimin e shkaqeve prej të cilave ka vdekur njeriu. Më shumë detaje për incidentin, MPB do të jep gjatë ditës së sotme.

## Zhduket 19-vjeçarja nga Studenicani

Arife Kurtishi (19) nga fshati Studenicani, ka humbur. Familjarët thanë për televizionin SHENJA se ajo ka dalë nga shtëpia që nga 05.11.2017 në orët e paradites dhe ende nuk ka asnjë shenjë se ku mund të gjendet. Që nga ajo ditë, policia është vënë në kërkim të saj në çdo qytet të Maqedonisë. Siç u shprehën familjarët, Arifja ka qenë nxënëse e shkëlqyer dhe shembullore dhe nuk mund të kuptojnë arsyet se pse të bëjë një veprim të tillë. Familjarët luten që çdo kush që mund ta takoj ndokund Afiren 19 vjeçare, menjëherë t'i kontaktojë në numrin e telefonit 070/672-640.

(O.XH)



## Kronikë

Qëllon  
bashkëfshatarin

Tridhjetë e shtatëvjeçari L.S., banor i fshatit Çegran të shtunën në orën 15:33 tek vendi i quajtur "Gropa" në fshatin Negotinë-Gostivar, pas grindjes me E.E. (33) nga i njëjti fshat i cili ka kullotur dhen, i është afruar pistoletës deri te pëllëmba e djathtë e E.E. dhe ka shtënë një plumb, me ç'rast e ka plagosur, ndërsa pastaj ka ikur nga vendi i ngjarjes. MPB informon se pas ndihmës së dhënë mjekësore në Qendrën mjekësore Gostivar, E.E. është dërguar në Klinikën për kirurgji plastike në Shkup. Ekspertizë në vendin e ngjarjes nga Sektori për punë të brendshme Tetovë. Arsyeja me siguri paraprakisht është kryer sulm fizik nga ana e E.E. ndaj B.S. (39), vëlla i sulmuesit. Ndërmerren masa për ndriçim të rastit.

Zjarr në një garazh  
në Kumanovë,  
lëndohen dy  
persona

Dy kumanovarë të shtunën mbrëma kanë marrë të djegura nga shkalla e dytë në zjarr në një garazh i cili ka shpërthyer nga shpërthimi i instalimit për gaz të automjeteve. Ministria e Punëve të Brendshme informoi se mbrëmë, në orën 21:10 në Kumanovë në rr. "Nikolla Tesla" është shkaktuar zjarr në një hapësirë ndihmëse-garazh nga shtëpia pronë e M.J. Për shkak të moskujdesit gjatë ndërrimit të gypit për gaz, montimit dhe çmontimit të bombolës së gazit në automjetin "Reno 18" me targa kumanovare, pronësi e T.M. (54) nga Kumanova, ndërsa T.M. dhe A.C. (34) nga Kumanova kanë qenë së bashku në kanalën nën automjet, ka ardhur deri te shpërthimi dhe ndezje të instalimit për gaz të automjetit, me ç'rast brendësia e të njëjtës tërësisht është djegur, ndërsa T.M. dhe A.C. janë marrë të djegura nga shkalla e dytë në duar dhe fytyrë, ndërsa njëherësh është djegur edhe garazhi. Me automjet të Ndhmës së shpejtë mjekësore janë dërguar në Qendrën Mjekësore - Kumanovë për dhënie të ndihmës mjekësore. Zjarr është shuar nga ekip i Njësitit zjarrfikës - Kumanovë. Ekspertizë në vendin e ngjarjes kanë kryer Prokurori publik dhe ekipi i ekspertëve nga Sektori për punë të brendshme Kumanovë.

Theret një i mitur  
nga Shkupi

Një i mitur nga Shkupi është therur me një objekt të mprehtë në shpinë, të shtunën mbrëma në bulevardin "Video Smilevski Bato". Ministria e Punëve të Brendshme informon se mbrëmë, rreth orës 21:30 derisa i mituri B.V. nga Shkupi në bulevardin "Video Smilevski Bato" ka qenë së bashku me disa shokë. Është njoftuar prokurori publik kujdestar, i cili ka dhënë drejtimin që ngjarja fillimisht të trajtohej si - prishje e rendit dhe qetësisë. Po ndërmerren masa për ndriçim të plotë të rastit.

(U.H)

## Oda Ekonomike e Maqedonisë publikon raportin

Prodhuesit e suksesshëm të ushqimit organik në Maqedoni thonë se edhe në këtë degë të re bujqësore mund të arrihet sukses, nëse ajo orientohet në prodhimin cilësor ndaj tregut të jashtëm që duhet së paku të trefishohet, duke iu afruar mesatares sllovene prej 2.5 për qind hektarë

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 12 nëntor - Vetëm 0.5 për qind e tokave bujqësore në Maqedoni janë të mbjella me prodhime organike. Kjo paraqet një sasi shumë të vogël në raport me mundësitë dhe kërkesat e tregut, sidomos atij të huaj për një ushqim të shëndoshë organik. Sipas të dhënave të Odës Ekonomike të Maqedonisë, në shtet janë të regjistruar vetëm 533 fermerë të prodhimtarisë organike, që më së shumti kultivojnë kultura të perimeve dhe të drithërave në një tokë prej afër 3200 hektarë.

Për dallim prej Maqedonisë, që nuk ka asnjë për qind të tokës bujqësore të mbjellë me prodhimtari organike, në Slloveni gati 2.5 për qind e të mbjellave janë me prodhime organike. Vend lider për prodhimin e ushqimit organik është Danimarka, ku mbi 9 për qind e tokës mbillet me ushqim organik. Ky shtet, për çdo vjet ndan nga 50 milionë euro që të stimulojë fermerët të kalojnë nga prodhimtaria tradicionale në atë organike. Nga ana tjetër, konsumuesi më i madh i ushqimit organik në botë është Gjermania, me një treg të vlefshëm 8 miliardë euro.

Agronomët thonë se ardhmëria e prodhimtarisë bujqësore është te prodhimtaria organike që se vjen e më shumë do të kërkohet në treg, për çka Maqedonia ka kushte ideale. Prodhuesit organik thonë se prodhimet e tilla kanë një treg të garantuar, por me kusht që fermerët të respektojnë rregullat rigoroze të kultivimit dhe të kenë durim që pas disa vitesh të presin fitimin.

Në ndërkohë, prodhuesit e suksesshëm të ushqimit organik në Maqedoni thonë se edhe në këtë degë të re bujqësore, mund të arrihet sukses nëse orientohet në prodhimin cilësor ndaj tregut të jashtëm që duhet së paku të trefishohet, duke iu afruar mesa-

Prodhimet organike,  
ardhmëria e bujqësisë

tares sllovene prej 2.5 për qind hektarë.

"Ardhmëria e bujqësisë në Maqedoni është orientimi ndaj cilësisë së lartë dhe prodhimin të specializuar dhe jo ndaj kuantitetit. Evropa kërkon prodhime organike dhe të shëndosha që mund të prodhohen tek ne. Me fjalë të tjera, prodhimtaria organike mund të jetë ardhmëria jonë nëse dëshirojmë që nga bujqësia të krijojmë një biznes me fitim të lartë si dhe diçka dalluese nga shtetet e tjera.", thotë Suzana Dimitrievska nga Sveti Nikola që eksporton groshën e saj organike në Zvicër. Sipas saj, në vitet e fundit tregu i prodhimeve organike është rritur në mbi 90 miliardë euro, që kryesisht furnizohet nga Evropa Lindore dhe juglindore. Kjo duhet të paraqesë një stimulim edhe për prodhuesit vendor që të orientohen në prodhimtarinë organike, për shkak se kanë plasman të sigurt të prodhimeve të tyre.

Probleme e tjera të prodhimtarisë organike në Maqedoni, janë edhe fakti se një ushqim i tillë ka afat të shkurtër të zgjatjes ndërsa nuk ekziston obligim ligjor për përpunimin e prodhimtarisë organike në prodhim të konservuar apo të tharë. Agronomët thonë se


ardhmëria e prodhimtarisë bujqësore është te prodhimtaria organike që sa vjen e më shumë do të kërkohet në treg për çka Maqedonia ka kushte ideale.

"Tregu i ushqimeve organike është i garantuar, ndërsa një prodhimtari e tillë ka perspektivë, por megjithatë prodhuesit nevojitet të jenë mjaft të disiplinuar dhe duhet t'u përmbahen të gjithë rregullave strikte të një prodhimtarie të tillë, duke filluar nga procedurat e caktuara për certifikimin e tokës, organizim mjaft specifik të punë duke filluar prej blerjes së rasatit, kultivimit e kështu me radhë, ku nuk guxohet prej fillimi deri në fund të bëhet as lëshimi më i vogël që do të shkel standardet e prodhimtarisë organike", thonë agronomët. Gjithashtu, prodhuesit organik duhet të kenë më shumë durim lidhur me fitimin që nuk mund të vijë menjëherë, por pas dy apo tre viteve. Gjithashtu eksporti i prodhimeve organike kërkon procedura të ndërlikuara dhe që kushtojnë, por megjithatë për shkak të plasmanit të sigurt të prodhimeve organike ia vlen të ndërmerret një hap i tillë i orientimit në prodhime bujqësore që kanë shitje të sigurt jashtë shtetit.

Në ndërkohë, në vitet e kaluara në Maqedoni janë kultivuar në mënyrë aromatike dhe bimë aromatike dhe shëruese, pemë, perime, drithëra, lopë, dhen, dhi dhe bletë. Ndryshe, sipas Ligjit për prodhimtari organike në Republikën e Maqedonisë për një hapësirë konvencionale që të bëhet organike nevojiten 2-3 vite. Dy vite janë të nevojshme për kulturat njëvjeçare, ndërsa tre për shumëvjeçaret, siç janë vreshtat dhe pemëtaria. Gjatë kësaj periudhe kohore duhet të jetë e pastruar toka nga helmet e shkaktuara nga prodhimtaria konvencionale. Qëllimi kryesor i prodhimtarisë organike është ruajtja e mjedisit, pjelloria e tokës dhe ruajtja e konsumatorëve nga efektet e ndryshme që vijnë nga pesticidet në prodhimtarinë intensive.

Arritja e gjithë kësaj që përmendëm më lart, mund të arrihet në qoftë se përmeshen disa parakushte që kërkohen, duke filluar nga parakushti i parë që është ngastra apo vendi ku kultivohet produkti, i cili duhet të jetë larg objekteve industriale, larg rrugëve që ka qarkullim të madh të makinave, gjithashtu duhet të ketë ujëra nëntokësore të cilat duhen të jenë të pastra etj.

## Mbyllen 13 objekte hotelerike në Shkup



Shkup, 12 nëntor - Në bazë të analizave të përgatitura më herët dhe njohurive operative, MPB gjatë natës së mbrëmshme ka realizuar kontroll në 13 objekte hotelerike, ku kanë konstatuar se nuk respektohen dispozitat ligjore në lidhje me orarin e punës, ofrimin të alkoolit në vende ku ka të mitur dhe mos dhënie të llogarive fiskale. "Në tetë objekte hotelerike është eviden-

tuar prezencë e personave të mitur, ndërsa janë arrestuar katër të mitur. Dy prej tyre për përdorim të lëndëve narkotike, ndërsa dy për vërtetim të identitetit", ka deklaruar zëdhënësi i MPB-së, Toni Angellovski. Për shkak të parregullsive të konstatuara, janë mbyllur 13 objekte hotelerike, ndërsa në edukim janë ftuar pesë pronarë të objekteve hotelerike, informojnë nga

MPB. Mbrëmë është realizuar edhe aksion i përfortuar kontrolli në lidhje me drejtimin e makinave në gjendje të dehur, ku është vërtetuar se 272 vozitës janë kontrolluar nga alkotesti dhe tek 102 vozitës është vërejtur prezencë e alkoolit. Nga MPB informojnë se janë konstatuar edhe 49 shkelje të tjera, për çka janë shqiptuar 12 gjoa mandator dhe 37 gjoa me pagesë.



Autostradat të pasigurta

Numri më i madh i këtyre aksidenteve kanë ndodhur në autostradën Gostivar – Tetovë - Shkup, aksidente këto të cilat fatmirësisht kanë përfunduar pa persona të vdekur, vozitës dhe bashkudhëtarë të lënduar rëndë

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 12 nëntor - Në dhjetë muajt e këtij viti, në rajonin më të gjerë të Tetovës gjithsej kanë ndodhur 54 aksidente komunikacioni të shkaktoar nga kafshët, para së gjithash nga qen endacak. Numri më i madh i këtyre aksidenteve kanë ndodhur në autostradën Gostivar – Tetovë - Shkup, aksidente këto të cilat fatmirësisht kanë përfunduar pa persona të vdekur, vozitës dhe bashkudhëtarë të lënduar rëndë. Por, përsëri në secilin prej këtyre aksidenteve është shkaktoar dëm material nga 10 deri në 30 mijë, gjegjësisht 40 mijë denarë, varësisht automjetit, forcës së goditjes dhe rrethanave të tjera. Më shumë aksidentet kanë ndodhur si pasojë e lëvizjes së pakontrolluar të kafshëve në rrugë, për shkak të pasigurisë së rrugëve me mburojë adekuate ose në mënyra të tjera. Këto aksidente, si zakonisht, kanë ndodhur në orët e mbrëmjes ose në orët e hershme të mëngjesit, në të shumtën e rasteve në afërsi të daljes për në fshatin Kamjan, në afërsi të Grupçinit si dhe në disa vende të tjera. Këto aksidente, pa përjashtim, si rezultat kanë pasur ngordhjen e këtyre kafshëve që janë përfshirë në aksidente. Duke marrë parasysh të dhënat se gjatë një viti në Pollog regjistrohen mbi njëqind aksidente me kafshë, Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, apelon deri te vozitësit për një vëmendje maksimale

## Për dhjetë muaj, 54 aksidente nga kafshët



kur lëvizin në autostradë, ndërsa deri tek organet kompetente apelohej që të ndërmarri masa konkrete, me qëllim që të pengohet qasja dhe lëvizja e lirë e kafshëve në rrugë. "Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë sërish apelon deri te vozitësit që të jenë jashtëzakonisht të vëmendshëm dhe kujdesshëm si dhe të përshtatin shpejtësinë me kushtet e rrugës, kjo sidomos vlen për në orët e natës, për arsye se gjatë natës mundësitë për të hasur në ndonjë kafshë në rrugë janë më të mëdha, për shkak se në shumë vende gardhet e hekurta të autostradës janë të dëmtuara dhe nuk janë funksionale.

Vitin e kaluar, rikujtojmë se 118 aksidente në rajon janë shkaktoar nga kafshët, shumë prej tyre në këtë autostradë", deklaroi Josifovski. Profetori universitar, Vullnet Palloshi, thotë se është obligative që shteti apo ndërmarrija përgjegjëse që të mirëmban rrugët dhe autostradën. "Ata kanë obligim që çdo pesë vjet të bëjnë rikonstruimin, rinovimin dhe

rregullimin e të njëjtës. Por, gati se 15 vite nuk është bërë asgjë në këtë drejtim, prandaj edhe është në atë gjendje kjo autostradë, që ka shumë dëmtime. Obligim i ndërmarri është që të mirëmbajë gardhin përgjatë autostradës, me qëllim që të pengojë hyrjen e kafshëve. Obligim ligjor është mirëmbajtja e sinjalizimit vertikal dhe horizontal. Mirëmbajtja e gardhit apo korsisë në mes të autostradës. Po ashtu, duhet të mirëmbahet edhe asfalti, sepse ka plasaritje, gropa dhe deformime të tjera që në masë të madhe e vënë në rrezik jetën e vozitësve. Po ashtu, pjesë e mirëmbajtjes janë edhe mburojat prej metali përgjatë autostradës që janë të dëmtuara si dhe shtyllat ndriçuese që përkufizojnë fundin e rrugës, të cilët nuk janë funksionale", thotë Vullnet Palloshi.

Autostrada Tetovë-Shkup, me një gjatësi prej rreth 40 kilometra, ka shumë pika të zeza të cilët janë ankth i vërtetë për vozitësit, sidomos në vendin e quajtur Karpallëk, ku rruga është dëmtuar

që nga viti 2001, ndërsa edhe në hyrje në Saraj gjendja aspak nuk është më e mirë. Krahas këtyre pikave të zeza, pjesë e tmerrshme vazhdon të jetë rruga afër Grupçinit, sidomos në pjesën te nënkalmi për në Debërcë, ku ndodhin më shumë aksidente me kafshët për shkak të mungesës së mburojave prej metali. Aspak më mirë nuk është situata në autostradën Tetovë-Gostivar, ku për çdo ditë ka aksidente të kësaj natyre, për shkak të mungesës së mburojave përgjatë autostradës. Të njëjtat, sipas autoriteteve, shpesh herë vendosen, por ka raste edhe kur ata largohen ose grabiten nga hajnat për përfitime materiale. Së fundi, ka filluar një pjesë e autostradës nga Shkupi për në Tetovë të rikonstruohet, por sa do të zgjasë kjo dhe sa do të përmirësojë gjendjen, pritet të shihen në të ardhmen. Pikërisht nga moskujdesi dhe mos mirëmbajtja e kësaj autostrade, ka bërë që brenda vitit të ndodhin mbi 150 aksidente, ndërsa vetëm në vitin 2016 ka pasur tre viktima.

## Përkujtohet dëshmorit i kombit Visar Sinani

Në nder të 10 vjetorit të rënies heroike të dëshmorit Visar Sinani, në varrezat e qytetit në Tetovë janë bërë homazhe në varrin ku prehet trupi i dëshmorit, ku është përkujtuar jeta dhe vepra heroike e Visar Ramadan Sinanit, i cili ra dëshmorë në aksionin policor "Stuhia Malore" në Brodec të vitit 2007. Në ceremoninë e nderimit të veprës së dëshmorit Visar Sinani përveç familjarëve, të afërmeve, ka marrë pjesë edhe zëvendëskryeministri Hazbi Lika, kryetari i Shoqatës së veteranëve të luftës Fazli Veliu, Fatmir Limani si dhe shumë bashkëveprimtarë dhe miq të familjes Sinani. Sipas pjesëmarrësve në këto homazhe, Visar Sinani u vra si bartës i idealeve të lirisë së shqiptarëve të robëruar, vepra e tij si dhe e shumë dëshmorëve të tjerë do të përkujtohet ndër breza pasi që ata tanimë kanë një vend të merituar në historinë më të re të kombit shqiptarë.

## "Stop and go" me lojë shpërblyese

Kompania për shitjen dhe servisimin e gomave "Stop and Go" zyrtarisht ka filluar me organizimin lojës së madhe shpërblyese "Bli goma dhe vozit", ku për çdo gomë të blerë të brendeve Hankok dhe Laufen bëhesh fitues potencial i një makine Citroen C3 të ri si dhe fitues i shumë shpërblyeseve të tjera. Sipas organizatorëve, qëllimi i këtij aktiviteti është promovimi i gomave të brendit Hankok, goma këto të vlerësuar si më të sigurtat në treg. Përndryshe kompanie "Stop and Go" është importues i autorizuar i markave Hankook, Laufenn, Pirelli dhe Goodyear. (U.H)

Këtë vit janë kapur 700 qen endacak

## Dëmshpërblimi nga kafshimi i qenve shkon deri 90.000 denarë

Drejtori i Ndërmarrjes Publike "Higjiena Komunale", në Shkup, Rakip Doçi, thotë se prej 1 janari e deri në këtë periudhë, nëpër rrugët e kryeqytetit janë kapur mbi 700 qen endacak

Shkup, 12 nëntor - Qentë endacak janë rrezik për qytetarët e Shkupit, të cilët thonë se shpesh po ndodhë që ata të sulmohen dhe kafshohen. Për vitin vijues ende nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e personave të cilët janë kafshuar nga qentë e rrugës, ndërsa sipas statistikave të Klinikës Infektive, vitin e kaluar të kjo Klinikë janë regjistruar mbi 520 pacientë të kafshuar, ndërsa nuk ka të

dhëna se sa prej tyre janë kafshuar nga qenë të rrugës. Drejtori i Ndërmarrjes Publike "Higjiena Komunale", në Shkup, Rakip Doçi, thotë se prej 1 janari e deri në këtë periudhë - nëpër rrugët e kryeqytetit janë kapur mbi 700 qen endacak. "Në Qytetin e Shkupit deri në këtë periudhë janë kapur mbi 700 qen endacak, të cilët kanë kaluar trajtimin në Qendrën për stacionim që gjendet në 'Vardar-

ishte'. Pasi të kapen, shërbimi veterinarik bën kontrollimin e tyre dhe u bëhet trajtimi i nevojshëm. Një pjesë e tyre trajtohen nga parazitë të ndryshëm, një pjesë e tyre eutanazohen, një pjesë adaptohen nga persona që i duan qentë endacak", tha Doçi. Strehimi i përkohshëm i qenve në strehimorin "Vardarishte" ka filluar në vitin 2007 dhe i njëjti kapacitet për strehimin e 100 qenve në ditë. Gjatë vitit 2015 janë kapur rreth 1800 qen, ndërsa gjatë vitit 2014 - rreth 2200 qen endacak. Qyteti i Shkupit dhe Higjiena Komunale paguajnë dëmshpërblim për qytetarët e kafshuar nga qentë e rrugës dhe të

cilët më pas kanë paditur në Gjyq. Autoritetet e qytetit thonë se brenda vitet ka dhjetëra padi nga qytetarët që janë sulmuar nga qentë. Për kafshim, qytetari mund të kërkojë dëmshpërblim të cilën e ndajnë në mënyrë solide NP "Higjiena Komunale" dhe Qyteti i Shkupit. Nëse rasti shkon në procedurë gjyqësore, praktika tregon se qytetari për dhimbje të shkaktoara fizike në trup mund të marrë dëmshpërblim prej 35 mijë denarësh, për panik dhe frikë 30.000 denarë, për dhembje shpirtërore prej të cilave ka ndaluar aktivitetet jetësore - 20.000 denarë dhe për shpërbllim - 5000 denarë ose gjithsej



merr 90.000 denarë. Ndryshe, ditë më parë, kreu i ri i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov së bashku me Shoqatën për mbrojtjen e kafshëve "Anima Mundi" e vizituan Qendrën për trajtim human të qenve të rrugës "Vardarishte". "Qëllimi ynë është t'i shohim kushtet, mënyrën se si është përkujdesja e qenve endacakë, t'i përmirësojmë kushtet për kafshët që janë të stacionuar këtu për shkak të periudhës së

dimrit dhe të bëjmë një koordinim, unë si kryetar, të punësuarit këtu dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të gjejmë një zgjidhje optimale për një mënyrë më moderne dhe më humane të strehimit të këtyre kafshëve. Jam i kënaqur që këtu janë përfaqësuesit e sektorit civil, sepse me ta kemi ndërmend ta rregullojmë mënyrën dhe sistemin e funksionimit të kujdesit të qenve të pastrehë", tha Shilegovi. (A.Xh)



Intervista me vetveten

**Erdhi koha që Himara u nda: Himara bregdetare mbeti e lirë dhe e krishterë, kurse Himara e brendshme, Labëria, Kurveleshi, Lumi i Vlorës e Dukati u myslimanizuan dhe u ndanë. Megjithëse u ndanë në dy fe nuk e humbën kurrë lidhjet e gjakut dhe të fisit**

Petro MARKO

Pra ç'jemi ne? Shqip-tarë! Po pse e humbëm gjuhën? Unë do të them ato që di: Pse nënat plaka, gjyshët dhe gjyshet dinë më mirë shqipen se greqishten? Pse qajmë e këndojmë në shqip? Pse fjalët e urta i themi në shqip? Siç duket që nga viti 1820 e këtej, greqizimi u bë me qëllim politik nga vetë Greqia, që fitoi lirinë me gjakun e shqiptarëve, qoftë në Mesolongji, qoftë në revolucionin grek. Suli dhe Himara ishin shqiptarë, po dy krahina autonome që nuk njihnin as Greqinë, as Shqipërinë, së cilës i kishte humbur edhe emri. Suli dhe Himara ishin kurdoherë në luftë me turkun.

Erdhi koha që Himara u nda: Himara bregdetare mbeti e lirë dhe e krishterë, kurse Himara e brendshme, Labëria, Kurveleshi, Lumi i Vlorës e Dukati u myslimanizuan dhe u ndanë. Megjithëse u ndanë në dy fe nuk e humbën kurrë lidhjet e gjakut dhe të fisit. Çdo



fshatar kishte të tijtë në një fshat të myslimanizuar që në kohën e Ali Pashë Tepelenës. Kur bëheshin operacione ndëshkimore nga turqit, bregasit nuk shkonin përtej maleve, në Mesaplik e në Kurvelesh, për t'u mbrojtur, siç bënin gjer në atë kohë, por iknin me varka për në Korfuz ose për në Gjirit, nën mbrojtjen e venecianëve. Aty shkonin pleq e plaka dhe fëmijët. Burret luftonin. Aty rrinin shumë vjet, gjersa mbaronin operacionet ndëshkimore. Thonë se banorët e Dhërmiut shkonin në ishullin grek, kurse ata të

Himarës në Gjirit. Prandaj dhe, kur flasin greqisht, dhërmijazit flasin si korfjanët, kurse himarjotët, si gjiritlinjtë. Pastaj shkollat ishin greke. Mesha këndohej greqisht, tregtinë e bënë me Korfuzin, Janinën. Pak nga pak u shkëputen lidhjet me Labërinë, me Dukatin. Greqia, që u çlirua e para, thoshte se kudo ku janë ortodoksë, janë grekë; myslimanët janë turq. Nisi antagonizmi turq e kaurë! Propaganda bënte punën e saj. Kjo u thellua në kohën e Ali pashë Tepelenës, i cili dërgoi një delegacion në Himarë, që dhe

Himara të myslimanizohej. Paria e Himarës delegacionin e priti në Qeparo, se kishte më shumë kapedanë. Delegatët e Ali pashë Tepelenës u thanë mendimin dhe qëllimin e vizitës. Më plaku i kuvendit himarjot u tha delegatëve:

– E falënderojmë pashanë, që mendon për të mirën tonë. Po i thoni pashait se këtu poshtë, në fshat, kemi një fushë që s'ka ujë. Thahet në verë dhe nuk na jep asgjë. I jemi lutur Krishtit dhe Shën Mërisë, Shën Kozmait dhe Shën Spiridhonorit, po s'na dhanë ujë. Në

na dhëntë Muhamedi ujë, menjëherë bëhemi myslimanë. Kështu i thoni pashait. Kur vajtën e ia thanë pashait përgjigjen e bregasve, ai qeshi me zemërim dhe tha:

– Eh kaurët e dreqit, do të ma paguajnë!

– Pastaj, duke qeshur: – Pizevengët, janë të zgjuar, s'ke ç'thua, janë rrufjanë të mëdhenj!

Pak nga pak propaganda greke bëhej më e madhe, duke pretenduar se Himara ishte krahina heroike e Greqisë. Shumë kapedanë, sidomos paria, kishin privilegje. Dhe paratë e mirëbërësve hi-

marjotë, që i kishin lënë në bankat greke për shkollat e Himarës, ishin një shkak shumë serioz për propagandën greke. Gjithë Bixhili nga Dhërmiu kishte fituar shumë para në Rusi, ku e kishte marrë Pano Bixhili, përfaqësues i himarjotëve pranë Carit, në Petërsburg. Mësuesit dhe shpenzimet për shkollën merreshin nga fondi i Gjithë Bixhilit. Gjithë Bixhili ndërtoi dhe një shkollë, që është sot e kësaj dite. Ne kur ishim të vegjël, në shkollën e fshatit shihnim portretin e tij, të varur në klasë. Siç i la Gjithë Bixhili paratë në bankën greke, ashtu i lanë dhe shumë mirëbërës të tjerë nga Jugu, si Zhapa me shokë. Ishin miliona, të cilat u bënë burim për të ushqyer propagandën greke në vendin tonë, sa u krijua miti i Vorio Epirit dhe sillogu vorioepirit, që merrej me çlirimin e Vorio Epirit, domethënë të Shqipërisë së Jugut. Paratë u vunë në dispozicion të parisë, e cila merrte një mijë dhe shpenzonte një...

Paria merrte para nga banka greke, e cila qe e autorizuar nga qeveritë reaksionare nacionaliste të Megali Idheja (Megali Idheja: që Greqia të behej e madhe duke përfshirë në kufijtë e saj jugun e Shqipërisë dhe vendet ballkanike ku janë ortodoksë). Himarjotët që emigronin në Greqi, kishin privilegje: përkraheshin si bij të një "krahine heroike greke" me histori trimërie e burrërie. Fatkeqësisht ishte se Shqipëria u çlirua e fundit në Ballkan. Himara kishte ushqyer shpirtin e aneksartisë, autonomisë, si Suli, i cili pak nga pak u

# Kryeministrat shqiptarë të Perandorisë Osmane

**Në shekullin XVIII, numri i vezirëve shqiptarë në Pallat u shtua aq shumë sa debatet e vezirëve në Kubbealltë Divani Humajun (Këshilli Kryeministor Perandorak në Portën e Lartë), në vend të osmanishtes, zhvilloheshin në shqip**



Në periudhën e Fatih Sulltan Mehmetit II, kryeministri i parë shqiptar u caktua vlonjati Gedik Ahmet Pasha. Ahmet Pasha, i cili doli në plan të parë me dobitë që solli në fushatat e Akonjunllu dhe Karaman, si dhe në betejën e Otlukbeli, ra në sy me arritje të tilla, si bashkimi i Krimesë me Osmanët, aneksimin e bregdetit shqiptar në tokat osmane dhe, më në fund, sundimin e Kanalit të

Otrantos në thembër të çizmes italiane. Pas Gedik Ahmet Pashës, në ekipin e Sulltan Sulejmanit të Madhërisë (Ligjvënësit) shohim si vezir të Madh/Kryeministër përsëri një vlonjat, Ajas Pashën, i cili u ul në postin kryeministor më 942 H/1535-36 me Dekret Perandorak. Vdiq më 26 Safer 946/13 – Korrik 1539. Varrin e ka në

Ejup Sulltan, në anë të majtë të portës hyrëse, nga ana e Haliçit ose Bririt të Artë. Pas Ajas Pashës, si zëvendës i tij, u caktua përsëri një shqiptar, Lutfi Pasha nga Shkodra. Çiraku me gradën Aga në Oborrin Mbretëror, Lutfi Pasha, pati arritur më parë funksionet e nëpunësisë (çuhadarllëk) dhe korrierit (myteferrika). Pati marrë përsipër, me radhë, de-

tyrat e kryegjellëtarit (çashnigirbashë) dhe beut të flamurit (mirallaj).

I ngjitur në postin e sanxhakbeut, Lutfi Pasha, pati kryer funksionet e sanxhakbeut të Kastamonu-së, Ajdinit dhe Janinës. Më pas qe emëruar në funksionet e sanxhakbeut të Karamanit, Damaskut (Sirisë) dhe Rumelisë. Në vitin 936 H/1529-30, Sulltan Sulejmani e martoi Lutfi

Pashën me të motrën Shah Sulltan. Në vitin 946 H, Lutfi Pasha u bë kryeministër në vend të Ajas Pashës. Ndërsa ishte në pension, në çifligun e tij në Dimetoka, meqë kishte arsim medreseje, shkroi më se 20 vepra në arabisht dhe osmanisht. Ai mori famë me veprat në osmanisht "Historia e Dinastisë Osmane" (Tevarih-i Al-i Osmani) dhe "Kryeministrologji" (Asafname), të dyja të botuara. Në gjysmën e dytë të shekullit XVI, në postin e kryeministrit u ngjiten shqiptarët Ferhat Pasha dhe ngadhënjyesi i Jemenit, Koxha Sinan Pasha. Në shekullin XVI, shqiptarët u bënë kasta më e fuqishme e administratës ose burokracisë së Portës së Lartë. Edhe guvernatorët dhe qeveritarët e tjerë të vilajeteve dhe qendrave administrative, si Halepi, Damasku, Egjipti, Budini, Morea, etj., ishin shqiptarë. Mes tyre, më i shquari pati qenë bejlerbeu (valiu) i Budinit (Hungari) dhe Damaskut (Siri), Mustafa Pashë Plaku.

I dalë nga Shkolla e Pallatit Perandorak "Endërun-i Humajun", Mustafa Pashë Plaku u bë bej i Janinës. Pastaj u bë bej i Rodosit dhe më 926 H (1520), Kapiten i Marinës. Pasi u martua me një zonjë haremi me emrin "Shah Huban", u ngjiti në postin e vezirit. Pas kësaj, u bë bejlerbej i Budinit. Në vitin që u bë edhe bejlerbej i Damaskut (Sirisë) më 939 H (1531/2), u largua nga detyra. Pastaj shkoi në Egjipt, ku kaloi pleqërinë i tërhequr në vetmi. Më në fund, në vitin 940 H (1533/4) u kthye në Stamboll, vit në të cilin vdiq. Varrin e ka në varrezën e Ejup Sulltanit. Ai ka lënë një xhami dhe medrese në Gelibollu. I biri, Ahmet Bej, ka vdekur si bej i Estergonit. Kurse xhamia e Mustafa Pashë Plakut, që ndodhet në Serez të Greqisë, sot është në gjendje të rrënuar dhe me minare të shembur.

Disa nga shqiptarët që kanë mbajtur postin kryeministor në shtetin osman: Gedik Ahmet






Historia tronditëse

## Shqiptari që fitoi 17 milionë dollarë, por vrau të dashurën!

**Emri i autorit të vrasjes ishte Gjelosh Rukaj, i njohur si Joe Rukaj. Ai merrej me prona të patundshme dhe pati fatin të fitonte 17 milionë e gjysmë dollarë në Lotarinë e Nju Jorkut**



greqizua. Dhe, pasi u çlirua Shqipëria, me kufijtë të cinguar shumë, propaganda greke e ushqeu shumë idenë e autonomisë së Himarës: as shqiptarë, as greke! Kishte hedhur rrënjë të thellë kjo propagandë në shpirtin e himarjotëve, të cilët sytë i mbanin nga Greqia.

Krerët himarjotë, si Spiro Miloja, një luftëtar që e ndihmoi shumë Greqinë, ishte në krye të kësaj propagande, me gjithë farefisën dhe sojin e tij të përndarë në Dhërm, Vuno e gjetkë. Spiro Miloja ishte nga Progonati. Në fshatin tonë ai kishte farefis Llukë Zh. e të tjerë, që propagandonin ndarjen e Himarës nga Shqipëria. Si bazë kryesore të propagandës përdornin dhe këtë: Pse Labëria u bë turke? E pse te mos bëhemi edhe ne me Greqinë, që është armike e betuar e Turqisë, siç jemi dhe ne armiq të betuar të turkut. Shumë fanatikë ishin fshatarët e mi! Njëzet e gjashtë kisha kishte. Mbjaj mend unë se kishte tetë priftërinj. Lidhjet ekonomike, privilegjet në Greqi, interesimi i Greqisë për himarjotët, sillogu vorioepiriti ndikuan shumë për t'i bërë himarjotët t'i kthenin sytë nga Greqia dhe të ëndërronin për një autonomi. Pastaj, edhe në kohën e pavarësisë himarjotët panë se asnjë qeveri e Tiranës nuk u kujdesua asnjëherë për ta. Nuk shkonin as xhandarë dhe nuk merreshin në asnjë punë. Ata pëlqyen të mërgonin: herën e parë në Llavri, ku kishte miniera; në Korint, për të hapur kanal; në Vllahi, në Rusi, pastaj në Amerikë, në Francë, në Meksikë, në Argjentinë, në Australi, Kanada e gjetkë. Kështu ne dinim më mirë ku binte Buenos Airesi sesa Kukësi, që nuk ia kishim dëgjuar kurrë emrin. Dinim ku binte Australia dhe jo Kosova, që nuk ja kishim dëgjuar kurrë emrin. Dinim ku binte Athina dhe Korfuza ose Tirana e Shkodra. Ishim pa asnjë lidhje me atdheun tonë. Disa përçarës, vetë regjimi i Zogut, sidomos Musa Juka, na përçau. U ndamë në fshat në dy parti: pendëkuqet që deshën Shqipërinë dhe shkollat shqipe; dhe pendëbardhët, që deshën Greqinë e shkollat greke në fshat. Këtë përçarje e ushqeu shumë Musa Juka, duke na armiqësuar vëlla me vëlla.

Familja jonë bënte pjesë në partinë e pendëkuqeve dhe mbanim në ballkon kurdoherë flamurin e Shqipërisë. Kapedanët e Spiro Milos na kishin ardhur disa herë në shtëpi, duke na thënë se Andrea Deshën që ne të linim shtëpinë e të shkonim në Korfuz, ku do të na mbante me shkolla e me pensione Athina. Qoftë im vëlla, Fotoja, qoftë kushëri im Jani, i sikterisnin duke u thënë: "Andrea Markoja u vra për Himarën dhe Marko Jani vdiq i veremosur nga internimet dhe vuajtjet e shumta për Himarën dhe jo për Greqinë. Himara sot është dhe mbetet shqiptare. Prandaj mbajmë dhe flamurin ditë e natë në ballkon. Ne e dimë gjakun tonë se nga buron".

*(Pjesë e shkëputur nga libri i "Intervistë me vetveten")*

Pasha, Ajas Pasha, Lutfi Pasha, Kara Ahmet Pasha, Ahmed Pasha (dhëndri i Rustem Pashës), Ferhat Pasha, Koxha Sinan Pasha, Yemishçi Hasan Pasha, Hasan Pashë Ohri, Mere Hysen Pasha, Jassi Mehmed Pashë Tabani, Kara Mustafa Pashë Qemaneliu, Kara Murat Pasha, Ahmet Pashë Trahanalliu, Mehmet Pashë Qypryliu, Fazil Ahmet Pashë Qyprylizadeliu, Mustafa Pashë Qyprylizadeliu, Arabaxhi Ali Pashë Ohri, Amxhazade Hysen Pasha, Dalltaban Mustafa Pasha, Numan Pashë Qyprylizadeliu, Damat Hasan Pashë Toska nga Moreja, Haxhi Halil Pasha, Ivaz Mehmet Pasha, Ivazzade Halil Pasha, Arnavut Haxhi Memish Pasha, Dervish Mehmet Pasha, Mustafa Naili Pasha, Mehmet Ferit Pashë Vlora, Sait Halim Pasha nga Kavalla.

Veçanërisht shekujt XVII-XVIII, ishin periudhat kur administratorët vezirë me nëpunësit shqiptarë të Pallatit Osman ishin të pandarë nga njëri-tjetri. Në qendrat, si Budin, More, Janinë, Varnë, Halep, Damask, Humus, Ruha, Kajro, Jeruzalem, Bejrut, Jemen, Erzurum, Dijarbakër, Trablusgarp, etj., kryesonin përgjithësisht guvernatorët dhe administratorët shqiptarë. Krahas kësaj, në shekullin XVII, personalitete si Mustafa Koçi, i cili mori famë me Traktatin, që ia ofroi Sulltan Muratit IV, dolën në plan të parë me veprat e tyre.

Në shekullin XVIII, numri i vezirëve shqiptarë në Pallat u shtua aq shumë sa debatet e vezirëve në Kubbealltë Divani Humajun (Këshilli Kryeministrot Perandorak në Portën e Lartë), në vend të osmanishtes, zhvilloheshin në shqip. Me fjalë të tjera, mbledhjet e Këshillit të Lartë të Shtetit bëheshin në gjuhën shqipe. Madje, shpeshherë, shqipja merre përparësi ndaj turqishtes si gjuhë komunikimi në Pallatin Perandorak. Personalitetet shqiptare dalin në plan të parë jo vetëm në hierarkinë administrative kryeministrotre dhe guvernatorialë, por edhe në atë shkencore-intelektuale. Ndër ta shquhet Shejhul Islami Ivazzade Ibrahim Efendi, ndër bijtë e Kryeministrit Ivaz Haxhi Mehmet Pasha, i mbiquajtur "Dy herë ngadhënjyesi i Beogradit".

Rreth 21 vjet më parë, në 11 shtator 1996, një shqiptar që kishte bërë emër kur fitoi lotarinë e Nju Jorkut, vrau ish-të dashurën e tij shtatzënë dhe vjehrrin e saj.

Gjykata pranoi shpjegimin e tij se e vrau ish-të dashurën për vetëmbrojtje, pasi ajo e qëlloi e para, por e quajti vrasje pa paramendim atë të vjehrrit dhe të fëmijës së palindur, si dhe vuri në dukje shkeljen urdhrit për të mos iu afruar familjes.

Shqiptari u dënua me 20 vjet burg me mundësinë për ta kthyer në burgim të përjetshëm. Pak javë përpara afrimit të 20-vjetorit, historia është shpëlhurosur nga emisioni televiziv "Your Number's Up" (Të erdhi radha) i "Investigation Discovery".

Të gjitha detajet e atij incidenti që tronditi jo vetëm komunitetin shqiptar, por edhe lagjen e qetë dhe të preferuar ku ndodhi ngjarja, do të rivizitohen nga emisioni në fjalë.

Emri i autorit të vrasjes ishte Gjelosh Rukaj, i njohur si Joe Rukaj. Ai merrej me prona të patundshme dhe pati fatin të fitonte 17 milionë e gjysmë dollarë në Lotarinë e Nju Jorkut.

Historia e tij tregohet shpesh nga ata që duan të provojnë se fitimi i lotarisë sjell fatkeqësi në jetën e njeriut.

Edhe emisioni që njihet për analizën që u bën krimeve nuk i ka rezistuar dot tundimit për ta lidhur me lotarinë, duke e titulluar "Fortune's Curse" (Mallikimi i Fatlumis). Lotaria i dha mundësinë Gjeloshit të rregullonte jetën për vete dhe për njerëzit e tij dhe pastaj të hidhte në erë gjithçka në një konflikt personal me ish të dashurën e tij, Rigaletta Nikc.

Ishte një konflikt në dukje fare i panevojshëm, por shkatërroi jetën e dy familjeve.

Për këtë konflikt është shkruar edhe më parë në median shqiptare, sidomos në revista Klan në Shqipëri.

Ja si e përshkruan revista Klan historinë: "Familja Rukaj erdhi nga

Grinburg ne Harrison rreth vitit 1990, pasi dolën nga fituesit e shumës 35 milion dollarë, që jepte lotaria e shtetit të Nju Jorkut, duke përfituar 17,5 milion dollarë. Ëndërra amerikane për emigrantin shqiptar Gjelosh Rukaj (i njohur edhe si Joseph Rukaj) dhe familjen e tij kishte marre jete, me shpejtë se për vetë amerikanët.

Shume prej banoreve e mbajnë mend si një njeri të paraqitshëm, i cili vishej me kostume Versace,

ngiste nje "Range Rover" dhe e vendosi familjen e tij - gruan dhe katër fëmijët - në një shtëpi te

mrekullueshme. Në të njëjtën kohe ai kishte edhe një vajzë jashtë martesë, me të dashurën Rigaletta Nikac, e cila i krijonte probleme Gjeloshit për ta takuar fëmijën e tij. Pas pesë vjetësh mosmarrëveshje, me 11 shtator te 1996, ai shkon në shtëpinë e Rigalettas, në Chappaqua për të marrë vajzën, këtë herë me pistoletë. Në fund të ditës ngjarja rezultoi me vrasjen e Rigaletta dhe Mark Nikac.

Gjelosh Rukaj u dënua me 20 vjet burgim për vrasjen e Mark, ndërsa vrasja e Rigalettas u shpjegua se ndodhi për arsye

vetëmbrojtjeje pasi kjo e fundit e kish gjuajtur e para me pistoletë Gjeloshin.

Nuk ka asnjë media në New York, duke përfshirë edhe "The New York Times" që nuk e kanë ndjekur me detaje gjyqin.

Në fillim njerëzit mendonin se do të kishte dënim me vdekje, sidomos sepse viktimja ishte shtatzënë, por prokuroria kërkoi burgim të përjetshëm sepse faktet ishin të ndërlukuara.

Sipas prokurorisë, Gjeloshi ishte përpjekur me armë të rrëmbente vajzën e familjes dhe duke e bërë këtë vrau nënën e saj shtatzënë.

Mirëpo, mbrojtja paraqiti dokumentin e atësisë që tregonte si Gjeloshi ishte në të vërtetë babai i vajzës. Ata siguruan edhe që juria të dëgjonte një telefonike mes të dyve në të cilën viktimja i thoshte "po të jesh burrë guxo të vish ta marrësh vajzën".

Duket se u pranua në fund që nëna kishte qëlluar e para. Dhe ishte vrarë nga përgjigja po me zjarr e Gjeloshit.

Mbrojtja tha se ishte një pritë e ngritur nga bashkëshorti i Rigolettas që nuk duronte dot lidhjen e vjetër të gruas së tij, keqtrajtohte vajzën e vogël dhe donte ta eliminonte Gjeloshin.

Mirëpo, juria pranoi nga akuza e prokurorisë së vjehrrit i Rigolettas ishte i paarmatosur dhe ishte vrarë kot dhe se Gjeloshi kishte shkelur një urdhër gjykatë për mosafirm dhe se kishte kërcënuar shumë shpesh me telefonata.

Në fund e dënuan me 20 vjet, për vrasje rrethore dhe ndoshta do të lirohet së shpejti.

*(illyriapress)*

**Gjelosh Rukaj u dënua me 20 vjet burgim për vrasjen e Mark, ndërsa vrasja e Rigalettas u shpjegua se ndodhi për arsye vetëmbrojtjeje pasi kjo e fundit e kish gjuajtur e para me pistoletë Gjeloshin**

## Kur vdiq gazetaria e pavarur?

Interneti sot të njeh me gazetarë për të cilët mund të vihet dora në zjarr për paanshmërinë dhe sinqeritetin e tyre edhe pse të tillët numërohen me gishtat e dorës



Naomi KLEIN

Është konsideruar si "pushteti i katërt" dhe mbrojtësi i qytetarit përballë tre pushteteve (legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori), por gjithmonë nëse është gazetar e pavarur dhe jo e manipuluar. Interneti sot të njeh me gazetarë për të cilët mund të vihet dora në zjarr për paanshmërinë dhe sinqeritetin e tyre edhe pse të tillët numërohen me gishtat e dorës. Por, kur nisi kriza e medias, kur u shndërrua shtypi në veglën e pushtetit dhe a ka pasur ndonjëherë shtyp të lirë? Me një kërkim të thjeshtë në internet me fjalën kyçe "shtypi i lirë" është e pamundur të mos hasësh fjalimin e bujshëm të kryeredaktorit të "The New York Times", i cili edhe pse daton një shekull më parë, është më aktual se kurrë. Në vitin 1880, botuesi dhe kryeredaktori i "The New York Times", John Swinton, ishte mysafir nderi në një banket të shtruar për shtypin. Kur iu desh të ngrinte një doli për këtë rast, Swinton thuhet se mbajti një fjalim që i habiti të gjithë. "Nuk ka shtyp të lirë në Amerikë. Ju dhe unë e dimë këtë. Askush nga ju nuk guxon të shkruajë mendimet e tij të sinqerta edhe nëse do ta dijë paraprakisht se nuk do të shfaqen asnjëherë në shtyp. Unë paguhem 150 dollarë në javë që t'i mbaj mendimet e mia të sinqerta larg nga puna dhe artikujt që shkruaj. Të tjerë nga ju paguhen afërsisht njësoj për të njëjtat gjëra dhe në qoftë se një nga ju do të ishte aq i naiv sa të shkruante mendimet e veta, do të dilte shumë shpejt në rrugë dhe do të kërkonte një punë tjetër. Në qoftë se do të lejoja që mendimet e mia të sinqerta të pasqyroheshin në punën time, për 24 orë do të mbeteshja i papunë. Biznesi i gazetarit të Nju Jorkut është të shkatërronë të vërtetën, të gënjejë hapur, të shtrembërojnë, të fyejnë, të shesë racën dhe vendin e tij për bukën e përditshme. Ju e dini këtë dhe unë e di gjithashtu. Çfarë budallallëku është të ngresh doli për një shtyp të pavarur. Ne jemi mjetet dhe vasalët e të pasurve që qëndrojnë pas perdes. Talentet tona, mundësitë tona dhe jetët tona janë të gjitha pronë e njerëzve të tjerë. Ne jemi prostituta intelektuale". Fjalë të ngjashme tha dhe Max Frankel, kryeredaktori i "The New York Times" nga viti 1986-1994, fitues i çmimit Pulitzer në 1973, mbi impaktin e spekulimit në gazetar pas daljes së tij në pension në 1994. Në 2005 në "Konferencën për Reformën e Medias" shumë zëra denoncuan dorëzimin e gazetarisë pushtetit. Aty u dëgjuan fjalë si këto: "Qytetarët trajtohen si konsumatorë, për të cilët ka shumë për t'u shitur dhe asgjë për t'u treguar" (Amy Godman, drejtore e programit "Democracy Now"); "Mediat e mëdha të komunikimit interpretojnë rolin e kullave të rojës të ngritura nga kompanitë e mëdha për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të nënshtruar shoqërinë".



Jean Pisani-FERRY

Ndërsa Bashkimi Demokratik Kristian i Gjermanisë (CDU) dhe partia e saj simotër bavareze, Bashkimi Social Kristian (CSU), kërkojnë të formojnë një "koalicion të paprecedent" me Liberal Demokratët dhe të Gjellbrit, pjesa tjetër e Europës pret me ankt programin qeveritar që do të dalë nga negociatat e tyre.

Rreziqet janë të larta për Europën, sepse këto nuk janë kohë të zakonshme. Rritja e nacionalizmit ekonomik, rritja e kërcënimeve të sigurisë dhe kriza e vazhdueshme e refugjatëve kanë bërë që reagimet kolektive të jenë më të nevojshme. Kina po bëhet gjithnjë e më e sigurt dhe administrata e presidentit amerikan Donald Trump e ka bërë të qartë mospëlqimin e saj për Bashkimin Europian dhe dyshimet e saj për fuqinë ekonomike të Gjermanisë.

Në shtëpi, arsyetimi i BE-së po testohet nga Brexit dhe nga qeveritë sfiduese të Polonisë dhe Hungarisë – dy vende që, siç vuri në dukje kohët e fundit Constanze Stelzenmüller nga Instituti Brookings, po gëzojnë benefitet e anëtarësimit në BE dhe po injorojnë detyrimet përkatëse.

Në këtë kontekst, zgjedhja e Emmanuel Macron në presidencën franceze në maj ishte një lehtësim për Gjermaninë. Megjithatë, Macron e ka vënë Gjermaninë në një pozitë të pakëndshme ku duhet t'i përgjigjet propozimeve të tij për reformat në nivelin e BE-së. Duke bërë thirrje për një fond të përbashkët mbrojtjeje të BE-së, harmonizim të taksave dhe një buxhet të përbashkët të eurozonës, Macron po e ngre në këmbë status quo-n europian.

Çështja tani është nëse vendi më i madh dhe më i begatë i Europës do të sigurojë liderhipin që kërkojnë këto kohë të vështira. Secila parti në bisedimet për koalicion sjell një perspektivë ndryshe në tavolinë. Për çështjet evropiane, CDU-ja e kancelares Angela Merkel, e cila ka 12 vjet në pushtet, do të sjellë vazhdimësi. Por CSU-ja më konservatore po tërhiqet djathtas nga konkurrenca nga populistja Alternative für Deutschland (AfD).

Përsa i takon dy partive të tjera, FDP-ja ka miratuar një vijë të ashpër drejt Europës. Liderët e saj kanë sugjeruar se

# Fiksimi i rrezikshëm i Gjermanisë

Aftësia e Bashkimit Europian për t'iu përgjigjur sfidave globale dhe atyre të brendshme do të varet kryesisht nga programi qeverisës që del nga bisedimet e vazhdueshme të koalicionit në Gjermani. A do të jetë qeveria e ardhshme gjermane e gatshme ta lërë mënjanë frikën e rishpërndarjes së padrejtë të BE-së apo ajo do të vazhdojë t'i lejojë këto frika të diktojnë çdo veprim të saj?

Greçia duhet të largohet nga euroja dhe se mekanizmi i BE-së për të shpëtuar vendet që luftojnë duhet të shpërbëhet. Të Gjellbrit, nga ana tjetër, janë të prirur për thellimin e integritimit europian; por kjo nuk është përparësia e tyre e parë dhe ata janë partia më e vogël në tavolinë.

Së fundmi, programi i qeverisë së re me shumë gjasa do të pasqyrojë dyshimin se vendet e tjera anëtare të BE-së duan t'i zgjidhin problemet e tyre me paratë e Gjermanisë sesa me reforma të brendshme. Politikanët gjermanë dhe opinionistët vlerësojnë pothuajse çdo propozim për reformën në nivel të BE-së përmes këtij prizmi shpërndarës. Skemat që nuk kanë për qëllim të çojnë në transferime strukturore diskutohen në mënyrë të vazhdueshme për të konfirmuar se ata nuk do të bëhen shpërndarës parash për vendet e tjera anëtare të BE-së.

Për shembull, gjermanët e konsiderojnë një buxhet të përbashkët jo si një mënyrë për të financuar të mira publike si hulumtimi apo infrastruktura, por si një mjet për ta detyruar Gjermaninë të mbulojë shpenzimet e vendeve të tjera. Në mënyrë të ngjashme, sigurimi i përbashkët i papunësisë konsiderohet si një skemë për t'i detyruar gjermanët të paguajnë për punonjësit e papunë spanjollë ose francezë. Dhe një program garancie depozitash për bankat shihet si një mënyrë për t'i detyruar depozituesit e kujdesshëm gjermanë të paguajnë për huat me probleme në Itali.

Padyshim, secili nga këto shqetësime mund të jetë i drejtë. Të gjitha propozimet sigurisht që duhet të shqyrtohen për të qenë të sigurt që me to s'do të abuzohet apo nuk do të paraqesin rrezik moral. Solidariteti europian nuk është një rrugë njëkalishe.

Por, në të njëjtën kohë, liderët gjermanë duhet ta pranojnë se fokusi i tyre

kryesor në efektet shpërndarëse është helmues. Ata duhet të kujtojnë një çast në vitin 1979 kur kryeministria e Britanisë Margaret Thatcher hyri në një samit europian dhe tha: "Dua të më ktheni pas paratë e mia!" E njëjta logjikë ishte edhe afër 40 vjet më pas gjatë fushatës për Brexit, kur politikanët "Largohu" pretenduan në mënyrë të gabuar se largimi nga BE-ja "do t'i kthente pas paratë" Shërbimin Shëndetësor Kombëtar.

Pse Gjermania është fiksuar me frikën se po paguan shumë? Buxheti i BE-së ka shumë gjëra për të kritikuar, por ai vështirë se e trajton në mënyrë të padrejtë Gjermaninë. Gjermania mund të jetë kontribuuesja më e madhe neto, por kjo është sepse ajo ka ekonominë më të madhe. Si pjesë e të ardhurave kombëtare, vende si Belgjika, Franca dhe Holanda gjithashtu kontribuojnë në një pjesë të madhe të të ardhurave të tyre neto.

Frika e Gjermanisë se Mekanizmi Europian për Stabilitetin shërben si një kanal për transferatë të fshehura është po aq e pabazë. Po, ESM-ja përfiton nga kostot e huave të ulëta, të cilat i kalojnë vendeve që i marrin këto hua. Nëse Greçia s'është në gjendje ta paguajë borxhin e saj, aksionerët e ESM-së do të pësojnë një humbje dhe ky rrezik nuk llogaritet në normën e interesit që paguan Greçia. Por, deri më tani, ESM-ja ka vazhduar të ketë fitime dhe çdo humbje që ajo pëson, do të shpërndahet midis të gjithë aksionerëve – përfshirë, për shembull, Italinë. ESM-ja është shumë larg të qenit një makinë subvencioni e financuar nga taksapaguesit gjermanë.

Disa njerëz në Gjermani gjithashtu hedhin poshtë të ashtuquajturat ekuilibra Target2, që regjistrojnë teprica dhe deficite të bankave qendrore kombëtare kundrejt Bankës Qendrore Europiane. Për shembull, Hans-Werner Sinn i Universitetit

të Munihut argumenton se sistemi Target është shndërruar në një kanal për operacione të fshehta që të përfitojnë vendet debitorë në Europën jugore. Vërtetë, në shtator, Bundesbank kishte një suficit neto prej 878 miliardë eurosh (1.2 trilionë dollarë) kundrejt BQE-së, ndërsa Italia dhe Spanja kishin deficite përkatësisht 432 miliardë euro dhe 373 miliardë euro. Këto pozicione pasqyrojnë shkallën në të cilën flukset zyrtare ende zëvendësojnë ato private.

Por, përsëri, kjo marrëveshje nuk i ka kushtuar Gjermanisë as edhe një euro. Përkundrazi, sistemi Target në thelb është një skemë kolektive sigurimi: nëse një bankë qendrore kombëtare nuk do të paguante, humbja do të ndahej midis aksionarëve të BQE-së. Sistemi i lejon në këtë mënyrë eksportuesit gjermanë të vazhdojnë të shesin prodhimet e tyre në Europën Jugore, sepse ai del garant që ata do të paguhen. Pretendimi që Gjermania humb nga kjo thjesht nuk është i vërtetë.

Do të jetë gjithmonë në interes të një partie politike t'i përgjigjet frikave të elektoratit. Por politikanët e kanë gjithashtu për detyrë t'i lajmërojnë votuesit kur frikët e tyre janë të tepruara ose të pabaza. Europa ka nevojë për një Gjermani që do të vendosë veton për gjysmë propozimet. Por ajo gjithashtu ka nevojë për një Gjermani që mund të kapërcejë fiksime të saj të ngushta dhe të sigurojë liderhip.

Me bisedimet aktuale të koalicionit, liderët e Gjermanisë kanë një mundësi për të vlerësuar zhvillimet e reja globale që do të kenë implikime të gjera për Europën dhe Gjermaninë. Ata duhet të vendosin nëse është më e rrezikshme të mos bëjnë asgjë apo të marrin nisim. Askush nuk pret një ndryshim të papritur besimi. Por shpresojmë për një qeveri që do të jetë më e gatshme për të ofruar zgjidhje.

(reporter.al)




## Galiani drejt Realit?

Ish drejtori i AC Milan, Adriano Galliani, mund të rikthehet në botën e futbollit duke iu bashkuar bordit drejtues së Real Madridit, raportohet nga mediat spanjolle. Ai ka qenë një pjesë e integrale e kuqezinjve për mbi 30 vite përpara se ish-presidenti Silvio Berlusconi shiti klubin të investitorit kinez Jhongong Li në prill. Sipas "Mundo Deportivo" dhe La Stampa, presidenti i Real Madridit Florentino Perez i ka propozuar një rol të rëndësishëm 73-vjeçarit Galliani në bordin e drejtuesve. Galliani gjithashtu është përfolur për postin e shefit të Ligës së Serie A ose FIGC, por momentalisht është përfshirë në biznesin e televizionit të Berlusconi. Perez është një mik i mirë i Galliani, teksa kanë negociuar shumë marrëveshje gjatë viteve të kaluar.

## Agüero kalon Maradonën

Sulmuesi i Argjentinës Sergio Agüero është i lumtur që ka kaluar Diego Maradonën për golat e shënuar me kombëtaren. Agüero shënoi golin e vetëm në minutat e fundit të miqësorës (86) me Rusinë që u luajt në Moskë të shtunën. Ky gol ishte i 35-i për yllin e "Dytetarëve" me fanellën e "Albiceleste"-s, duke lënë pas Maradonën që ka ndaluar në shifrën 34. 35 gola për Agüeron po aq sa Hernan Krespo, duke mbetur pas Gabriel Batistutës me 56 dhe Lionel Messit me 61. "Jam i lumtur për golin që na dhuroi fitoren. Luajtëm mirë dhe duhet të vazhdojmë të rritemi. Kemi shumë lojtarë të rinj dhe është e vështirë të njihemi me njëri-tjetrin. Por gjatë ndeshjes u kuptuam mirë", komentoi Kun.



## Kuqezinjtë në Antalia takohen me Turqinë



# TË PARAQITEMI MIRË E PSE JO TË MARRIM EDHE REZULTAT POZITIV

**"Do të kërkojmë të paraqitemi mirë dhe pse jo, të marrim edhe rezultat pozitiv në këtë sfidë", pohon korçari Lilaj**

Kombëtarja e Shqipërisë sot (e hënë) do të zhvillojë ndeshjen e fundit për vitin 2017, ndërsa përballë do të ketë përfaqësuesen e Turqisë. Atmosfera tek kuqezinjtë është e mirë dhe të gjithë presin një rezultat pozitiv. Njëri prej tyre është edhe mesfushori i Skënderbeut, Sabien Lilaj. Ai vlerëson Turqinë, si një kundërshtar i nivelit të lartë, por u shpreh se kombëtarja do të hyjë në fushë për të dhënë më të mirën, dhe pretenduar

rezultat. "Natyrisht që kundërshtari është i një niveli të lartë dhe këtë e dinë të gjithë. Kanë futbollistë që luajnë në klube të mira, por ne do të bëjmë lojën tonë. Do të kërkojmë të paraqitemi mirë dhe pse jo, të marrim edhe rezultat pozitiv në këtë sfidë", tha korçari. Lilaj tregoi se nuk e kishte takuar më herët Panuçin, ndërsa tha se preferon të luajë para mbrojtjes, sepse aty jep më të mirën. "Nuk e kisha takuar asnjëherë Panuçin, por kjo nuk është e rëndësishme, sepse në kombëtare vlen vetëm paraqitja dhe forma e mirë, për t'u aktivizuar. Këto ditë këtu na shërbyen për t'u njohur më mirë, si me trajnerin, ashtu edhe me njëri-tjetrin dhe besoj se kemi bërë një punë të mirë. Roli im i preferuar është mes-

fushor para mbrojtjes, sepse aty ndihem mirë dhe besoj se jam më të mirën, por gjithsesi jam i gatshëm të luaj ku të më kërkojë Panuçi", deklaroi Lilaj. Krahas Sabien Lilajt, në kuadër të ndeshjes me Turqinë foli edhe mbrojtësi Frederik Veseli. Ai premtoi se skuadra do të japë më të mirën në fushë. "Nuk ekzistojnë ndeshjet miqësore. Edhe ndaj Turqisë do të kërkojmë të japim maksimumin dhe të paraqitemi mirë. Kemi pasur një javë kohë për ta përgatitur këtë sfidë dhe mendoj se kemi punuar mirë, jemi bashkuar edhe më tepër si grup dhe kemi pasur mundësi të njohim më mirë edhe trajnerin", deklaroi Veseli. Në anën tjetër, Trajneri i Turqisë, Mircea Luçesku, në kuadër të ndesh-

jes miqësore që skuadra e tij do të zhvillojë sot ndaj Shqipërisë në Antalia ka folur në lidhje me rindërtimin që po i bën kombëtares turke, dhe ka kërkuar nga lojtarët që të marrin një shembull nga shqiptarët. "Çdo gjë fillon nga lojtarët. Ata duhet të bëjnë çmos që të luajnë në skuadrat e tyre. Unë nuk mund t'iu them se çfarë duhet të bëjnë që të luajnë në klubet përkatëse, por e rëndësishme është që t'iu jap një shans për të qenë pjesë e kombëtares. 9 lojtarë të Shqipërisë, ndaj të cilëve do të luajmë sot, aktivizohen në Itali. Edhe futbollistët turq, pasi të arrijnë një nivel të caktuar, duhet të dalin jashtë shtetit dhe të luajnë vazhdimisht në skuadrat e tyre", tha Luçesku.

## Igor Angellovski i kënaqur me fitoren ndaj Norvegjisë



# E kthjem Maqedoninë aty ku e ka vendin

Shkup, 12 nëntor - Përfaqësuesja e Maqedonisë vitin 2017 e ka mbyllur me fitore, pasi që të shtunën në stadiumin "Filipi i dytë" në Shkup në kuadër të ndeshjes kontrolluese me rezultat 2:0 mundi përfaqësuesen e Norvegjisë. Goran Pandev dhe Markovski ishin autor të golave për djemtë e trajnerit Igor Angellovski. Pikërisht Angellovski pas përfundimit të ndeshjes uroj futbollistët e tij për fitoren e arritur duke thënë se arriten që këtë vit ta kthejnë futbollin e Maqedonisë aty ku e ka vendin. "Dua të uroj futbollistët të cilët luajtën në këtë ndeshje, pasi që fituam një kombëtare e cila është shumë më mirë e renditur se ne. Urime për të gjithë ata që e veshën fanellën e përfaqësueses në këtë vit. E kthjem futbollin e Maqedonisë, atje ku e ka vendin", tha trajneri Angellovski në takimin me gazetarë pas mbylljes së ndeshjes. Ai po ashtu dëshiron që edhe në vitin 2018 përfaqësuesja të vazhdojë me paraqitjet e mira. "Dua që edhe në vitin 2018 të vazhdojmë kështu. E presim shortin për Ligën e Kombeve, përmes së cilës duam të shkojmë në kampionatin evropian", përfundoi Angellovski.

Ndërkohë, ishte kjo ndeshje e pestë e përfaqësueses së Maqedonisë në të cilën nuk humb, por njëkohësisht edhe fitorja e pestë në vitin 2017.

## Shkupi nuk ia del as ndaj "AB Ohrid"


Shkup, 12 nëntor - Skuadra e Shkupit ka pësuar disfatën e gjashtë në po aq ndeshje të zhvilluara në Superligën e basketbollit në Maqedoni. Në ndeshjen e zhvilluar si mysafir në Ohër ndaj skuadrës së "AB Ohrid", basketbollistët shkupjan pësuan me rezultatin 105:92 (28-24; 30-24; 34-21; 13-23). Vetëm çereku i fundit u ka takuar djemtë të trajnerit Enver Miftari, të cilin e fituan me rezultatin 23:13,

megjithatë kjo nuk mjaftoi që të bëjnë përmbysje dhe të arrijnë fitoren e parë. Ndryshe, te KB Shkupi shkëlqeu debutuesi Muojke Afam, me 32 pikë të shënuara, derisa Tajron Haris shënoi 23 pikë, 5 kërcime dhe 3 asistime, teksa Xhozef Tejlor regjistroi 18 pikë, 7 kërcime dhe 1 asistim. Ndeshjen e radhës KB Shkupi do ta zhvillojë si vendas përballë skuadrës së "Karposh Sokoli". (B.K.)



## Shqipëria triumfon në "Gongu i Artë"

# Bekim Vjerdha boksieri më i mirë



Shkup, 12 nëntor - Kombëtarja e Shqipërisë e boksit ka triumfuar në turnirin "Gongu i Artë" që u zhvillua në Shkup. Boksierët kuqezinj kanë siguruar 4 medalje të arta, duke qenë kombëtarja më e mirë e këtij turniri, dhe duke lënë pas Serbinë me 3 medalje të arta.

Medalje të arta në këtë turnir morën boksierët Ardit Murja (pesha 56 kg), Indrit Sokoli (pesha 64 kg), Arjon Kajoshi (pesha 75 kg) dhe Bekim Vjerdha (pesha 81 kg). Ndërsa dy boksierët e tjerë, Emiljano Xhediku dhe Krenar Zeneli pësuan humbje të pamerituata, të vendosura

më së shumti nga gjyqtarët. Veçohet fitorja me "KO" e Sokolit përballë boksierët maqedonas, ndërsa boksieri Vjerdha u shpall më i mirë i turnirit duke marrë edhe trofeun e "Gongut të Artë 2017". Të gjitha sfidat kanë qenë të bukura dhe me rivalitet, ndaj ky triumf është një



rezultat i rëndësishëm për boksion shqiptar. Ndërkohë, boksieri më i mirë nga Maqedonia ishte Denis

Muaremovski, përkundër faktit se përfaqësuesja e Maqedonisë nuk arriti asnjë fitore.

**FISNIK NUHIU, FUTBOLLIST**



**TE RENOVA  
EDHE PAS  
PËRFUNDIMIT  
TË KARRIERËS**

**“E ardhmja ime përsëri lidhet me futbollin. Mendoj të mbetem në profesionin tim. Më kanë premtuar pronarët e KF Renova se do më mbajnë aty pas përfundimit të karrierës si futbollist dhe do shohim çfarë detyrash do kem në të ardhmen. Ashtu si do thotë Zoti ashtu do bëhet”, thotë Nuhiu**

Koha | Bujar KURTAJ

Shkup, 12 nëntor - Fisnik Nuhiu është njëri prej mesfushorëve më të mirë në elitën e futbollit vendor. Aktualisht mbron ngjyrat e skuadrës së Renovës, ku është një kapiten dhe organizator i lojës së bardhekaltërve. Por, para se të vjen te Renova, Nuhiu hapat e parë me futbollin i ka bërë te KF Shkëndija, por që talentin e tij e zbuluan drejtuesit e KF Vardar, ku pasi i kaloi të gjitha kategoritë, arriti të debutojë edhe në ekipin e parë. Por, rrjedha e karrierës së Nuhiut ndryshoi me konfliktin në vitin 2001 në Maqedoni, ku u largua nga Vardari për të shkuar te KF Prishtina, ndërsa tre muaj ka qenë pjesë e KF Sloga J. Por për shkak të problemeve me dokumentet u detyrua të largohet. Pas konfliktit u rikthye te Vardari por jo gjatë, për tu rikthyer aty ku e filloi karrierën, te KF Shkëndija. Mirëpo, kulmi i karrierës ndodhi te KF Renova, ku nga viti 2005 Nuhiu është pjesë e saj. Të gjitha këto Nuhiu i tregon në intervistën për gazetën KOHA, por që nuk mungojnë edhe gjërat nga jeta e tij jashtë futbollit dhe momentet e mira që i kanë ndodhur gjatë karrierës së tij, ku ai thotë se akoma ka për të treguar edhe pse është 34 vjeç.

**KOHA: Fisnik, hapat e parë me futbollin i bërë te KF Shkëndija. A të kujtohet kjo periudhë dhe çka të inspiroi që të merre-**

**sh me sportin më të popullarizuar në botë?**

**NUHIU:** Po si fëmijë në moshën 12-vjeçare fillova të ushtroj në moshat e reja te KF Shkëndija. E mora këtë hap duke menduar se kam talent që të filloj të merrem me futboll, normal kjo ndodhi edhe me përkrahjen e familjes të cilën gjithashtu e kanë vërejtur talentin tim për këtë sport te bukur.

**KOHA: Më pas si rezultat i talentit që kishe, nga viti 1997 e deri në vitin 2001 ke qenë pjesë e KF Vardar. Si erdhi deri te kjo dhe cilat janë përshtypjet e tua në këtë klub?**

**NUHIU:** Gjatë asaj periudhe kishim ndeshje kundër të gjitha skuadrave që kishin shkolla futbollit dhe nga ndeshjet që kemi zhvilluar kundër KF Vardar ju kam ra në sy drejtuesve të tyre me paraqitjet e mija. Pas kësaj ata ishin shumë të interesuar që të më merrnin atje dhe kjo ndodhi në muajin maj të vitit 1997, ku në akoma isha në shkollë fillore, respektivisht në klasë të 8. Ishte klubi më i madh dhe kjo ishte arsyeja pse kalova atje duke menduar se mund të arrijë suksese në karrierë. Pasi i kalova të gjitha kategoritë e reja në Vardar, arrita deri në ekipin senior ku më 25 prill të vitit 2000 debutova në ndeshjen Tikvesh -Vardar në Kavadar.

**KOHA: Pas luftës në Maqedoni, u detyrove të largohesh nga Vardari dhe të transferohesh në**

**kampionatin kosovar, respektivisht te KF Prishtina. Cilat ishin arsyet që e bërë këtë hap?**

**NUHIU:** Në verën e vitit 2001 kur ishin trazirat në Maqedoni, unë u largova nga Vardari dhe shkova në KF Prishtina. Për shkak të situatës, unë dhe familja ime nuk e shihnim të arsyeshme të mbetem në një klub maqedonas në rrethana të tilla edhe pse isha nën kontratë me Vardarin ndërsa

ata llogaritnin shumë në kualitetin tim.

**KOHA: Meqë iu bashkove KF Prishtina. Sa qëndrove në këtë klub dhe për çfarë do ta mbash mend periudhën te ky klub?**

**NUHIU:** Në Prishtinë qëndrova 6-muaj dhe kjo ishte periudha kur fizikisht isha atje, por mendjen dhe zemrën i kisha në shtëpi te familja në fshatin Odër, pasi situa-

ta nuk ishte e mirë, kohë e vështirë.

**KOHA: Pas largimit nga KF Prishtina u riktheve përsëri te Vardari?**

**NUHIU:** Po në shkurt të vitit 2002 u ktheva në Vardar sepse isha nën kontratë me ata dhe nëse doja te vazhdoj me futbollin duhej ta respektoj kontratën deri në fund.





**KOHA: A është e vërtetë se në vitin 2000 u transferove te KF Slloga Jugomagnat tani FC Shkupi, por ky transferim dësh-toi. Cilat ishin arsyet?**

**NUHIU:** Në vitin 2000 kisha një kontratë stipendore me Vardarin, e cila më skadonte gjatë verës dhe KF Slloga Jugomagnat ishte shumë e vendosur të kaloj atje. Në fakt ishte edhe dëshira ime dhe e prindërve të shkoj atje, pasi Slloga aso koha ishte kampione e Maqedonisë dhe kishin super skuadër. Shkova, mirëpo nuk e dija se do dilnin probleme me dokumentacionin, sepse kishte pas një rregull në FFM që ai lojtar që ka kontratë stipendore edhe pse i skadon e njëjta, është e detyrueshme të nënshkruhet edhe kontrata profesionale 4 vjeçare. Ndërkaq, duhej të kthehem në Vardar sepse nuk kisha drejtë të luaj ndeshje zyrtare për dy vite e gjysmë edhe pse kalova 3 muaj te Slloga realisht doja të mbetem aty.

**KOHA: Më pas te Vardari nuk qëndrove gjatë, vetëm 1 vit dhe gjatë dy viteve të ardhshme ishe pjesë e KF Shkëndija. Si erdhi deri te kjo?**

**NUHIU:** Pasi dështoi transferimi te Slloga J. u ktheva në Vardar, por nuk isha i lumtur dhe nuk doja të qëndroja por kisha kontratë. Pastaj erdhi interesimi nga KF Shkëndija që të kaloj në formë huazimi, ku fatmirësisht arritën marrëveshje dy klubet dhe unë u ktheva në Tetovë.

**KOHA: Transferimi te Shkëndija doli si hap i mirë, pasi arritët që klubin ta riktheni në elitën e futbollit vendor. A mund të na përshkruash periudhën e kaluar te kuqezinjët?**



**NUHIU:** Kisha nevojë për klub ku do luaj dhe Shkëndija ma ofroj këtë dhe pas dy sezoneve në Ligën e dytë arritëm të plasohemi në Ligën e parë. Sukses i madh me lojtar vendas dhe shumica nga shkolla e klubit.

**KOHA: Përkundër paraqitjeve të mira, nuk vazhdove qëndrimin te Shkëndija, dhe u transferove te rivali lokal KF Renova?**

**NUHIU:** Pas 6-muajve në Ligën e parë me Shkëndijën dhe pas disa lëndimeve që kisha, ndodhi që udhëheqësit ta humbnin besimin në mua dhe kështu në janar të vitit 2005 u transferova te KF Renova.

**KOHA: Dhe nga viti 2005 je pjesë e këtij klubi dhe je një lider i diskutueshëm. Sa je i kënaqur me paraqitjet tuaja të deritanishme dhe sukseset me këtë klub?**

**NUHIU:** Te Renova gjeta njerëz që kanë besim maksimal tek unë dhe kjo më dha përgjegjësi që tua kthej me paraqitje të mira dhe me angazhim maksimal në çdo aspekt. Prej atëherë dhe deri tani jam i kënaqur me gjithçka këtu si nga paraqitjet poashtu edhe nga të sukseset e arritura.

**KOHA: Te Renova u zgjodhët kapiten?**

**NUHIU:** Kapiten u zgjodha shumë shpejt, në fund të nëntorit 2005. Ishte befasi për mua kur në ndeshjen kundër Vardarit në mbledhjen që zhvillon trajneri para ndeshjes, ma kumtoj lajmin se do jem kapiten dhe kjo ishte befasi shumë e bukur. Prej atëherë vazhdoj ta mbaj shiritin e kapitenit, që është një privilegj për mua por edhe përgjegjësi.

**KOHA: A e kujton përballjen e parë me ish-klubin tuaj Shkëndija, ndeshje e cila gjithmonë zgjon interesim të madh. Si e vlerëson këtë derbi shqiptar?**

**NUHIU:** I kujtoj të gjitha ndeshjet derbi ne Tetovë, të gjitha janë ndeshje speciale dhe më ndryshe se ndeshjet tjera. Vite më parë ishin derbi shumë më të zjarrtë dhe kish-te shumë presion si në fushë ashtu edhe në tribuna dhe qytet, por tani është më qetë, por që prapë zgjojnë interesim të madh.

**KOHA: Je 34 vjeçar, a e ke vendosur se kur do ti varësh këpucët në gozhdë?**

**NUHIU:** Jam 34 por ndjehem shumë më i ri. Do ndaloj atëherë kur trupi im do më jep shenja se duhet të ndaloj. Tani jam në gjendje perfekte fizike dhe nuk mendoj se do ndaloj shpejt. Normal kjo varet edhe nga fati që mos kem lëndime të rënda. Kur jemi te lëndimet, gjatë karrierës time falë Zotit nuk kam pas lëndime të rënda dhe kjo më ka ndihmuar të kem formë konstante.

**KOHA: A e ke menduar të ardhmen tuaj pas futbollit?**

**NUHIU:** Sigurisht se po dhe ajo përsëri lidhet me futbollin. Mendoj të mbetem në profesionin tim, më kanë premtuar pronarët e KF Renova se do më mbajnë aty pas përfundimit të karrierës si futbollist dhe do shohim çfarë detyrash do kem në të ardhmen. Ashtu si do thotë Zoti ashtu do bëhet.



**NUHIU:** Nuk kam shënuar edhe shumë, por ama kur kam shënuar kanë qenë vërtetë gola të bukur. Shumica e golave kanë qenë nga distanca për shkak të pozicionit tim në fushë si mesfushor. E mbaj mend një gol kundër Vardarit dhe portierit Pačovski, një parabolë e bukur me të djathtën edhe pse jam majtak.

**KOHA: Momenti më i mirë dhe mi keq që të ka ndodhur gjatë karrierës tënde?**

**NUHIU:** Momentet ma të bukura sigurisht janë trofeu kampion dhe fitimi i kupës me Renovën. Ndërkohë që, momentet e këqija nuk dua ti kujtoj.

**KOHA: Nëse nuk do të ishit futbollist, me çka do të kishit dashur të merreni?**

**NUHIU:** Në fillim nuk dua ta imagjinoj jetën pa futboll, por mendoj se do studioja psikologjinë dhe do bëhesha një psikolog i mirë.

**KOHA: Kush është në jetën private Fisnik Nuhiu?**

**NUHIU:** Fisniku ne fillim është bashkëshort, vëlla, shok, i cili është i lumtur atëherë kur të gjithë njerëzit që i dua janë të lumtur. Jam shumë familjar dhe serioz. Jam dajë, kam nip e mbesë Erjoni dhe Rona që i dua shumë ashtu si i dua prindërit, motrën Fisnike, vëllain Florimin, nusen Drita me të cilën e presim një djalë të na vjen në këtë botë. Jam krenar shqiptar-musliman, i cili e donë kombin e vet dhe e dua fenë time të cilën e praktikoj ashtu si na ka urdhëruar Zoti. Ky është Fisniku në disa pika të shkurta.



**KOHA: Sigurisht se ke shënuar shumë gola gjatë karrierës së deritanishme, por cilin gol do ta kishe vëçar?**



Ka takime të destinuar për tu shndërruar në legjendare dhe këtë Pablo Eskobar e ka ditur gjithmonë. Për këtë arsye, një ditë vendosi që të ftojë në "La Catedral", yllin e futbollit botëror, Diego Armando Maradona

# Kur Maradona luajti për nder të Eskobarit

Sikurse ka emra të destinuar për tu gdhendur në kujtesë. Burra të cilët ma vendimet e tyre ndryshojnë historinë e një atdheu të tërë. Disa herë në aspektin pozitiv, por në shumë herë të tjera në aspektin negativ. Por ndodh edhe që varfëria dhe dëshpërimi të mos lejojnë më që të dallojnë Parajsën nga ferri dhe ajo që lind është një gjendje hibride, në të cilën gjithçka është e lejuar, në të cilën çdo kufi mund të shtyhet disa metra më tutje, në të cilin qëllimi justifikon çdo mjet.

Pablo Emilio Eskobar Gaviria nuk ka nevojë për prezantime. Është e natyrishtme të kujtohet si perandori i kokainës, narkotrafikanti më i pasur i të gjitha kohërave, ose si një prej kriminelëve më gjakatarë të historisë. Ajo që jo të gjithë e dinë është se Eskobar ishte edhe një zotëri i futbollit. Mundësoi ndërtimin e stadiumeve dhe ndihmoi skuadrat lokale deri në pikën kur u bë financuesi më i madh i skuadrës më të rëndësishme në atdheun e tij, Atletiko Nacional di Medellin, skuadra e parë kolumbiane që fitoi trofeun "Coppa Libertadores", e mundur në minutën e fundit të kohës shtesë në finalen e Kupës Interkontinentale, në vitin 1989 nga Milani i Arrigo Sakit. Metoda e Eskobar ishte perfekte për të marrë konsensusin dhe mbështetjen popullore, ndërkohë që riciklonte sasi gjigante të parave. Por pas personave të lindur për të bërë histori, ndodhen takimet e destinuar për tu bërë legjendarë. Tani që të gjithë e kanë të qartë në mendje imazhin e Eskobar, bashkëngjitni atij një tjetër figurë mitike, të pamundur për ta injoruar, futbollistin me famë botërore, Diego Armando



Maradona. Çfarë ndodh kur dy persona me staturën e bujshme të tyre takohen? Nuk ka shaka. Ishte viti 1991, muaji dhjetor. Maradona po vuante dënimin dhe skualifikimin e tij 2-vjeçar, pasi rezultoi pozitiv ndaj kokainës në testet antidoping, kur nga menaxheri i tij, Guillermo Koppola u njoftua se një zotëri i rëndësishëm kolumbian ishte i gatshëm të paguante një shumë të konsiderueshme, vetëm që ylli argjentinas i futbollit botëror të merrte pjesë dhe të luante në një ndeshje miqësore me futbollistë të tjerë amerikano-jugorë, mes të cilëve edhe Rene Higuita. Në fund të fundit, Diego në Kolombi ishte shumë i famshëm në atë kohë. Kur ishte vetëm një fëmijë dhe i bënte të çmendeshin tifozët me

fanellën e Argentinos Juniors, e kërkuar edhe të famshmit vëllezërit Orejuela, drejtues të kartelit të Cali. Oferta e tyre u kapërcye nga Barcelona, se në të kundërt, Maradona do të kishte veshur fanellën e America, ekipit të parë të kryeqytetit kolumbian. Maradona pranoi pa bërë shumë pyetje ofertën e propozuar nga miku dhe menaxheri i tij. Por, kur arriti në Medellin dhe u shoqërua në një burg të rrethuar nga qindra roje, siguria e tij nisi të çekuilibrohej. "Çfarë ndodh? Duan të më arrestojnë?". Vendi për ku u shoqërua Diego mban emrin që në Amerikë të gjithë e njohin, "La Catedral", burgu personal i Pablo Eskobar. "Dukej njëllor sikur të ishe në një hotel luksoz në Dubai. Aty më prezantuan me zotërinë që më kishte

ekzekutuesi i më shumë se dhjetë mijë vrasjeve dhe se kishte qenë padroni absolute i narkotrafikut botëror.

"Në çështjen e narkotrafikut unë jam personi më pak i përshtatshëm për të gjykuar, por "Padroni" paguante fshatarët për të mbledhur pastën e kokas, paguante të tjerët për ta përpunuar atë në laboratorë dhe paguante pilotët që ta transportonin në Shtetet e Bashkuara. Në fund të llogarive, fabrikonte një produkt në mënyrë klandestine dhe ua shiste atë njerëzve që e kërkonin, askush nuk detyrohej dhe as nuk ishte i imponuar, apo jo? Nuk ja vidhte atë askujt. Në anën tjetër politikanët zgjidhen dhe vjedhin paratë e popullit duke i rritur taksat një nëne që blen qumështin për fëmijët e saj. Kështu, në aspektin etik, kush është më i keq? Përsa i përket vdekjeve, ai ishte në luftë kundër shtetit për një motiv nationalist, sepse qytetarët kolumbianë të mos ekstradoheshin në Shtetet e Bashkuara dhe në luftë njerëzit vriten. Edhe Bush, për naftën vrau me qindra e mijëra persona. Po ai nuk është i keq?", komenton Maradona mbi aktivitetin e Eskobar.

Jo të gjithë takimet janë të destinuar për tu rizgjidhur në një revolucion. Disa janë vetëm kryqëzime të dy jetëve që do të vijojnë secili në rrugën e vet. Eskobar i propozoi Maradonës që të bëhej numri 10 i skuadrës së tij, por Diego preferoi të transferohej te Siviglia. Ishte viti 1992.

Pak më shumë se një vit më pas, trupi i pajetë i Pablo Eskobar u fotografua nga agjentët amerikanë të "DEA" në çatitë e Medellin.



## Të gjithë e duan Poketinton

Mauricio Pochettino është trajneri i momentit, të cilin e duan të gjitha skuadrat më të mëdha në Evropë. Pas zërave se ai mund të jetë trajneri i ardhshëm i Real Madridit, mediat britanike konfirmojnë sot se për të janë interesuar edhe dy skuadra të tjera: Manchester Junajted dhe Paris Sen Zhermen. Francezët duket se janë të pakënaqur me rendimentin e trajnerit Unai Emery dhe mendojnë se Pochettino mund të bëjë të madhe një skuadër ku luajnë mjaft yje. Kalimi i trajnerit argjentinas te PSZH mund të realizohet edhe pas polemikave të kohëve të fundit të trajneri Emery me brazilianin Neymar. Për Poketinton ky do të ishte një rikthim te PSZH, ku ka luajtur dy sezone. Por duket se së fundi edhe Manchester Junajted po interesohet për trajnerin e Tottenhamit, pas kërkesave që Hoze Murinjo ka shfaqur për një rritje të ndjeshme të rrogës, ndërkohë që ende nuk ka fituar titullin në Premier Ligë. Madje në kampionat skuadra e "djajve të kuq" po çalon shumë, duke mos qenë në gjendje të mbajë ritmin e Sitit dhe humbet me skuadrat e tjera pretendente. Në rast se trajneri portugez largohet, Pochettino mund të lëvizë nga Tottenhami tek Junajted, duke qëndruar në Premier. Vlera e trajnerit argjentinas është rritur ndjeshëm kohët e fundit, sidomos pas fitores 3-1 që ekipi i tij arriti ndaj Real Madridit në Çampions Ligë.

Publicitet

Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup  
Fakulteti ekonomik – Shkup

Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, Fakulteti ekonomik – Shkup në vijim publikon

**LAJMËRIM**

Anulohet Konkursi i publikuar në gazetën ditore "Koha" më datë 9.11.2017, ndërsa i cili ka të bëjë me zgjedhjen e:

- një realizues, asistent – doktorant në sferën shkencore: teoria ekonomike (50300);
- një realizues, asistent – doktorant në sferën shkencore: kontabilitet (50328);
- një realizues asistent – doktorant në sferën shkencore: grup lëndësh nga sfera juridike (508).

Në lidhje me Konkursin e publikuar më datë 9.11.2017 nuk do të bëhet zgjedhje për angazhim të realizuesve të kërkuar.

Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup  
Fakulteti ekonomik – Shkup

## Arsenali piketon Zahan si zëvendësuesin e Sançez

Arsene Wenger ka kohë që përgatitet për të luajtur herët e vonë pa sulmuesin kilian Aleksis Sançez, që nuk do të rinovojë me Arsenal dhe do të largohet në janar ose në fund të sezonit. Ndaj trajneri francez është gati të ofrojë 35 milionë sterlina për të marrë yllin e skuadrës së Krisal Pallas, Vilfried Zaha. Për Wenger, Zaha është zëvendësuesi ideal i kilianit, një mesfushor i avancuar, që mund të luajë edhe si sulmues i dytë, duke bërë praktikisht te skuadra e Pallas të njëjtën gjë si Sançez sot te "topçinjtë". Skuadra e Kristal Pallas nuk dëshiron të largojë Zaha, sidomos në këtë moment të vështirë të sezonit, ku rrezikon rënien nga kategoria. Ai ka munguar në ndeshjet e para sezonale, i dëmtuar dhe është rikthyer në fushë vetëm muajin e fundit. Zaha ka një mar-



rëveshje 5-vjeçare me "shqiponjat", por përballë një oferte të mirë siç është ajo e Arsenalit situata mund të ndryshojë. Duket se Arsenal kërkon të lëvizë më shpejt, pasi edhe Tottenhami ka piketuar Zahan si një përforcim të mundshëm për të ardhmen.

Mendo  
JETË më të SIGURITË,  
më të MIRË  
dhe  
më të GJATË.

+389 2 3288 800  
[www.uniqa.mk](http://www.uniqa.mk)

Mendo



SIGURIME  
JETË dhe JO-JETË



Ndërkohë këto marka vendosin etiketën "Made in Europe" ose "Made in EU" duke i ofruar kështu konsumatorit idenë se markat prodhohen në kushte të ndershme

## Shqipëria rikthen territorin e humbur nga Greqia

Kanë vazhduar edhe gjatë pasdites në ishullin e Kretës bisedimet mes Greqisë dhe Shqipërisë për zgjidhjen e çështjeve dypalëshe. Mbasi janë pritur me këngë dhe valle në Lasithi, lokalitet pranë vendit ku mbahen bisedimet, emrin e sheshit të së cilës Kotzias e ka pagëzuar me emirin "Europa" dy vjet më parë, të dy ministrat u janë rikthyer bisedimeve. Ndoshta për të theksuar pikërisht këtë aspekt, Kotzias deklaroi se, "po vazhdojmë diskutimet për integrimin evropian të Shqipërisë". Bisedimet e pasdites së të shtunës janë fokusuar në problemet e minoritetit grek që jeton në Shqipëri, si dhe do të diskutohet për pikat e mbetura pezull në marrëveshjet për të cilat palët kanë dakordësi ose qasje. Ajo çka tashmë quhet e përfunduar, sipas burimeve të Top Channel, është Marrëveshja e Detit. Pala greke ka pranuar se me marrëveshjen e viti 2009 Shqipëria humb sovranitet në territor ndaj dhe është rënë dakord që të ketë një ndarje të re. Pikërisht për këtë do të ketë referime të reja në terren, nga të cilat Shqipëria nuk do të humbë asnjë metër katror sipërfaqe. Duket se çështja e varrezave të të rënëve të ushtarëve grekë në Luftën e Dytë Botërore do t'i bashkëngjitet listës së çështjeve të mbyllura mes dy vendeve. Pala greke insistoi se bëhet fjalë për një çështje humane, ndaj dhe si e tillë duhet të trajtohet. Për çështjet konsullore tashmë është rënë gjithashtu dakord dhe mbetet për të përfunduar formulën sesi do të aborgohet në praktikë edhe kjo çështje. Për ligjin e luftës, palët kanë sjellë me vete edhe ekspertizën ndërkom-betare, ndërsa pala greke ka hulumtuar me presidencën për mënyrën ligjore të heqjes së ligjit në fjalë. Për këtë temë ka një shqyrtim të presidencës greke, e cila ka vlerësuar se heqja e ligjit mund t'i bashkëngjitet traktatit të ri të miqësisë, i cili do të formulohet në muajt në vazhdim.

# Sklevërit modernë në Ballkan

**Firmat e modës i prodhojnë lirë produktet e tyre të shtrenjta në Europën Lindore e Ballkan. Ligjet shkelen, rrobaqepëset marrin një rrogë që nuk mjafton për të jetuar, e qeveritë e rajonit i mbështesin praktika të tilla**

Ato janë dëshmi tronditëse nga një botë e fshehtë. "I thashë drejtorit tim, që nuk marr dot frymë me këtë makinë qepëse. Brenda në fabrikë janë 30 gradë, dhe kur punojmë në makinë temperatura rritet", rrëfen një punëtorë tekstili në Serbi. Pas kësaj drejtori i makinës e merr tubin e ajrit ia drejton në fytyrë rrobaqepëses e koleges së saj dhe thotë: "Ky është problemi juaj, e nëse ju nuk arrini dot ta përballonit, ka shumë njerëz që presin të zënë vendin tuaj. Dera është atje". Një tjetër rrëfen se "menaxhmenti i firmës kërkoi të mblidhnim para për një matës tensioni, sepse na trajtojnë vetë dhe nuk duan të thërrasin një mjek po qe se na bie të fikët". Të dyja punëtorët duan të mbesin anonime, si shumë të tjera që patën guximin e raportuan për Studimin Evropian për Tekstile të Pastra. (CCC) mbi kushtet e punës në industrinë serbe të tekstilit. Vërtet shihet si fat të gesh një vend pune në ekonominë e tregut, në një vend ku papunësia zyrtarisht kap 16%, tek të rinjtë madje 30%.

### TË TRAJTUAR SI SKLEVËR

Në një kohë që punëtorët e industrisë së tekstilit, që i përket kryesisht investitorëve të huaj e ku punohet për tregun evropianoperëndimor, duhet të durojnë kushte prodhimi nën dinjitetin njerëzor dhe arrogancën e drejtuesve të tyre. Në këtë industri sundon një at-



mosferë frike, rregullisht ka kërcënime për humbjen e vendit të punës. Shpesh nuk ofrohen të plota ditët e pushimeve dhe në tualet ose nuk lejohet të shkosh ose me kufizim. "Punëtorët raportojnë, se trajtohen si makineri apo sklevër, jo si njerëz. Atyre u bërtitet, edhe ngacmimi seksual është në rend të ditës", thotë Bettina Musiolek, koordinatore e CCC për Evropën Lindore dhe Juglindore në bisedë me Deutsche Wellen.

Të gjitha këto për një punë me orë shtesë të papaguara dhe një rrogë nën kufirin e varfërisë. Në Serbi zyrtarisht ekzistenca minimale kap shifrën e 278 eurove, dhe një familje me katër anëtarë ka nevojë të paktën për 652 euro që të mbijetojë. Ndërkohë punëtorët e industrisë së tekstilit fitojnë vetëm 202 euro në muaj, në industrinë e këpucëve 227 euro. Rreth 100.000 vetë janë të punësuar në Serbi në këtë sektor. Por Serbia nuk përbën përjashtim. "Për markat globale të modës, vendet e Evropës Lindore dhe të Ballkanit janë parajsë e rrogave të ulta", theksojnë autorët e studimit. Mes tyre gjenden firma si Benetton, ESPRIT, GEOX apo Vero Moda, por edhe marka botërore si Armani, Calzedo-

nia, Dolce & Gabbana e H&M. Madje edhe markat e luksit Louis Vuitton, Prada dhe Versace prodhojnë lirë aty produktet e shtrenjta. Këto vende ofrojnë punëtorët të kualifikuar e me çmim të lirë. Rrogat mujore të punëtorëve mezi i arrijnë pagat minimale shtetërore, që variojnë nga 89 euro në Ukrainë në 374 euro në Sllovakia. Një rrogë që mjafton për të jetuar duhet të ishte katër deri në pesë herë më e lartë.

Ndërkohë këto marka vendosin etiketën "Made in Europe" ose "Made in EU" duke i ofruar kështu konsumatorit idenë se markat prodhohen në kushte të ndershme. "Në realitet të 1,7 milionë punëtorët e tekstilit në rajon jetojnë në varfëri", thuhet në studimin e CCC-së. "Nganjëherë as nuk kemi për të ngrënë", thotë një punëtorë ukrainase. Këto kushte janë të mundura vetëm në një ambient shoqëror tejet miqësor ndaj punëdhënësve. "Këtu bëhet fjalë kryesisht për një zonë pa sindikata, askush nuk i mbron interesat e punëtorëve", thotë Musiolek. Në një kohë që qeveritë japin subvencione direkte ose jo direkte për firmat e huaja. Kështu në Serbi, firma të tilla marrin subvencione të majme si dhe truall nën vlerën e tregut, nganjëherë

edhe pa para, e këtyre favoreve i shtohen edhe lehtësimet tatimore apo një infrastrukturë falas.

### MARRËDHËNIE SI NË KAPITALIZIMIN E HERSHËM

Ka një konkurrencë ekonomike të drejtuar për poshtë, thotë Stefan Aleksiq, një nga autorët e studimit në bisedë me Deutsche Wellen. "Rreth Serbisë ka vende edhe më të varfra, e të gjithë luftojnë për të njëjtat investime. Kështu krijohet konkurrenca. Kush i ofron kapitalit të huaj kushte më të mira për një prodhim të lirë". Rezultati katas-trofik. Shtetit financon prapambetjen ekonomike", thotë Aleksiq. Megjithatë fushata për veshje të pastra nuk bën thirrje për bojkotim. "Punëtorët na thonë gjithmonë "Ne kemi nevojë për këto punë. Por ato duhet të paguhen si duhet dhe të përmirësohen kushtet e punës", thotë Bettina Musiolek. Rruga deri aty është ende e gjatë. "Fillimisht duhen forcuar sindikatat. Nuk mund ta besosh se marrëdhëniet e punës aty janë si në kapitalizmin e hershëm dhe se sa të dobët janë aktorët e tregut të punës", thekson Musiolek.

(DW)

## S'ka Ushtri të Kosovës, pa pajtimin e Listës Serbe

Formimi i Ushtrisë do ta sfidojë edhe Qeverinë "Haradinaj". Shndërrimi i Forcës së Sigurisë në Forcë të Armatosur vazhdon të mbetet ende temë sa e nxehtë aq edhe e paprekshme, kjo për një faktor

të vetëm Lista Serbe. Rexhep Selimi nga Lëvizja Vetëvendosje thotë se nuk ka formim të Ushtrisë pa pëlqimin e Listës Serbe. Madje, ai shtoi se përdërisa kjo parti është e ndikuar kryekëput nga

Beogradi, nuk duhet të pritet që të ndryshojnë mendim për këtë çështje. Analisti Haki Abazi po e vlerëson si gabim të madh të institucioneve të mëhershme të cilët me marrëveshjet e nënshkruara në

Bruksel i kanë dhënë rol shumë të madh kësaj partie në temat kyçe për zhvillimin e vendit. Transformimi i Forcave të Sigurisë në Forca të Armatosura ishte premtuar vite më parë nga shumë Qeveri.

## Dy muaj afat për Demarkacionin

**Marrë parasysh se në Bruksel pritet që fokusi të orientohet kah zgjedhjet e ardhshme për Parlamentin Evropian, vonesat e reja në Prishtinë rreth ratifikimit të Demarkacionit, besohet se do të reflektonin në zvarritje të reja në procesin e liberalizimit të vizave**



Institucioneve të Kosovës u kanë mbetur më pak se dy muaj që të ratifikojnë Marrëveshjen për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, nëse synojnë të ecin përpara me procesin e liberalizimit të vizave. Ky

mesazh, përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës, u është transmetuar javëve të fundit si nga ana e zyrtarëve të Bashkimit Evropian, ashtu edhe nga zëvendësndihmëssekretari amerikan i shtetit, Hoyt

Brian Yee, i cili qëndroi para pak ditësh në Prishtinë. Marrë parasysh se në Bruksel pritet që fokusi të

orientohet kah zgjedhjet e ardhshme për Parlamentin Evropian, vonesat e reja në Prishtinë rreth ratifikimit

të Demarkacionit, besohet se do të reflektonin në zvarritje të reja në procesin e liberalizimit të vizave. Për urgjencën e përmblyljes së çështjes së Demarkacionit ka folur vetë ministrja e Integritimit Evropian në Qeverinë e Kosovës, Dhurata Hoxha, e cila kohë më parë ka qëndruar në Bruksel. Ajo ka pranuar se zyrtarët e BE-së janë të interesuar që kjo çështje të mbyllet pa vonesa të reja. "Unë, në takimet e mia në Bruksel, patjetër që i kam informuar për zhvillimet e

fundit në Qeveri, për përpjekjet dhe iniciativat që i ka ndërmarrë kryeministri në lidhje me formimin e Komisionit të ri për shënjimin e vijës kufitare dhe punën që ai po bën, por edhe përkundër këtij raportimi, prapë është përsëritur që ratifikimi i Demarkacionit mbetet kusht kyç. Një kërkesë ka qenë që të procedohet sa më shpejt, ngase më pastaj fillojnë zgjedhjet në Parlamentin Evropian", ka thënë ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha.





## Shqiptarët të parët në Evropë për konsumim të ilaçeve

Më se 5 për qind të shpenzimeve për kujdesin shëndetësor, familjet shqiptare i shpenzojnë duke blerë ilaçe. Pjesa e mbetur shkon për shërbime mjekësore. Raporti përmbyset në vendet e tjera të Evropës, ku shpenzimet për ilaçe zënë vetëm 7-15 për qind të shpenzimeve për kujdesin shëndetësor. Shifrat nxjerrin në pah kulturë e konsumimit të lartë të barnave që ekziston në Shqipëri. Jo thjesht për shkak të rekomandimit të mjekut, por edhe sepse shumë barna mund blihen në farmaci pa recetën e mjekut. Kjo e bën popullsinë shqiptare të ketë një nivel shumë të lartë shpenzimesh për medikamente.

Tendenca e konsumimit të ilaçeve po vjen në rritje edhe pse popullsia po shkon drejt tkurrjes. Në 8 muajt e parë të këtij viti, u importuan 3374 tonë produkte farmaceutike ose 15.9 miliardë lekë, raporton Monitor.

Në krahasim me vitin e kaluar, importi i ilaçeve është rritur me 7%, që do të thotë se shqiptarët kanë konsumuar më shumë ilaçe për këtë vit. Faktorët që ndikojnë në rritjen e konsumit janë disa; që nga plakja e popullsisë, rezistenca ndaj ilaçeve për shkak të përdorimit të tepërt dhe rritja e sëmundshmërisë. Farmacistët e pranojnë se imuniteti ndaj ilaçeve është në rritje. Përdorimi i shpeshtë rrit rezistencën, për pasojë i sëmuri ka nevojë të konsumojë me shumë medikamente.

Edhe ushqimet e pakontrolluara, apo dhe jeta sedentare kanë ndikuar në uljen e reagimit të trupit ndaj virozave. Instituti i Shëndetit Publik ka gjetur nëpërmjet një anketimi se antibiotikët merren në 24 për qind të rasteve pa recete mjekësore. Marrja në këtë mënyrë e antibiotikëve nga përdoruesit i ka bërë shumë prej tyre rezistentë ndaj veprimt të tyre. Në veçanti, 73% e individëve gabimisht konsideruan se dhimbjet e fytyrë mund të trajtohen me antibiotikë.

Për më tepër, 69% e pjesëmarrësve deklaruan se ftohjet e zakonshme dhe gripi duhet të trajtohen me antibiotikë.

Gjithashtu, 41% dhe 34% të individëve konsiderojnë të përshtatshme përdorimin e antibiotikëve për dhimbje të përgjithshme të trupit dhe të kokës.

# Pse po acarohet kriza mes Iranit dhe Arabisë Saudite

**Situata u përkeqësua pasi Riadi shkatërroi një raketë të lëshuar prej rebelëve jemenas, të mbështetur nga Irani, dhe ka akuzuar Teheranin për "akt lufte"**

Marrëdhëniet midis Arabisë Saudite dhe Iranit kanë patur ulje dhe ngritje, që nga revolucioni iranian i vitit 1979 dhe nga përpjekja e Teheranit për të luajtur një rol udhëheqës në nivel rajonal. Pozicionet e fundit anti Iran të presidentit të SHBA, Donald Trump dhe mbështetja për Riadin, sigurisht nuk e thjeshtojnë situatën. Sidoqoftë, në ditët e fundit, përplasja historike midis dy fuqive ka arritur nivele të reja tensionesh, për shkak të një numri rrethanash.

## RAKETAT E LËSHUARA NGA JEMENI

Marrëdhëniet mes dy vendeve janë përkeqësuar pas të shtunës së 4 nëntorit, kur Arabia Saudite tha se kishte interceptuar dhe shkatërruar një "raketë balistike" në verilindje të kryeqytetit Riad, lëshuar nga rebelët jemenitë Houthi, të mbështetur nga Irani. Raketat e lëshuara ranë pranë aeroportit ndërkombëtar të Riadit.

Pas lëshimit të tyre, princi trashëgimtar saudit Mohammed bin Salman akuzoi Iranin për "agresion të drejtpërdrejtë ushtarak" ndaj Arabisë Saudite, sepse furnizon me raketa rebelët e Jemenit. Teherani hodhi poshtë këtë argument dhe paraqiti një ankesë formale në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për t'u mbrojtur. Përveç kësaj, presidenti iranian Hassan Rouhani akuzoi Riadin për nxitjen e armiqësisë në Jemen, duke forcuar pozitën e shtetit të vetëshpallur islamik dhe duke orkestruar dorëheqjen e Kryeministrit libanez Saad



Hariri, si dhe duke e zhytur vendin në kaos.

"Pse treguat armiqësi ndaj popujve të Sirisë dhe Irakut? Pse e forconi ISIS dhe braktisni popujt e vendeve ku ISIS bën ligjin? Pse ndërhyntë në punët e brendshme dhe në qeverisjen e Libanit?", tha Rouhani ndërkohë që i raportonte qeverisë së tij për dorëheqjen e Haririt. Një nga ngjarjet e raportuara nga Presidenti iranian është njoftimi televiziv me të cilin kryeministri libanez Saad Hariri dha dorëheqjen pasi u kthye nga vizita në Arabinë Saudite. Në fjalimin e tij,

Hariri tha se ishte në rrezik për jetën dhe akuzoi Iranin për kontrollimin e rajonit, së bashku me militantët shiitë të lëvizjes Hezbollah. Hariri është politikani sunit me më shumë ndikim në Liban dhe është më pranë mbretërisë saudite.

Që nga dhjetori 2016 ai ka udhëhequr qeverinë libaneze dhe koalicioni i tij qeveritar ka përfshirë gjithashtu Hezbollahun. Njoftimi i dorëheqjes së tij ka sjellë në Liban përplasjen e fortë mes sunitëve të mbështetur nga Arabia Saudite, dhe shiitëve, të mbështetur nga Irani.

## DORA E FORTË E PRINCIT

Njoftimi i dorëheqjes së Haririt erdhi në prag të një sërë arrestimesh nga një trupë e re anti-korrupsion në Arabinë Saudite.

Ndodhi në fakt arrestimi i 11 princave dhe dhjetëra ish-ministrave në një përpjekje për të konsoliduar pushtetin e kurorës të princit Mohammed bin Salman, i biri 32-vjeçar i Mbretit.

Kjo lëvizje, së bashku me qëndrimin ndaj Iranit, ka rikthyer "luftën e ftohtë" për kontrollin e rajonit mes Riadit dhe Teheranit, tashmë në një fazë të re dhe ogurzezë.

## TRIUMF PËR IRANIN

Prej vitesh Arabia Saudite dhe Irani qëndrojnë në një gjendje lufte përballë njëri-tjetrit. Arabia Saudite mbështeste forcat sunitë islamiste, në një kohë që Irani me forcat e gardave të revolucionit dhe Hizbollahun luftoi në krah të Asadit. Me Rusinë, një aleat tjetër, ky regjim bëri të tërhiqeshin forcat xhihadiste me në krye ato të të ashtuquajturit "Shteti Islamik". Në fund të kësaj jave, ushtria siriane mori qytetin e fundit të IS-it, Albu Kamal. Me fitoren ushtarake të Asadit, Irani fiton influencë në rajon. Një shenjë tjetër e rritjes së tensionit mes dy vendeve është edhe deklarata e dorëheqjes së kryeministrit libanez, Saad Hariri. Hariri që prej disa kohësh qëndron në Arabinë Saudite, dha fundjavën e shkuar dorëheqjen nga qeveria e koalicionit. Ai akuzoi forcat e milicëve shiitë të Hizbollahut se po nxisin trazira. Por nga ana e tij Hizbollahu akuzoi Arabinë Saudite, se e ka detyruar Haririn të japë dorëheqjen dhe të qëndrojë në Arabinë Saudite. Madje kreu i Hizbollahëve, Hasan Nasrallah në një fjalim televiziv akuzoi qeverinë saudite, se po kërkon të nxisë Izraelin të ndërmarrë sulm kundër Libanit.

# Me përgjegjësi për Evropën

**Në Paris, presidenti i Gjermanisë Frank-Walter Steinmeier vlerësoi nismën për politikën evropiane të presidentit francez Emmanuel Macron. Të dy presidentët përurojnë në Alzasë një memorial për Luftën e Parë Botërore**

Takimi Steinmeier-Macron fokusohet tek e shkuara për të ardhmen: Hartmannswillerkopf në Alzasë ka qenë në Luftën e Parë Botërore skena e luftimeve të tmerrshme gjermano-franceze. Sot ajo do të kthehet në një memorial të luftës në shenjë e pajtimit gjermano-francez. Ish-kundërshtarët e luftës botërore, Gjermania dhe

Franca, janë të vetëdijshëm për detyrën e tyre, "për ta drejtuar Evropën në një të ardhme më shpresëdhënëse dhe më të mirë", tha presidenti Frank-Walter Steinmeier para gazetarëve në pallatin Élysée. Para kësaj konference shtypi ishte zhvilluar takimi me homologun francez Emmanuel Macron. Ky i fundit shtoi, se

"Ne ndajmë mendimin, që është i nevojshëm dhe urgjent një rithemelim i Bashkimit Evropian." Viti i ardhshëm do të jetë vendimtar, për të vënë në lëvizje nismën gjermano-franceze. Pas bisedës në Paris të dy politikanët u nisën për në Alzasë në Lindje të Francës. Atje ata duan të ndërtojnë në Hartmannswillerkopf muzeun e parë gjermano-francez për Luftën e Parë Botërore. Në një mal, që në frëngjisht quhet Vieil Armand ose në gjuhën rajonale Hartmannswillerkopf, ushtarët gjermanë e francezë në Luftën e Parë Botë-

rore (1914-1918) kanë zhvilluar luftime të ashpra. Për shkak të 30.000 viktimeve mali quhet edhe "ngrënësi i njerëzve". Sipas të dhënave franceze, në muzen e ri të përbashkët synohet që të kujtohet lufta në shenjë e pajtimit të armiqve të betuar të dikurshëm Gjermanisë dhe Francës. Afrimi i Gjermanisë dhe Francës pas Luftës së Dytë Botërore konsiderohet si shtylla themelore e Bashkimit Evropian. Macron deklaroi, se ai do të shqyrtojë detajet me kancelaren Angela Merkel, sapo të jetë krijuar koalicioni qeveri-



tar. Bëhet fjalë për një "projekt të ri evropian", në të cilin Gjermania dhe Franca kanë rolin e një "motori". Menjëherë pas zgjedhjeve parlamentare në Gjermani Macron në

një fjalim parimor shpallsi idenë e tij për zhvillimin e mëtejshëm të BE-së. Disa kërkesa megjithatë si p.sh. buxheti për Eurozonën janë të diskutueshme në Gjermani.



Varfëria dhe mungesa e institucioneve efikase shtetërore në këto zona ka krijuar një mungesë zhvillimi dhe mundësie që ka lehtësuar shfaqjen e forcave ndikuese siç janë themelet islamike me ide radikale. Norma e papunësisë në Shqipëri gjatë periudhës 2010-2015 ishte rreth 18-21 për qind i forcës totale të punës. Akoma më i lartë në rajone nga të cilat vinin shumica e ekstremistëve shqiptarë që shkuan të luftonin në Siri dhe Irak, siç janë Pogradeci, Elbasani, Librazhdi, Bulqiza, Burreli dhe Dibra


# Të luftosh radikalizmin dhe hoxhallarët e internetit



shpjegoi babai i tij Esad Kundakoviç.

Esad Kundakoviç ishte në dijeni të qëllimit të djalit të tij - Eldarit, për të shkuar të luftonte dhe u përpoq ta parandalonte atë, por Eldari ishte i bindur se misioni i tij ishte i drejtë. Ai i tha babait të tij se do të shkonte në Stamboll për të studiuar, por përfundoi në Alepo. Herën e fundit që Esad Kundakoviç dëgjoi për të birin ishte në pranverën e vitit 2013. Në maj, ai u vra. Që prej vdekjes së djalit të tij, Kundakoviç është përpjekur të parandalojë që të rinj nga zona e Sanxhakut të shkojnë t'i bashkohen luftërave në Lindjen e Mesme. Sipas policisë serbe, rreth 50 persona nga Sanxhaku kanë shkuar të luftojnë për kauzën islamike.

Kundakoviç, rrobaqepës, tha se tani i është kushtuar arsimimit të të rinjve në Sanxhak për fenë dhe jetën. "Dua të kontribuoj me autoritetin time dhe eksperiencën që kam, sepse im bir vdiq atje, për të ndihmuar këta të rinj", tha ai për BIRN. "Ata duhet ta kuptojnë se do të ketë luftëra deri Ditën e Gjykimit, por ata s'duhet të kontribuojnë në to", tha ai. Kundakoviç punon falas. Ai nuk ka një organizatë apo njerëz që punojnë me ata, por ai i bashkohet



**Esad Kundakoviç ishte në dijeni të qëllimit të djalit të tij - Eldarit, për të shkuar të luftonte dhe u përpoq ta parandalonte atë, por Eldari ishte i bindur se misioni i tij ishte i drejtë. Ai i tha babait të tij se do të shkonte në Stamboll për të studiuar, por përfundoi në Alepo. Herën e fundit që Esad Kundakoviç dëgjoi për të birin ishte në pranverën e vitit 2013. Në maj, ai u vra**

paneleve dhe debateve të ndryshme dhe shkon në xhamitë në Novi Pazar ku flet me të rinj që kanë filluar tashmë ta shohin atë si një autoritet moral që jep këshilla të zgjuara. Ai flet gjithashtu me të rinj në internet për informacionet që ata gjejnë në internet apo që i marrin nga predikuesit radikalë. "I lexoj bashkë me të rinj dhe pastaj i interpretojme bashkë, që të mund të krijojnë një ide më të

qartë. Por nëse një djaloshi i ri i lexon ato vetëm natën dhe nuk di asgjë për luftën, ai ka shumë gjasa të ndikohet", tha ai.

## IMAMËT LUFTOJNË PËR ZEMRA DHE MENDJE TË REJA

Në vendet e Ballkanit, radikalizmi i të rinjve këqenë edhe më problematik, siç është rasti i Shqipërisë, ku pothuajse 150 persona kanë udhëzuar drejt Lindjes së Me-

sme. Në Shqipëri njerëzit janë shënjestruar nga imamë të vetëshpallur që predikojnë versione ekstreme të islamit duke promovuar dhunë kundër jo besimtarëve. "Në rastin e Shqipërisë, imamët e vetëshpallur kanë pasur një rol shumë negativ në nxitjen e të rinjve drejt radikalizmit nëpërmjet ideologjisë së fortë të islamit ekstrem politik", tha për BIRN Indrit Abdij, drejtor i Forumit Intelktual Mysliman Shqiptar dhe themelues i Qendrës për Zhvillim Rinor dhe Përmirësim Profesional. Abdij tha se ai beson se mënyra më e mirë për t'i mbajtur të rinjtë larg radikalizmit është duke u ofruar atyre interpretime jo të dhunshme të islamit dhe duke i mbajtur të përfshirë në shoqërinë myslimane.

"Duhet t'u japim atyre një tjetër narrativë dhe t'i bëjmë pjesë të komuniteteve tona", tha ai. Abdij kujtoi rastin e një 25-vjeçari nga Elbasani i cili me shumë pak përpjekje nga komuniteti, u largua nga identiteti ekstremist. "Ne e identifikua atë si një person që kishte respekt dhe admirim për ideologjinë e ISIS. Hapi i parë ishte organizimi i një takimi mes tij dhe imamit vendas, ndërkohë që e ftuam atë nëpër diskutime ku flitej për çështje në lidhje me islamin dhe paqen", shpjegoi ai. Sipas Abdij, i riu filloi gradualisht të ndryshonte besimet e tij ndërsa kuptonte se shumica dërrmuese e myslimanëve e refuzojnë ideologjinë ekstremiste.

"Ai tani është i angazhuar dhe bën një jetë të mirë, ndërkohë që s'ka më ide që kishte në të kaluarën", tha ai. Megjithatë, t'i bindësh njerëzit të heqin dorë nga ideologjia ekstremiste s'është gjithmonë aq e lehtë. Abdij beson se mungesa e mundësive në jetë, si edhe izolimi gjeografik dhe personal, kanë ndihmuar në procesin e radikalizmit. Problemet familjare janë një tjetër faktor në nxitjen e njerëzve drejt ekstremizmit, shtoi ai. "Këta të rinj të rritur shpesh vijnë nga familje me probleme sociale të shkaktuara nga emigrimi, divorcet dhe ngjarje traumatike", tha ai. Organet zyrtare isla-

mike në Shqipëri kanë filluar gjithashtu të kërkojnë mënyra të ndryshme për të ndikuar pozitivisht te besimtarët, në veçanti të rinjtë.

Edhe pse ata tradicionalisht orientoheshin drejt komunikimit në xhami, shumë prej tyre tani janë në internet, duke u përpjekur të përzihen me myslimanë më të rinj që mund të jenë të prekshëm nga radikalizmi. Ylli Gurra, një myfti në Tiranë dhe përfaqësues i Komunitetit zyrtar Mysliman Shqiptar, tha se imamët i kanë këshilluar ndjekësit e tyre - sidomos të rinjtë - të rrinë larg xhamive informale që nuk njihen nga Komuniteti Islamik dhe ku klerikët radikalë predikojnë interpretime ekstremiste të islamit. Gurra dikur fliste vetëm ballë përballë me myslimanët, por ai tani flet në internet, sidomos me të rinjtë. "Shumica e imamëve besojnë se predikimi dhe këshillimi nëpërmjet rrjeteve sociale nuk është i nevojshëm gjatë gjithë kohës. Unë personalisht i përdor më shumë për të dhënë një kundër-narrativë në raste që në internet predikohen forma jo korrekte të islamit", tha ai për BIRN.

## VARFËRIA KRIJON BAZË PËR EKSTREMISTËT

Disa OJQ me bazë në Ballkan kanë kryer disa anketime duke eksploruar arsyet pse të rinjtë i janë drejtuar ekstremizmit të dhunshëm, me përgjigje që sugjerojnë se shumica prej tyre shpesh janë ndjerë të izoluar dhe mendonin se s'kishin perspektivë për të ardhmen. Një raport nga Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare nga viti 2015 arriti në përfundimin se radikalizmi islamik i vendit ka rrënjë socio-ekonomike dhe se shumica e ekstremistëve islamikë vinin nga zona të largëta dhe fetare.

Varfëria dhe mungesa e institucioneve efikase shtetërore në këto zona ka krijuar një mungesë zhvillimi dhe mundësie që ka lehtësuar shfaqjen e forcave ndikuese siç janë themelet islamike me ide radikale. Norma e papunësisë në Shqipëri gjatë periudhës 2010-2015 ishte rreth 18-21 për qind i forcës totale të punës. Akoma më i lartë në rajone nga të cilat vinin shumica e ekstremistëve shqiptarë që shkuan të luftonin në Siri dhe Irak, siç janë Pogradeci, Elbasani, Librazhdi, Bulqiza, Burreli dhe Dibra. Norma e papunësisë për persona të moshës 17 deri në 35 vjeç, që janë edhe më të cenueshëm ndaj radikalizmit, ishte



"Fillova të agjëroja çdo ditë, sepse mendoja se duhej të kapja ritmin. Rrita mjekrën, shkova në Xhaminë Fahd në Arabinë Saudite. Shkoja në Brijesce (zonë e Sarajevës), në xhemat (xhami e paregjistruar) për leksionet e tyre", tha ai. Shumica e "vëllezërve" të tij radikalë përfunduan duke u bashkuar Shtetit Islamik në Lindjen e Mesme, tha ai - por ai, nga ana tjetër, filloi të përqendrohej përsëri te studimet e tij dhe u largua nga qarqet islamike pas katër vjetësh. Po të mos e kish të bërë, ai mund të kish të përfunduar si djali i Esad Kundakoviçit, i cili u vra katër vjet më parë kur forcat e presidentit sirian Bashar Al Assad nisën një ofensivë kundër qytetit të Alepos. Eldar Kundakoviç, një student psikologjie që vinte nga qyteti serb i Novi Pazarit në zonën me shumicë myslimane të Sanxhakut, vendosi të shkonte në Siri "për të ndihmuar vëllezërit e tij myslimanë",

**Disa OJQ me bazë në Ballkan kanë kryer disa anketime duke eksploruar arsyet pse të rinjtë i janë drejtuar ekstremizmit të dhunshëm, me përgjigje që sugjerojnë se shumica prej tyre shpesh janë ndjerë të izoluar dhe mendonin se s'kishin perspektivë për të ardhmen**



**Eldar Kundaković, një student psikologjie që vinte nga qyteti serb i Novi Pazarit në zonën me shumicë myslimane të Sanxhakut, vendosi të shkonte në Siri "për të ndihmuar vëllezërit e tij myslimanë", shpjegoi babai i tij Esad Kundaković**

edhe më e lartë, në disa zona e kapërcente 40-45 përqindëshin. Pedrag Petroviç nga Qendra për Studime të Sigurisë në Beograd tha për BIRN se nuk ka një faktor specifik që inkurajon njerëzit të përqafojnë ekstremizmin, edhe pse ai citoi papunësinë si një prej problemeve kryesore. "Vendet e Ballkanit janë në pozitë të keqe ekonomike, e cila po përkeqësohet. Kështu që pritshmëritë e të rinjve nuk përmbushen", tha ai.

Petroviç tha se radikalët kanë përfitur nga të rinj që kërkojnë informacione në internet. "Interneti u ofron të rinjve informacione të të gjitha llojeve dhe ata kanë nevojë për përgjigje të shpejta. Kështu që ata i rikthehen atyre që u ofrojnë atyre përgjigje", tha ai. "Ata janë një objektivi i lehtë, sepse duan të ndihen të sigurt dhe duan të kenë ndjesinë se dikush kujdeset për ta", shtoi ai. Trajtimi i këtij kërcënimi në internet është pjesë e një strategjie të miratuar nga Komuniteti Mysliman në Serbi për të luftuar ekstremizmin dhe probleme të tjera që prekin të rinjtë në Novi Pazar. Strategjia parashikon arsimimin e përfundues të institucioneve fetare dhe komunale, rritjen e aftësive komunikuese të anëtarëve të Komunitetit Islamik, përmirësimin e dijeve kompjuterike dhe përdorimit të internetit dhe punën me median për të zhvilluar marrëdhënie më të mira dhe më pozitive.

Komuniteti Islamik në Bosnjë dhe Hercegovinë është përfshirë më shumë në arsimimin e të rinjve dhe forma të tjera angazhimi gjatë viteve të fundit, ose nëpërmjet leksioneve në lidhje me vlerat e islamit ose nëpërmjet takimeve në të gjithë Bosnjën ku të rinjtë vijnë të luajnë sporte.

Komuniteti Islamik përpiqet gjithashtu të shpjegojë islamit e moderuar nëpërmjet Fakultetit për Shkenca Islamike në Sarajevë, që bashkëpunon me institucione të tjera në vend për të promovuar ato që ai i quan "vlera të vërteta të islamit dhe shkencës së tij".

Sipas Zuhdija Hasanović, dekani i fakultetit, përgjigja më e mirë ndaj abuzimit të vlerave fetare është të punosh me ata që i janë drejtuar ideologjive të dhunshme dhe të promovosh vlerat e vërteta të islamit. "Ky është një proces i gjatë që s'jep menjëherë rezultate, por nuk shoh zgjidhje tjetër", tha Hasanović.

(BIRN)

**Zyrat e gjendjes civile në Gjermani këtej e tutje krahas seksit "femër" dhe "mashkull" duhet të regjistrojnë edhe seksin e tretë për trasngjinorët. Ky është vendimi i Gjykatës Kushtetuese në Gjermani**

Vendimi i kushtetueses është mëse i qartë: Është diskriminim, nëse njerëzit interseksualë, gjinia e të cilëve është e papërkufizuar qartë, të duhet të vendosin gjatë regjistrimit për seksin "femër" ose "mashkull", kështu argumentoi Gjykata Kushtetuese të mërkurën (08.11). Deri më tani kanë ekzistuar vetëm këto dy emërtime për regjistrat e gjendjes civile. Me këtë vendim pati sukses ankesa e një personi, që është trasngjinor dhe që gjatë konfrontimit me autoritetet donte t'i përmbahej seksit të vet. Legjislativi ka tani kohë deri në fund të vitit 2018 për të vendosur rregullat e reja mbi bazën e këtij vendimi.

Aq më domethënëse është ky vendim, kur merr parasysh që në instancat më të ulëta si në Gjykatën e Faktit në Hanover, ashtu edhe Gjykata e Lartë patën dhënë vendime krejt të ndryshme. Këshilli gjerman i Etikës, i angazhuar nga parlamenti, është prononcuar qysh para katër vjetësh, duke argumentuar se është ndërhyrje e pajustificueshme në të drejtat e personalitetit, nëse njerëzit trasngjinorë duhet të vendosin për njërin nga dy seksat. Teologu



## Barazi gjinore edhe për gjininë e tretë

i moralit Andreas Lob-Hüdepohl, anëtar i Këshillit të Etikës e mbështet këtë vendim. Për DW ai thotë: "Nga këndvështrimi etik interseksualiteti është i kushtëzuar me trupin, një variant i jashtëzakonshëm i biseksualitetit të njohur në jetën njerëzore dhe shtegut të zhvillimit të tij seksual. Personat trasngjinorë meritojnë të pranohen dhe respektohen plotësisht." Tek njerëzit trasngjinorë nuk mund të përcaktohet qartë gjinia. Shkaqet mund të jenë kromozomet seksuale, por edhe kushtëzimi hormonal.

Institucioni Federal i Antidiskriminimit, një autoritet, që është krijuar para dhjetë vjetësh, e vlerësoi vendimin si historik. Drejtuesja e këtij autoriteti Christine Lüders mendon, se vendimi përcakton qartë edhe se martesat për të gjithë, që u vendos në Bundestag, vlen edhe për trasngjinorët.

"Ky vendim është një hap i madh në aspektin e të drejtave të njeriut dhe tani ai duhet të pasohet nga rregulla të qarta", thotë për DW Lucie Veith nga shoqata "e njerëzve interseksualë" në bisedë për

DW. Edhe Instituti për të Drejtat e Njeriut, që pati paraqitur një ekspertizë për barazinë gjinore të interseksualëve, e vlerësoi vendimin e kushtetueses. Disi më me distancë ka reaguar zëdhënësi i ministrit të Brendshëm kristiandemokratit Thomas de Maiziere (CDU), Johannes Dimroth, në Berlin: Kjo ministri është përgjegjëse për zyrat e gjendjes civile: "Vendimi është ende i freskët. Nuk dua ta komentoj atë tani, por natyrisht që ne e respektojmë këtë gjykim", u shpreh zëdhënësi.

## Rusia e Putinit, "kërcënim i madh" për demokracitë perëndimore

**Deklarata vjen në prag të një takimi të ministrave të Jashtëm të Bashkimit Evropian, më 13 nëntor, kur do të vlerësohet se si po funksionon komunikimi strategjik i bllokut me fqinjët e tij lindorë**

Një grup i ekspertëve të sigurisë dhe politikës së jashtme thotë se qeveritë perëndimore kanë qenë "të kufizuara dhe të dobëta" në përgjigjen e tyre ndaj "veprimeve armiqësore" të Kremlinit. Në një deklaratë të iniciuar nga Instituti i Vlerave Evropiane, me seli në Pragë, dhe të titulluar "Perëndimi demokratik duhet të ndalojë Putinin", rreth 70 ekspertë thonë se duhet të ndërmerren hapa për të penguar planet e presidentit rus, Vladimir Putin, për të luajtur "përçaj dhe sundo" në zonën euroatlantike. "Vladimir Putin ka vendosur të trembë dhe të shqetësojë demokracitë dhe një pjesë e madhe e strukturës politike perëndimore




nuk e ka kuptuar ende këtë", thuhet në deklaratën e publikuar të enjten. "Disa vende frikësohen me kërcënime, të tjerave u jepen premtime, në dukje të dashura, nëse marrin qëndrim më antiperëndimor, antidemokratik dhe antiliberal", thuhet tutje në deklaratë.

Sipas së njëjtës, gati të gjitha vendet janë të sulmuara me spiunazh, korrupsion dhe krime të organizuara, si dhe me fushata të pandërprera të dezinformatave. Deklarata vjen në prag të një takimi të minis-

trave të Jashtëm të Bashkimit Evropian, më 13 nëntor, kur do të vlerësohet se si po funksionon komunikimi strategjik i bllokut me fqinjët e tij lindorë. Deklarata e Institutit të Vlerave Evropiane u bën thirrje udhëheqësve politikë të pranojnë kërcënimin që paraqet Rusia për demokracitë perëndimore dhe të hetojnë dhe ekspozojnë aktivitetet e saj armiqësore. "Rusia e Putinit duhet të ndërmerret me kërcënim të madh për demokracitë perëndimore. Përdorimi i mjeteve përçarëse për ndikim armiqësor në

çështjet e brendshme të vendeve demokratike është i papranueshëm dhe duhet të kundërshtohet me veprime mbrojtëse", thuhet në deklaratë. Liderët e BE-së i janë përgjigjur fushatës ruse të dezinformimit në vitin 2015 duke krijuar grupin e punës Stratcom-i Lindor, me qëllim promovimin e vlerave dhe politikave të bllokut në, siç është thënë, lagjen lindore.

BE-ja po ashtu ka ngrirë asetet dhe ka vendosur ndalesa udhëtimi për mbi 150 njerëz, pasi Rusia ka aneksuar në mënyrë të paligjshme gadishullin ukrainas të Krimesë në vitin 2014, por vetëm një numër i vogël i tyre janë zyrtarë të lartë të Moskës. Grupi i nënshkruar të deklaratës së Institutit të Vlerave Evropiane thotë se këto përpjekje nuk kanë pasur ndikim të madh. "Nëse Evropa dëshiron ta mposhtë këtë kërcënim, liderët e saj duhet ta thërrasin atë me emër. Liderët rusë duhet të dëgjojnë nga përfaqësuesit evropianë se këto përpjekje përçarëse armiqësore kundër demokracive tona duhet të ndalojnë", thuhet në deklaratë.



## Lëngu i gjelbër që ndal dhimbjen e kokës



Një në dy persona në botë vuan nga dhimbjet e kokës ose migrena. Të gjithë ata që e kanë provuar këtë dhimbje, e dinë se nuk ka dhimbje më acaruese. Dhimbjet e kokës zakonisht shkaktohen nga stresi, por ka edhe faktorë të tjerë kontribuues përfshirë edhe mënyrën e të ushqyerit jo të shëndetshëm, ankthin ose qëndrimin e gjatë para ekranëve të telefonit ose kompjuterit. Në ndërkohë kur përjetojmë dhimbje të tilla, pothuajse gjithmonë zgjidhjen tentojmë ta gjejmë tek barnat. Por nëse nuk e keni ditur, përveç barnave që mund të merren lehtësisht në farmaci, ka edhe alternativa natyrale që mund ta trajtojnë me sukses këtë problem. Më poshtë gjeni një ilaç natyral kundër dhimbjeve të kokës shumë efektiv. Ky lëng i jashtëzakonshëm përpos që ndihmon në ndaljen e dhimbjes së kokës është edhe shumë i pasur me magnez dhe kalcium që janë mineralet e duhura për të trajtuar dhimbjet e tilla. Ju duhet vetëm një minutë kohë që ta përgatisni lëngun dhe të ndiheni më mirë!

### ÇFARË JU DUHET?

- 5 kërcëj selino
- 1 limon i gjelbër
- 1 trangull
- 3-4 filxhanë spinaq
- 5 cm xhenxhefil
- 1 filxhan majdanoz
- 2 molla të gjelbra

### SI TA PËRGATISNI KËTË

**LËNG?** Përzieri të gjithë përbërësit në mikser dhe lëngu juaj është gati për tu konsumuar. Gjithmonë konsumojeni këtë lëng të freskët, në mënyrë që të jetë sa më efektiv.

Është pak a shumë ajo që ndodh me disa qeliza imune para një tumori, një armik që duhet të arrihet dhe të asgjësohet: ata tërheqin frenat dhe i lënë qelizat e kancerit të lira në terren për të zgjeruar dhe për të dhënë metastaz


Ashtu si një Ferrari. Kështu funksionon sistemi ynë i mbrojtjes humanitare: është i fuqishëm, i pajisur me përshpejtues që e lënë atë të shkojë dhe të udhëtojë me shpejtësi të lartë, kur është fjala për mbrojtjen e organizmit nga agresionet e rrezikshme, por edhe me frena, të cilat e pengojnë atë të dalë nga rruga. Megjithatë, nëse sistemi frenon shumë, makina vjen duke u ndalur.

Është pak a shumë ajo që ndodh me disa qeliza imune para një tumori, një armik që duhet të arrihet dhe të asgjësohet: ata tërheqin frenat dhe i lënë qelizat e kancerit të lira në terren për të zgjeruar dhe për të dhënë metastazë.

Kjo është metaforë që ndihmon për të kuptuar këtë të fundit, të sofistikuar, zbuluar nga ekipi kërkimor i Alberto Mantovani, drejtor shkencor i Institutit Humanitas të Milanos dhe docent në Universitetin Humanistik, i sapopublikuar në Natyrë dhe financuar nga Airc, shoqata për kërkimet kundër kancerit: bëhet fjalë për zbulimin e një "frenimi" të ri që quhet IL-1R8.

**RËNDËSIA E ZBULIMIT.** Përse është kaq i rëndësishëm? Sot kufiri i fundit i terapive kundër

# Zbulimi i molekulës që kufizon zhvillimin e tumorit



kancerit quhet imunoterapi: lejon që të mbajë tumoret e vështirë, para se të kurohen, të tilla si melanoma, dhe vepron vetëm në sistemin imunitar, duke liruar frenat që e pengojnë atë dhe duke e bërë atë përsëri të aftë për të shkatërruar qelizat e kancerit. Sa për të thënë: pacientët me melanoma, deri pak kohë më parë, mund të mbijetonin disa muaj, sot arrijnë dhjetë vjet jetë më shumë.


Për momentin, ekzistojnë kryesisht dy "frena" që mund të neutralizohen nga imunoterapia: ato quhen Pd1 (dhe Pd11) dhe Ctl4. "Këto" frena "u

përkasin qelizave të sistemit imunitar të quajtur limfocitet T - shpjegon Mantovani. Sidoqoftë, ne kemi zbuluar një tjetër "pajisje frenimi", IL-1R8, e cila gjendet në qeliza të tjera imune të quajtura Killer Natyror, qelizat me "licencë vrasjeje". Ata gjenden në organe si mëlcia dhe mushkëritë, shpesh target metastaze. Ja përse ideja e riaktivizimit të "vrasësve profesionistë", mund të çojnë në terapi të reja anti-metastazë në këto organe.

**EKIPI.** Alberto Mantovani dhe ekipi i tij vazhdojnë të punojnë shumë dhe së shpejti do të

sjellin të reja: falë ndihmës së të rinjve dhe grave. Për shkak se "grupi i kokës" i hulumtimit të botuar nga Natyra është çifti "i lartë" i formuar nga Mantovani dhe Cecilia Garlanda, hulumtues humanitar (shtoi Angela Santoni nga Universiteti La Sapienza i Romës), por nënshkruesit e parë të punës janë dy "shkencëtarë" shumë të rinj, Martina Molgora dhe Eduardo Bonavita, studentë PhD që sapo kanë marrë çmimin Mit, një çmim i dhënë nga prestigjiozi Massachusetts, Instituti i Teknologjisë i Bostonit, dhe punojnë në Itali.

## Çfarë i ndodh fëmijëve nëse i ushqeni me salsiçe?



Salsiçet janë ushqimi i preferuar i miliona njerëzve, veçanërisht në Amerikë, ku shiten në formën e hot dogëve në evente dhe festivale të ndryshme. Disa hulumtime tregojnë se vetëm ditën e katër korrikut, çdo vit amerikanët i konsumojnë më shumë se 155 milionë salsiçe. Sidoqoftë, doktorët thonë se fëmijët që konsumojnë salsiçe kanë një rritje prej 9 % të rrezikut për të zhvilluar leukemi. Veç kësaj, nëse prindi i fëmijës ka konsumuar salsiçe para se të lind fëmija, atëherë fëmija rrezikohet të vuajë edhe nga kanceri.

Nëse nëna gjatë shtatzënisë konsumon më shumë se një salsiçe në javë, rritet rreziku që fëmija të vuajë nga kanceri në tru. Arsyja prapa këtyre është se salsiçet përmbajnë aditivë nitrat potasiumi, që shtohen në prodhimin e tyre për të parandaluar botulizmin. Veç kësaj, gjatë procesit të gatimit këta nitrate të kombinuar me aminet në mish krijojnë një përbërës shumë të rrezikshëm që shkakton kancerin, i njohur ndryshe edhe si N-nitroso. Prandaj, nëse salsiçet janë ushqimi juaj i preferuar, është mirë t'i ndalni menjëherë.

## Duhet t'u lexoni libra me zë fëmijëve

Lexojini me zë të lartë, merrini pak kohë në ditë dhe lexoni libra në prani të tyre. Ndihmijini fëmijët tuaj të kenë një të ardhme sa më të mirë, pavarësisht se mund të jetë shumë herët. Për dije dhe kulturë nuk njihen fjalët "herët" apo "vonë"

Fëmijët arrijnë të kuptojnë shumë mirë çdo gjest apo shprehje të fytyrës që u drejtohet atyre. Mund ta keni vënë re që nëse keni parë një fëmijë me inat, ata kanë filluar të qajnë. E kundërta ka ndodhur kur u keni buzëqeshur. E njëjta gjë ndodh edhe nëse prindërit fillojnë dhe u lexojnë libra me zë të lartë

fëmijëve të tyre. Me siguri, nëse ata janë shumë të vegjël, nuk kanë për ta kuptuar përmbajtjen, por do të mësojnë shumë për zërin dhe shprehjet e prindit. Më pas, kur fëmija të rritet, do të përpiqet të imitojë mënyrën se si ju lexoni, apo se si i kthenit faqet e librit. Të gjitha këto veprime të skalitura në

kujtesën e një fëmije do ta ndihmojnë atë të ruajë përqendrimin dhe të kuptojë kënaqësinë e leximit. Nëse libri ka figura, atëherë fëmija do të kënaqet duke i parë dhe duke i identifikuar ato me emrat përkatës (psh identifikimi i kafshëve në faqet e librit).

Por edhe nëse nuk ka figura, ju duhet ta mësoni fëmijën të paktën se si të kthejë faqet e librit. Kjo do të rrisë përqendrimin e fëmijës suaj. Leximi është pjesë shumë e rëndësishme për një person që do të jetë i kulturuar, ndaj është detyrë e çdo prindi të


marrë fëmijën e tij dhe t'ia shtojë dashurinë për librat që kur ata të jenë të vegjël. Edhe pse mund të mos ju pëlqejnë librat e fëmijëve, apo t'ju duken të kota përballat që do të lexoni, përpuni të mos e shfaqni mospëlqimin tuaj. Nëse ju tregoheni të bezdisur apo e shprehni hapur mospëlqimin tuaj, të njëjtin mospëlqim do të ushqejë edhe fëmija juaj për leximin në të ardhmen.

Kuptohet që komunikimi është pjesë shumë e rëndësishme e përditshmërisë sonë. Ai na mundëson ndërveprimin më të lehtë me të tjerët,



ndaj nëse doni që fëmija juaj të jetë më social në të ardhmen, përpuni t'i bëni ata t'i duan librat. Lexojini me zë të lartë, merrini pak kohë në ditë dhe lexoni libra në prani të

tyre. Ndihmijini fëmijët tuaj të kenë një të ardhme sa më të mirë, pavarësisht se mund të jetë shumë herët. Për dije dhe kulturë nuk njihen fjalët "herët" apo "vonë".



## Lamborghini zbulon supermakinën e mijëvjeçarit të tretë



Lamborghini është bashkuar me Institutin e Teknologjisë së Masaçusetsit për të prezantuar konceptin e një supermakine fantastike. Lamborghini Terzo Millenio është makina e parë e gjitha elektrike e markës italiane. Ajo ka 4 motorë elektrikë, nga një për çdo rrotë. Ashtu si çdo supermakinë, edhe Terzo Millenio ka një pamje të jashtme të jashtëzakonshme, por jo vetëm kaq. Shasia është me panele me fibra karboni, që shërbejnë si depo energjie, duke e kthyer praktikisht shasinë në një bateri. Ky material mund të kapë edhe probleme të ndryshme të makinës dhe të "shërojë" veten.




Diamantet sintetikë kushtojnë 30 deri në 40 për qind më pak se diamantet e nxjerr në miniera.

Vëzhguesit e tregut thonë se diamantet e rritur në laboratorë janë në rrugën e duhur për të kapur mbi 15 për qind të tregut deri në vitin 2020

Industria e diamanteve po kalon kohë të vështira. Shitjet e gurëve të çmuar, tradicionalë për martesë, janë ngadalësuar, ndërsa brezi i mijëvjeçarit e vonon martesën, dhe diamantet e shtrenjta nuk janë më guri i preferuar, siç ka qenë dikur. Një faktor tjetër është se në treg kanë filluar të hyjnë diamante të krijuar në laboratorë. Diamantet kanë qenë gjithmonë sinonim i dashurisë dhe përkushtimit, por me një çmim të lartë. Ndërkohë në treg kanë filluar të hyjnë diamante të prodhuar në laborator.

"Përbërja kimike është saktësisht e njëjtë. Është një diamant i vërtetë. Kemi krijuar të njëjtin proces që ndodh në natyrë dhe e kemi prodhuar diamantin në laborator", thotë Kelly Good me kompaninë Grown Diamonds. Vëzhguesit e industrisë thonë se diamantet e krijuar në laboratorë janë identikë me ata që nxirren nga miniera. "Diamantet kanë një përkufizim. Ata kanë një ngurtësi të caktuar. Kanë një strukturë dhe përbërje kimike të caktuara.

# Diamante të "rritur" në laboratorë



Në këtë drejtim, diamantet e krijuar në laboratorë janë vërtet të njëjtë me diamantet e nxjerr nga miniera", thotë specialisti David Weinstein.

Ndryshimi i vetëm i vërtetë është se prodhimi i diamantit në laborator kërkon vetëm disa muaj kohë. Inxhinierët marrin diamante nga toka që shërbejnë si farë për të rritur diamante në laborator. Ata i bombardojnë me një burim karboni në temperaturë të larta dhe pas disa javësh diamantet rriten si kristale. Procesi natyror kërkon mijëra vite. Në fakt

e vetmja mënyrë për të treguar ndryshimin është mungesa e papastërtive në diamantet e krijuara në laborator. "Kam një kristal, një diamant dhe në të shoh një peridot jeshil dhe e kuptoj menjëherë se ky diamant nuk është krijuar në laborator. Pra përmbajtja mund të tregojë shumë për origjinën e materialit. Këtë kërkojnë të veçojnë specialistët tanë", thotë David Weinstein.

Diamantet e krijuar në laboratorë janë bërë sot një industri prej 14 miliardë dollarësh. "Klientët tanë janë brezi i mijëvjeçarit. Të

gjithë që fejohen blejnë diamante të krijuar në laborator. Atyre u pëlqen gjithashtu aspekti i mbrojtjes së mjedisit. Ai rritur në laborator, pa lëvizur dheun, pa ndotje mjedisore", thotë Kelly Good me kompaninë Grown Diamonds.

Diamantet sintetikë kushtojnë 30 deri në 40 për qind më pak se diamantet e nxjerr në miniera. Vëzhguesit e tregut thonë se diamantet e rritur në laboratorë janë në rrugën e duhur për të kapur mbi 15 për qind të tregut deri në vitin 2020.

## Prezantohet linja e orëve të mençura Nokia Steel Limited Edition

Nokia më herët ka konfirmuar se orët e mençura të kompanisë kanë pasur shitje mjaft të mirë qëkur është blerë kompania franceze Withings. Për të përmirësuar ende shitjen e orëve të mençura Nokia Steel hibrid, kompania fin-



landeze ka prezantuar dy modele të reja nga edicioni i limituar: Rose Gold i Full Black.

Modelet e reja nuk sjellin përmirësime në funksione në krahasim me modelet standarde, por kanë dizajn krejt ndryshe

dhe janë të krijuara me stilin maksimal dhe me lehtësi për përdorim, transmeton KosovaPress. Modeli Full Black Nokia Steel Limited Edition shitet me çmim prej 130 dollarësh, derisa Rose Gold kushton 150 dollarë.

## Panelet e tejdukshme do të jenë e ardhmja e energjisë

Një ekip i inxhinierëve nga Universiteti Shtetëror Michigan (MSU) kanë propozuar përdorimin e paneleve diellore transparente. Udhëhequr nga Richard Lunt, Profesor i Profesor i Inxhinierisë Kimike dhe Shkencave të Materialeve MSU në MSU, u krijua një koncentruer diellor transparent që mund të gjeneronte energji diellore në çdo sipërfaqe të qartë pa ndikuar në pamje. Në teori, kjo teknologji mund të aplikohet në telefonat celularë, dritaret,

ndërtesat dhe makinat. "Qelizat diellore shumë transparente përfaqësojnë valën e së ardhmes për aplikimet e reja diellore. Ne analizuam potencialin e tyre dhe pamë se duke mbledhur vetëm dritën e padukshme, këto pajisje mund të ofrojnë një potencial të ngjashëm të prodhimit të energjisë si diellore në kulme, duke ofruar funksionalitete shtesë për të rritur efikasitetin e ndërtesave, makinave dhe elektronikës mobile", tha Lunt.






## Janë në BE, por jetojnë si në mesjetë, pa teknologji e qytetërim


Kur mendojmë për shtete brenda Bashkimit Evropian, mendja na shkon tek zhvillimi dhe tek teknologjia. Edhe pse duket e pabesueshme, ka komunitete që ndodhen në shtetet e BE-së, por jetojnë si në mesjetë. Ata nuk duan teknologjinë dhe janë fanatikë të zakonave të tyre. Këto foto janë bërë në fshatrat e largëta të Rumanisë. Banorët në këto fshatra jetojnë, punojnë dhe festojnë pa ndërhyrjen e teknologjisë. Kjo zonë ndodhet në Maramures në Rumanë. Besojeni, por këta njerëz punojnë dhe sigurojnë vetë të mirat materiale duke filluar nga buka, mishin bulmeti, frutat etj. Ata shprehen se janë të lumtur me jetesën e tyre dhe janë fanatikë në përcjelljen e traditave të tyre brez pas brezi.




## DASHI (20/III-20/IV)

 Ditë perfekte për t'u kujdesur për mirëqenien tuaj psikofizike. Harmonia që është krijuar midis shpirtit dhe mendjes do ju lejojë t'i kaloni ditët e para të këtij viti në mënyrë konstruktive. Tregoni kujdes kur praktikoni një sport.


## DEMI (21/IV-20/V)

 Yjet sot parashikojnë një ditë të favorshme si për sferën private dhe atë profesionale. Në qoftë se keni projekte për të realizuar, ose propozime mjaft interesante, ky është momenti ideal, sepse mund të keni besim të shpirti juaj krijues.


## BINJAKËT (21/V-20/VI)

 Mania për të arritur suksesin nuk duhet të bëhet një obsesion për ju. Keni ndjekur rrugën e duhur për të përmirësuar situatën tuaj ekonomike dhe atë profesionale. Në sektorin e ndjenjave jo gjithçka shkon siç dëshironi.


## GAFORRJA (21/VI-22/VII)

 Dita e enjte do të jetë mjaft konstruktive dhe produktive për aktivitetin profesional dhe studimin. Mos lejoni t'ju ikin një sërë rastesh për të përmirësuar pozicionin tuaj dhe përgatitjen profesionale.


## LUANI (23/VII-22/VIII)

 Dita e enjte do të jetë mjaft konstruktive dhe produktive për aktivitetin profesional dhe studimin. Mos lejoni t'ju ikin një sërë rastesh për të përmirësuar pozicionin tuaj dhe përgatitjen profesionale.


## VIRGJËRËSHA (23/VIII-22/IX)

 Hëna, Saturni dhe Dielli formojnë një aspekt të bukur në qiellin tuaj, duke e bërë ditën e sotme mjaft produktive. Mos refuzoni një detyrë me përgjegjësi dhe as një udhëtim, sepse në gjithçka që do të angazhoheni gjatë këtij muaji do të japë rezultate të mira së shpejti.


## PESHORJA (23/IX-22/X)

 Në shumë rrethana kërkoni të tërhiqni vëmendjen e të tjerëve. Ndoshta ky është një reagim që vjen si pasojë e melankolisë, i një boshllëku ndjenjash, apo si shkak i mosbesimit në vetvete.


## AKREPI (22/X-21/XII)

 Objektivi primar për ju në këtë moment do të jetë suksesi dhe realizimi profesional me çdo kusht. Mbrëmja e sotme do të jetë e paharueshme për sa i përket dashurisë dhe jetës në çift.


## SHIGJETARI (22/XI-21/XII)

 Profesionalisht mund t'ju paraqiten raste mjaft të mira, vetëm kini kujdes, sepse jo gjithçka është ashtu siç duket. Dita e sotme nuk premtion shumë në dashuri, përveç të lindurve në fund të nëntorit.


## BRICJAPI (22/XII-20/I)

 Yjet në favor ju dhurojnë një humor të shkëlqyer dhe mundësi të ndryshme, nga të cilat duhet të përfitoni menjëherë. Në punë guximi juaj do ju ndihmojë të përballoni çdo situatë, sado e vështirë që të jetë.

## UJORI (20/I-19/II)

 Ky do të jetë një moment ku do të bëni një analizë të brendshme, si për sa i përket punës dhe familjes. Nën profilin financiar, gjithsesi dita paraqitet mirë. Tregohuni të sinqertë me njeriun e zemrës.

## PESHQIT (20/II-19/III)

 Në sektorin profesional duhet të pranoni një ndryshim ose postim. Gjithsesi, avantazhet do të jenë të garantuara, edhe pse do ju duhet të hiqni dorë nga një program dhe nga disa zakone. Në dashuri mirëkuptimi erotik me partnerin do ju ndihmojë të ktheni sërish harmoninë në marrëdhënien tuaj.



NË KËTË DATË

13 NENTOR 1955

Mensur Mamuti	TË BËRIT I OLERANCE	FILM ME AKTOREN NJË FOTO	QËNDRIM PARIMOR I PALEKUNDSHËM	AKTORJA AMERIKANE NË FOTO		
	ENAMETALIKE KU LIDHEN PERKOHËSISHT ANIJET				JO NË KËMBË	SHKËMB I MADH, THEPI
L	AUSTRIA	LITUMI	ILINIUMI			
LLOJ ARTIKULIMI MUZIKOR						
KOHA	VEND TURISTIK AFËR ORIKUMIT	SULMUES, QË BËNATAK	BERILUMI	KOHA	DUELI TRUPI I NJERIUT (SH.)	
UJHESË NË KROACI				I PAPJEKUR, SHTALP		ISH FUTBOLLISTI ITALIAN, XHUZEPE
				NDRE MJEDA		
TENTIM PËR VRASJE TË NJË PERSONALITETI TË NJOHUR						ELEKTROMOTOR
						LUMI I SHKODRËS
DORËZOI			ETMERRSHME			
			AKTORJA ZHIRARDO			
SHKOVA				KARROCA (VJET)		
				HIVZI SULEJMANI		
PJESË E NJU JORKUT, VENDLINDJA E ARTISTES NË FOTO						CELSIUSI TEMPERATURA
FILZOZI PERIPATETIK I ALEKSANDRISE						PËREMËR VETOR

ZGJIDHJET: T, P, BOVA, ULUR, KEPI, URIM, RIGË, LIMOS, A, LI, SFIDA, RAB, SHTALB, ATENTAT, EM, DHA, MAKABRE, IKA, TALUGA, MENHETEN, C, ARISTO, ATA.

## Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

			7	2	6				9				4			8
8			9								2		7			
5	1				7					2	6		9		4	5
	8		6	3						8	2		1	6	3	
		3			4											
					1	8					7	4	8		6	2
		6			9					4	8		6		5	1
			4									5		3		
9			6	1					6			8				4

Shumë i lehtë: 934875216, 867192354, 512346798, 481623579, 753918462, 629754183, 246587931, 178439625, 395261847. Mesatar: 913654278, 854237961, 726198453, 582916347, 469372185, 137485629, 348769512, 271543896, 695821734.



## Telefoni më i vogël android në botë

Derisa Apple në mënyrë konstante po gjen mënyra të reja për të qenë revolucionar në industrinë e telefonave të mençur, një tjetër kompani po tenton të na kthejë në kohë më të qeta. Kompania FutureModel planifikon të lansojë pajisjen NichePhone-S kah fundi i muajit, i cili punon në sistemin



operativ Andorid, por nuk mund të kryejë asgjë më shumë se sa thirrjet, SMS dhe të emitojë muzikë. Madhësia e tij është sa një kredi kartele dhe duket si kalkulator i vogël. Telefoni do të dalë në treg më 10 nëntor në Japoni dhe do të kushtojë 95 dollarë. Ai punon në sistemin operativ Andorid 4.2.

## Truku me fijet e qibritit zbulon a i keni mushkëritë të shëndetshme

Shpesh ndodh që njerëzit të kenë probleme me organet respiratore, por të mos jenë të vetëdijshëm për to. A është çdo gjë në rregull me mushkëritë tuaja mund të na tregojë një test i vogël për të cilin ju nevojiten vetëm një fije qibriti dhe një çakmak. Ndizeni fijet e qibritit dhe shtrijeni dorën në të cilën do ta mbani para vetes. Merrni frymë thellë me hundë dhe nxirreni jashtë nga goja. Sa herë këtë e keni bërë para se keni fikur fijen e qibritit? Nëse



ju janë nevojitur disa herë që ta fikni, atëherë me siguri keni probleme me mushkëritë. Këto probleme mund të jenë nga pirja e duhanit, mungesa e kondicionit fizik dhe sëmundjet kronike të organeve respiratore. Në kapacitetin e mushkërive mund të ndikojë edhe mënyra e jetesës, por edhe sëmundja. Është domosdoshme testin ta bëni në dhomën e cila është e ajrosur, mirëpo në të nuk duhet të ketë lëvizje të madhe të ajrit.

## Zbulohet periudha kur gratë janë më të prirura të tradhtojnë

Shkencëtarët kanë identifikuar një periudhë specifike në të cilën gratë të cilat janë në lidhje afatgjata janë më të prirura që të tradhtojnë partnerët e tyre. Ata gjetën që gratë janë më të prirura që të tradhtojnë mes gjashtë dhe dhjetë vjetësh që janë në lidhje me dikë. Sidoqoftë, kur vjen puna te ekzaminimi i shkallës së pabesisë nga ana e meshkujve, studimi gjeti që ishte më pak specifik, ku meshkujt janë më të



prirur që të tradhtojnë lumbuesit bënë dy pas 11 vjetësh. Hu-studime të ndara që

shikuan 432 pjesëmarrës, ku prej secilit prej tyre ishte kërkuar të kompletohej një anketim në rëndësinë e perceptuar të rezistimit të joshjes për të tradhtuar. Studimi i publikuar në The Journal of Sex Research konkludoi që faktorë të shumtë çuan që njerëzit të mos tradhtojnë, por kjo më shumë kishte të bënte me dëshirën për t'i mbajtur standardet morale dhe nga frika e të mbeturit vetëm.

## KALENDARI HISTORIK 13 NËNTOR

1511 - Anglia nënshkruan marrëveshje për Lidhjen e Shenjtë.  
1843 - Shpërthen mali Rainier në Uashington.  
1851 - Bëhet lidhja telegrafike mes Londrës dhe Parisit.  
1864 - Miratohet kushtetuta e re e Greqisë.  
1865 - SHBA lëshon në përdorim certifikatat e para të arta.  
1885 - Ushtria serbe okupon Bullgarinë.  
1918 - Rusia anulon Traktatin e Brest-Litovsk.  
1921 - SHBA, Franca, Japonia dhe Perandoria britanike nënshkruajnë Traktatin e Paqësorisit.  
1935 - Shpërthejnë demonstrata anti britanike në Egjipt.



1941 - Gjermani Abweht konsultohet me udhëheqësin çetnik Drazha Mihailoviç.  
1982 - Monumenti dedikuar Luftës së Vietnamit ndërtohet në Uashington DC  
1994 - Suedia pajtohet t'i bashkohet

Bashkimit Evropian.  
1997 - OKB largon ekipin e inspektimit të armëve nga Iraku.

## A E DINI SE...



A e dini arsyen e vërtetë pse kafeja shërbehet me një gotë ujë? Kamerieri gjithmonë, porosisë suaj i bashkëngjit edhe një gotë me ujë. Por, a e dini pse ndodh kjo? Në fakt, përgjigja për këtë është shkencore. Kafeina është diuretik, që do të thotë se e rrit shpeshtësinë e urinimit dhe me këtë gjë trupi humb lëngje me një ritëm të shpejtë. Prandaj njerëzit zakonisht konsumojnë ujë bashkë me kafe për të kompensuar sasinë e ujit që humbet përmes urinimit. Duke mos konsumuar ujë gjatë kohës kur pini kafe, ju rrisni rrezikun për t'u dehidratuar. Tani e mësuat: Kurrë mos e lini pa pirë gotën e ujit!



## BARSOLETA



**TRE MIQTË DHE FËMIJËT E TYRE**  
- Djali im me shumë gjasa do të bëhet avokat. Që tani përdor argumente shumë të holla!  
- Djali im do të bëhet veteriner, thotë i dyti, që tani ka filluar të vizitojë kafshët!  
- Im bir me siguri do të bëhet kamerier kur të rritet. Sa herë e thërras, asnjëherë nuk vjen...

## THËNIA E DITËS

Njerëzit shpenzojnë shumë kohë, duke u përpjekur për të qenë dikush tjetër. Mendoj se kjo shkakton sëmundje të tmerrshme. (John Lennon)

